



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOSSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT

MINISTRY OF EDUCATION

MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE

SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

SCIENCE & TECHNOLOGY

NAUKU I TEHNOLOGIJU

Zyra e Sekretarit të Përhershëm Office of the Permanent Secretary

Kancelarija Stalnog Sekretara



RAPORTI I PUNËS SË MASHT-it PËR VITIN 2007

***Prishtinë
Janar-2008***

Zyra për Planifikim dhe Analizë

RAPORTI I PUNËS SË MASHT-it PËR VITIN 2007

Hyrje

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë , tashmë qe pesë vite, në fund të çdo viti kalendarik bën një rekapitulim të punës të zhvilluar gjatë atij viti dhe atë e boton në formë doracak. Kjo është dëshmuar si një përvojë e mirë, sepse në një vend i gjen të gjitha programet, projektet, punët dhe aktivitetet tjera kryesore që janë zhvilluar në MASHT dhe nga MASHT-i për arsimin në Kosovë.

Konsiderojmë që ky është një material i mirë dokumentar që do të shërbente për analiza dhe planifikim të arsimit për vitin që vjen si dhe për periudhën afatmesme të zhvillimit të arsimit, ndërsa për gjeneratat e ardhshme do të shërbejë si udhërrëfyes për studim dhe hulumtim të kësaj periudhe kohore në fushën e arsimit..

- ❖ MASHT gjatë këtij viti punën e vet e ka mbështetur në planin vjetor të punës së për vitin 2007 të miratuar në janar të këtij viti, si dhe në prioritetet që i ka caktuar në fillim të vitit Qeveria e Kosovës për fushën e arsimit;*
- ✓ Prioritet i të gjitha prioritetëve në Kosovë edhe këtë vit ishte përcaktimi i statusit final të Kosovës, prandaj MASHT ka krijuar një grup të veçantë të punës që në çdo kohë është i përgatitur për të ndihmuar Grupin e Unitetit për bisedime eventuale nga lëmi i arsimit;*
- ✓ Prioritet tjetër është implementimi i standardeve. Kështu, MASHT ka intensifikuar aktivitetet për implementimin konkret të të gjitha pikave nga standardet që kanë të bëjnë me lëmin e arsimit. Rezultatet janë evidente, sepse kemi integrim të plotë të të gjitha minoriteteve, me përjashtim të një pjese të minoritetit serb që ndikohet nga politika e Beogradit.*

Në MASHT janë përmbushur objektivat parësore të caktuara për vitin 2007

- ✓ Prioritet tjetër i MASHT-it është puna në finalizimin e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2007-2017*
- ✓ MASHT-i ka participuar në zhvillimin e Planit Strategjik të Qeverisë së Kosovës (në sferën e arsimit);*
- ✓ Është themeluar Agjencioni i Akreditimit të Kosovës;*
- ✓ Është themeluar Instituti Pedagogjik i Kosovës;*
- ✓ MASHT ka vazhduar bashkëpunim të frytshëm me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, që fushëveprimtari kryesore e kanë arsimin. Kështu, janë nënshkruar 8 memorandeme për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e arsimit, kryesisht me vendet e rajonit si dhe janë realizuar mbi 30 vizita me karakter ndërkombëtar, të cilat gjithashtu i kontribuojnë zhvillimit të arsimit në Kosovë etj.*

Ky raport ka dy kapituj:

Në kapitullin e parë prezantohet Plani i Punës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2007. Qëllimi i këtij prezantimi është që ta bëjë transparente punën në MASHT; mund të krahasohet se çka është planifikuar, çka është realizuar dhe çka ka mbetur pa u realizuar .

Në kapitullin e dytë prezantohet “Raporti i Punës së MASHT-it për vitin 2007”, që përbën pjesën qendrore (bërthamën) të këtij raporti. Raporti paraqet të arriturat konkrete nga secila fushë e arsimit, përkatësisht nga secili departament dhe sektor i MASHT-it.

Ky raport dallon nga të mëparshmit, sepse këtu nuk janë përfshirë treguesit statistikorë, përkatësisht treguesit sasiorë dhe cilësorë të arsimit kosovarë, pastaj nuk janë përfshirë as analizat e ndryshme mbi trendet e zhvillimit të arsimit, mbi cilësinë e mësimit, trajnimet, etj. , sepse këta tregues, po edhe shumë të tjerë do të botohen në një doracak të veçantë me titull “Statistikat Arsimore për vitet shkollore:2004/05; 2005/06 dhe 2006/07”, doracak ky që është përgatitur në bashkëpunim me UNICEF-in. Raporti prezanton objektivat e realizuara, ato që janë në proces dhe ato që janë planifikuar dhe nuk janë realizuar gjatë vitit 2007.

Prezantimi i punëve dhe aktiviteteve në raport bëhet sipas strukturës organizative të MASHT-it.

Në vend të përfundimit do të prezantojmë shkurtimisht sfidat kryesore që e kanë ndjekur dhe e ndjekin edhe sot arsimin kosovar, si dhe krejt në fund në vija të trasha do t'i paraqesim prioritetet e MASHT-it për vitin 2008.

Raporti do të përkthehet edhe në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe.

KAPITULLI I PARË

 *PLANIFIKIMI I PUNËS SË MASHT-it PËR VITIN
2007*

PLANIFIKIMI I PUNËS SË MASHT-it PËR VITIN 2007

HYRJE

Plani i punës i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2007 mbështetet në:

- *Prioritetet e Qeverisë së Kosovës për vitin 2007 (të paraqitura në Planin Strategjik të Kosovës 2007-2013);*
- *Strategjinë e Arsimit Parauniversitar, 2007-2017 (dokument ky që është në fazën përfundimtare të tij, para dërgimit për miratim në Kuvendin e Kosovës)*
- *Strategjinë e Arsimit të Lartë të Kosovës 2005-2015 si dhe në disa strategji të tjera sektoriale nga fusha e arsimit;*
- *Në të arriturat në të gjitha fushat dhe nivelet e arsimit, veçmas në procesin e zhvillimit të reformave të arsimit në Kosovë gjatë vitit 2006;*
- *Në vazhdimin e programeve dhe projekteve që zhvillohen nga MASHT, në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë të jashtëm e që kanë vijimësi më të gjatë kohore, si dhe inicimin e projekteve dhe programeve të reja veçmas në arsimin e lartë, si dhe në;*
- *Mundësitë buxhetore që ka Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2006*

Për sëndertimin e vizionit, misionit, dhe objektivave të arsimit që janë të parapara në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, përkatësisht Strategjinë e Arsimit të Lartë të Kosovës 2005-2015 MASHT për vitin 2007 ka përcaktuar këto programe dhe projekte që konsiderohen edhe si prioritetet për këtë vit:

- *Përmbushja në tërësi e standardeve që i përkasin fushës së arsimit*
- *Të sigurojë gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim të diversiteteteve në arsim*
- *Të ngrisë qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit*
- *Të zhvillojë sistem efektiv për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të personelit arsimor*
- *Të krijoj mjedis fizik të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë*
- *Të ndërtojë lidhje të qendrueshme të arsimit me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore*
- *Të avancimi i gjendjes materiale të arsimit.*
Prioritet edhe në këtë vit do të jetë:
- *Integrimi i të gjitha minoriteteve në sistemin unik arsimor të Kosovës, me theks të veçantë inkurajimi i minoritetit serb që të kyçet më me sukses në sistemin arsimor të Kosovës.*
- *Ndërtimi i bazës ligjore me ligje të reja si dhe nxjerrja e Udhëzimeve përkatëse Administrative që dalin nga ligjet e miratuara si dhe nga objektivat e cekura më lartë*
- *Valorizimi i procesit të reformave në arsim (Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës, planprogrameve dhe teksteve shkollore si dhe trajnimit të personelit arsimor;*
- *Zhvillimi i planprogrameve për mësimin protësues të fëmijëve tanë në diasporë*
- *Rishikimi i standardeve të përmbajtjes dhe standardeve të arritshmërisë për tri nivelet shkollore gjatë vitit shkollor 2007/08*
- *Finalizimi dhe miratimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2007-2017*
- *Implementimi i Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë 2005-2015*
- *Implementimi i Strategji së për arsimin e të rriturëve si dhe i Strategjisë për çështje gjinore.*
- *Fillimi i punës i Akademisë për Administratën Arsimore si dhe Agjencisë për Aftësimin e Mësimdhënësve*

- *Funksionalizimi i AAK-së si dhe themelimi i Qendrës për Transfer Teknologjik*
- *Ngritja e Qendrës për Standarde dhe Vlerësim;*
- *Përgatitjet për fillimin e punës së Institutit Pedagogjik;*
- *Licencimi i institucioneve të arsimit privat në të gjitha nivelet*
- *Organizimi i rrjetit të ri të shkollave*
- *Vendosja e urave të reja të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit - lidhja e marrëveshjeve bashkëpunimi dhe mirëkuptimi me vendet e rajonit dhe më gjerë*
- *Thellimi i bashkëpunimit me donatorët e deritashëm si dhe kërkimi i donatorëve*
- *Zhvillimi dhe implementimi i një sistemi modern për menagjimin e informatave në arsim*
- *Zhvillimi dhe përcjellja e veprimeve që dalin nga prioritetet e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE)*
- *Ky plan është hartuar sipas strukturës së brendshme organizative të MASHT-it (i ndarë sipas departamenteve, sektorëve), ku janë përfshirë aktivitetet e planifikuara në vija të trasha, përderisa në planet tremujore dhe mujore aktivitetet janë të specifikuar në aktivitete javore dhe ditore.*

❖ **Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar**

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi/Aksioni</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Vështirësitë/</i>
<i>Thellimi i lidhjeve me partnerë dhe donatorë ndërkombëtar si dhe krijimi i lidhjeve të reja për bashkëpunim dhe rrjetizim me theks të veçantë në realizimin e projekteve të filluar në vitet paraprake në arsimin e lartë dhe fillimi i realizimit të projekteve të reja</i>	<i>Tekimet e rregullta të Bordit të ERI SEE</i>	<i>-I-VI-XII-</i>	<i>1500 €</i>	<i>Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar</i>	<i>Ngritja e kapaciteteve Edukimi i nx. për të drejtën humanitare ndërkombëtare Fitimi i përvojave të reja në arsim si dhe ngritja profesionale e shërbyeseve civil në arsim. Shkëmbimi i ekspertëve dhe studentëve ndërmjet shteteve të rajonit dhe më gjerë si dhe stipendimi i stad. për studime pasdiplomike. Funksionalizimi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës dhe themelimi i Qendrës për Transfer të Teknologjisë</i>	<i>Buxheti dhe mungesa e stafit të Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar edhe për shkak të restriksioneve nga Qeveria për punësimin e stafit të ri në Institucione Qeveritare.</i>
	<i>Seminar me ERI SEE (iniciativa për reforma në arsim në Evropën Juglindore)</i>	<i>Shkurt-nëntor</i>	<i>3500 €</i>			
	<i>Përgatitja e Konferencës të Ministrave të Evropës për Procesin e Bolonjës në Londër</i>	<i>Shkurt-Maj</i>	<i>1000€</i>			
	<i>Mledhja e Bordit të KIJAC</i>	<i>Qershor</i>				
	<i>AUE Forcimi i Arsimit të Lartë në Evropën JL (Vienë)</i>	<i>Janar; tetor</i>	<i>1800 €</i>			
	<i>Mbledhja e Bordit të Projektit me Austriakët në Vienë</i>	<i>Gusht</i>	<i>1100 €</i>			
	<i>Bologna Follow-up Group</i>	<i>Mars</i>	<i>1800 €</i>			
	<i>Bordi i projektit me FSDEK</i>	<i>Prill</i>				
	<i>Pjesëmarrja në seminare dhe punëtori të organizuara në Kosovë</i>	<i>Janar-dhjetor</i>	<i>500€</i>			
	<i>Pjesëmarrja në seminare të organizuara nga ERI SEE në vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor dhe BE</i>	<i>Shkurt-Dhjetor</i>	<i>3300 €</i>			
	<i>Vizitë studimore në Maqedoni dhe Shqipëri lidhur me Programin Hulumtimi i Drejtës Humanitare</i>	<i>Mars-gusht</i>	<i>1500 €</i>			
	<i>Takimet e rregullta të Grupit për Promovimin e Procesit të Bolonjës</i>	<i>Janar-dhjetor</i>				
	<i>Nënshkrimi i MiM me Ministrinë e Arsimit të Turqisë</i>	<i>shkurt</i>				
<i>Takimet e rregulltat të Grupit për Programin pa Shkëputje nga Puna</i>	<i>Janar-dhjetor</i>					

❖ Zyra për planifikim dhe analizë

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/Sfidat
<p>Planifikimi i punëve së MASHT-it për vitin 2007;</p> <p>Zhvillimi i një Sistemi modern për Menaxhimin e Informatave në Arsim;</p> <p>Përcjellja, analiza dhe raportimi i aktiviteteve të realizuara në MASHT</p>	Planifikimi vjetor i punës së ZPA dhe MASHT-it për vitin 2007	XII-06		Zyra për planifikim dhe analizë	<p>Miratimi i planit të punës së MASHT-it për vitin 2007;</p> <p>Raportet mujore, tremujore dhe vjetore të punës në MASHT;</p> <p>Përgatitja e një programi operativ për sistemin e menagjimit të informatave në arsim.</p>	<p>Moskompletimi i stafit të zyrës;</p> <p>Nevoja për Trajnime jashtë vendit e stafit të zyrës</p>
	Planifikimet tremujore, mujore dhe javore të punëve në MASHT	-I-XII-				
	Hartimi i raporteve mujore, tremujore dhe vjetore të punës së MASHT-it	-I-XII-	2.000 €			
	Analizë mbi realizimin e programeve dhe projekteve të MASHT-it për 2006	-I-XII-				
	Implementimi programit "software" për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit në Arsim, projekt ky që realizohet në bashkëpunim me Bankën Botërore	-I-XII-	120.000 €			
	Përgatitja e planit dinamik për përfundimin e vitit shkollor si dhe përgatitjet për vitin e ri shkollor 2007/08	-V-VI-				
	Përgatitja e planit të regjistrimit të nxënësve në shkolla të mesme të larta	VI-VII				
	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2006/07	VII-XI-				
	Analizë e suksesit të përgjithshëm të nx. për vitin shkollor 2006-07	-VI-XI-	2.000 €			
	Analizë e rezultateve të Testit Kombëtar për nivelet e realizuara	-VIII-IX-				
	Informatë për regjistrimin e nx. dhe studentëve në vitin shkollor 2006/07	IX-XI				
	Analizë mbi rrjedhat dhe trendet e punës në arsim në Kosovë	-I-XII-				
Informacione, analiza dhe komente për përcaktimin e politikave arsimore për Sekretarin e Përhershëm apo Ministri	-I-XII-					

✚ Zyra e inspeksionit

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja finance.	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/Sfidat
-Zbatueshmëria e ligjeve dhe procedurave pozitive në fuqi	Vizita në ZRA	-I-XI-	300€	Z.L	Inspektimi në institucione arsimore	Personeli i mangët;
	Inspektimi në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetet Private	I-XII-	200€	ZL	Ngritja e cilësisë në institucionet e arsimit të lartë	
	Inspektimi në institucionet shkollore publike dhe private	-III-XII-	1750€	ZL	Ngritja e standardeve në arsim	
	Hartimi i raporteve	-I-XII-		ZI	-II- -II-	
-Efektivitet dhe cilësi më e lartë në	Nxjerrja e rekomandimeve	-I-XII-		ZI	-II- -II-	Llaptopët (
	Nxjerrja e vendimeve për të gjitha çështjet kontestuese	-I-XII-		ZI	Eliminimi i lëshimeve dhe	

<i>realizimin e objektivave të sistemit të arsimit, në Kosovë</i>	<i>në institucionet arsimore</i>				<i>parregullësive ligjore</i>	<i>terren),</i>
	<i>Shqyrtimi i ankesave të shkallës së dytë</i>	<i>-I-XII-</i>	47.000€	<i>ZI</i>	<i>-II-</i>	
<i>- Eliminimi i konteksteve dhe parregullësive nga institucionet arsimore</i>	<i>Trajnimi i stafit të inspektorëve</i>	<i>-X-</i>	3.300€	<i>ZI</i>	<i>Përvetësimi i metodologjisë bashkëkohore në lëmin e inspektimit</i>	
	<i>Vizita të ekskursioneve jasht vendit</i>	<i>-VI-X</i>		<i>ZI</i>	<i>Sigurimi i një përcjelljeje më të mire të ekskursioneve të nxënësve</i>	
	<i>Verifikimi i dokumentacionit</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>ZI</i>		
	<i>Përcjellja e rregullsisë gjatë pranimit të nxënësve dhe studentëve</i>	<i>-VI-IX-</i>		<i>ZI</i>	<i>Eliminimi i lëshimeve procedurale dhe lëshimeve të tjera gjatë rekrutimit të nxënësve</i>	
	<i>Përcjellja e rregullsisë gjatë rekrutimit të personelit mësimor</i>	<i>-IX-X-</i>		<i>ZI</i>	<i>-II-</i>	
	<i>Vizita në shkollat shqipe në diasporë</i>	<i>-XII-</i>	1.340€		<i>Përfshirje e fëmijëve në mësimin plotësues</i>	

❖ **Zyra ligjore**

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi/Aksioni</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Sfidat</i>
<i>Rregullimi me ligje i këtyre fushave arsimore</i>	<i>Hartimi i Projektligjeve :</i> <i>-Projektligji për Maturën;</i> <i>-Projektligji për Institutun Albanologjik;</i> <i>-Projektligji për Institutin Pedagogjik</i>	<i>-I-XII</i>	40.000 €	<i>Z. Ligjore dhe komisionet përkatëse</i>	<i>Hartimi i ligjeve për çështje konkrete dhe zbatimimi në praktik;</i>	
<i>II. Plotësimi dhe specifikimi Ligjeve me Udhëzime Administrative</i>	<i>1.Nga Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm do të nxirren 3 Udhëzime Administrative;</i> <i>2.Nga Ligji mbi arsimin e Lartë do të nxirren 4 (katër) udhëzime administrative;</i> <i>3.Nga Ligji mbi edukimin parashkollor do të nxirren 19 (nëntëmbëdhjetë)Udhëzime Administrative;</i> <i>4.Nga Ligji Mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional do të nxirren 10 (dhjetë) Udhëzime Administrative;</i> <i>5.Nga ligji Mbi botimin e teksteve dhe mjeteve shkollore do të nxirren 2 (dy) Udhëzime Administrative ;</i> <i>6.Nga Ligji për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjestarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës do të nxirren 2 (dy) Udhëzime Administrative</i>	<i>Janar-dhjetor</i>	30.000,00 €	<i>MASHT</i> <i>Dep. i Arsimit Parauniversitar</i> <i>Dep. i Arsimit të Lartë</i>	<i>Zhvillimi dhe Implementimi i Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative të miratuara</i>	

<i>IV. Pjesëmarrja ne Komisione</i>	<i>1.Pjesëmarrja në Komisionin për parashtrësia dhe ankesa; 2.Pjesëmarrja ne komisionin për barasvlerë dhe nostrifikim; 3.Pjesëmarrja ne komisionet për hartimin e ligjeve Udhëzimeve administrative;</i>	<i>Gjatë tërë vitit (sipas nevojës)</i>	<i>10.000€</i>	<i>Z. ligjore</i>	<i>Vendosja për lëndët e përsoneve qe kanë nevojë për Barazvler dhe Nostrifiki. Mbulimi i këyre fushave me normative Ligjore dhe nenligjore.</i>
<i>V. Hartimi shkresave të ndryshme</i>	<i>Hartimi i Vendimeve, kontratave, memorandumeve, statuteve, raporteve, planeve të punës, kërkesave, autorizimeve, përgjigjeve, vërtetimeve, njoftimeve, rekomandimeve etj.</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>5.000€</i>	<i>Z.ligjore</i>	<i>Rregullimi çështjeve të ndryshme</i>
<i>VI. Pritja e palëve.</i>	<i>Dhënia e ndihmës profesionale përmes këshillave juridike, dhe materialeve të cilat iu nevojiten palëve</i>	<i>Janar-dhjetor</i>		<i>Zyra ligjore</i>	<i>Parandalimi i parregullësive të ndryshme si dhe udhëzimi se si të realizohen të drejtat e palvë më lehtë.</i>

Zyra e auditimit

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi/Aksioni</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e</i>	<i>Vështirësitë</i>
<i>1. Vërtetimi se njësitë buxhetore në MASHT janë duke i kryer funksionet e caktuara në të gjitha fushëveprimet në përputhshmëri me ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe instruksionet në fuqi</i>	<i>Hartimi i planit të punës për vitin 2007</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>ZA</i>	<i>Përmirësimi i efektshmërisë së menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve udhëheqëse</i>	<i>Mungesa e llaptopëve për punët në terren</i>
	<i>Hartimi i raporteve mujore dhe vjetore të punës</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Auditime në:Shkollat speciale</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Universitet</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Qendren e studentëve</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Bibloteka Kombëtare</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Administrata Qendrore</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Institutet</i>	<i>I-XII -</i>		<i>ZA</i>		
	<i>Përgatitja e raporteve-raportimet</i>	<i>I-XII-</i>	<i>500 €</i>	<i>ZA</i>		
	<i>Percjellja e implementimit të dokumentave</i>	<i>I-XII-</i>		<i>ZA</i>		
	<i>I-XII-</i>	<i>3500 €</i>	<i>ZA</i>			
	<i>Trajnimet</i>					



DEPARTAMENTI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

❖ **Sektori i planprogrameve**

Objektivat	Aktivitet e planifikuara	Afati	Kostoja	Përgjegjësia	Rezultatet	Vështirësitë
Ndritja e cilësisë në arsim	Përgatitja për miratim i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës	-II-VI-	13000	NjZHP	Korniza eKurrikulii	
	Hartimi i planprogrameve për Edukimin Parashkollorë (deri në 3 vjeç)	Shkt – Tetor	26193	Nje parashk,	Kurrikuli i ri për parashkollën deri në 3 vjeç	
	Seminaret informative për edukatorët në edukimin parashkollor	Sht– Dhjetor	15000	Nj. parashkës		
	Hartimi i udhëzuesit për edukatorët dhe përkthimi në gjuhët e minoriteve	Qer– Dhjetor	13400	Nj. parashk		
	Përkthimi i programeve për edukimin parashkollor deri në 3 vjeç në gjuhët turke, boshnjake dhe serbe.	Jan.mars	7300	Nj e parashkës		
	Përgatitja, redaktuara dhe miratimi i planprogrameve për mësimin plotësues në diasporë	Janar – Mars	10000	Njësia ShSH në diasporë,Nj ZHP MASHT	Kurrikuli i Ri për mësimin plotësues në diasporë	
Trajnimi informativ i mësimitdhënësve në diasporë	Mar – Korrik	15000				
Përkthimi i programeve për diasporë në gjuhët angleze dhe gjermane	Mars - Korrik 2007	6000				
Vendosja e standardeve të përbajtjes dhe arritshmërisë	Redaktura, miratimi dhe botimi I standardeve të përbajtjes dhe arritshmerise në nivele (I, II, III)	Janar – Prill 2007	6400	NjVS, NjZHP MASHT	Dokumenti (libri) me standardet e miratuara të përbajtjes dhe arritshmërisë në nivele	
	Seminari me ekspertët për hartimin e standardeve në të tri nivelet e shkollimit	Prill, 2007	8000			
	Rishikimi I standardeve të përbajtjes dhe arritshmërisë në nivele, analiza dhe vendosja e standardeve të reja	Maj – Dhjetor	78800			
	Monitorimi i planprogrameve, metodologjisë dhe vlerësimit	Pr – Dhjetor	56100			
Monitorimi i planprogrameve, metodologjisë dhe vlerësimit	Analiza e monitorimit të planprogrameve të klasave 1,6,10	G – Tetor	10500	Sektori i Planprogrameve	Analiza e monitorimit me rekomandimet	Mungesa e agjencionit të pavarur për monitorim
	Aftësimi profesional i stafit të Njësive së Planprogrameve Shqipëri, Angli)	Janar, Qershor	14100			
	Pjesëmarrja në trajnimet e mësimitdhënësve	Ne proces	0			
	GJIHSEJ (Planprogramet)		290250			

➤ Njësia e Vlerësimit dhe Standardeve					
Ngritja e standardeve në mësim dhe vlerësimi objektiv i procesit mësimor	Vizita studimore jashtë vendit	Ja- Shtator	20150	NJVS	Ngritja e kapaciteteve të
	Punëtori me hartuesit kërkesave për klasën e 12-13	J- Dhjetor	2600	NJVS	
	Përpilimi i bankës së kërkesave për çdo lëndë (trefishi i kërkesave në test për çdo lëndë për klasat 9, 12 dhe 13)	Janar .Dhjetor	77680	NJVS	Formimi i bankës së kërkesave për testin e klasës së IX dhe XII-XIII
	Përgatitja, administrimi dhe analiza e Testit Kombëtar dhe maturës	-I- X-	206290€	NJVS	Mbarëvajtja e testit
	Përgatitja e një doracaku-materialeve për mësimdhënës për format dhe metodat e vlerësimit.	Janar – Tetor	6000	NJVS	Informimi i mësimdhënësve për vlerësim
➤ Njësia e Teksteve Shkollore dhe Burimeve të Planprogrameve					
Ngritja e cilësisë së teksteve shkollore	Komunikimi me autorët e teksteve dhe shtëpitë botuese	Ne proces	0		
	Trajnimi I stafit të Njesisë jashtë Kosovës	Prill	2000	MASHT	Përfitimi i përvojave të reja
	Zhvillimi I teksteve shkollore për arsimin profesional. Trajnimi I autorëve	Mars – Korrik	18000	MASHT	Pranimi i dorëshkrimeve
	(*)botimi I teksteve shkollore për minoritetet	Ne proces	0	MASHT	Sigurimi i teksteve
	(*) Recensentët dhe vlerësimi i teksteve për minoritetet	Ne proces	0	MASHT	Vlerësimi
	Përgatitja e standardeve për zhvillimin e teksteve shkollore	Jan – Tetor	12000	MASHT	Caktimi i standardeve
	(*) Botimi i teksteve dhe materialeve tjera plotësuese	Ne proces	0	MASHT	
	Diskutimi publik për tekstet shkollore	Sht – hjetor	7100	MASHT	Vlerësimi i teksteve
	GJITHSEJ (Tekstet):		32900		
GJITHSEJ (Sektori i Planprogrameve)			503640		
Arsimi Profesional per planprogramet			106360		
GJITHSEJ:			610000		

❖ Sektori për aftësimin e mësimdhënësve

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja financiare	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësi të/ Sfidat
Ngritja profesionale e personelit arsimor në të gjitha institucionet	MKLSH (MASHT-KEC)	Shk.nent	80.400€		Mësimdhënie bashkëkohore; zbatueshmëria e formave dhe	
	Trajnime: Udhëheqje Arsimore	Qershor-korrik	4.500 €			
	Trajnime: MNQ	Jan-,nentor	11.100 €			
	Shpenzime për libra të MNQ	Mars-prill	2.100			
	Trajnimi sipas planprogrameve të reja 5	Qerkorrik	13.000 €			
	Trajnimi per gj.angleze	Mars-nentor	20.000 €			

arsimore ; qendrueshmëria dhe zbatueshmëria e standardeve të praktikës profesionale si dhe ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	<i>Bashkëpunimi me KSHAM-in</i>	<i>Janar-dhjetor</i>	<i>7.200 €</i>	<i>Sektori për aftësimin e mësimdhënësve</i>	<i>metodologjive të reja të mësimdhënies; aftësimi i studentëve përmes punës praktike; ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies</i>
	<i>Seminar për vlerësim me mësimdhënës dhe drejtor</i>	<i>Mars,nen</i>	<i>9.850 €</i>		
	<i>Instituti Veror, trajnime për shkathtësi, barazi gjinore etj.</i>	<i>Qersh.-gusht</i>	<i>14.200 €</i>		
	<i>Monitorimi i seminareve</i>	<i>Janar-dhjetor</i>	<i>4.200 €</i>		
	<i>Trajnimi i trajnerëve klasor</i>	<i>Mars-ger</i>	<i>11.350€</i>		
	<i>Trajnimi i mësimdhënësve klasor</i>	<i>Qer-korrik</i>	<i>17.250€</i>		
	<i>Bashkëfinancim MASHT-DEA</i>	<i>Prill- korrik</i>	<i>3.500 €</i>		
	<i>Takime me OJQ, trajnime,</i>	<i>Mars, qer, shtat</i>			
	<i>Trajnime lëndore të arsimit profesional</i>	<i>Mars-nentor</i>	<i>20.000 €</i>		
	<i>Vlerësim të projekteve nga OJQ</i>	<i>Jan- -dhjetor</i>			
	<i>Raportimi i të dhënave rreth trajnimit vjetor 2007</i>	<i>dhjetor</i>			
	<i>Përgatitja e broshurave për punën e sektorit</i>	<i>Nent-dhjetor</i>	<i>200 €</i>		
	<i>Trajnime lëndore</i>	<i>Prill-nen</i>	<i>20.000 €</i>		
	<i>Bashkëpunimi me me koordinatore të Fakultetit të Edukimit- trajnimitin e mësimdhënësve mentor</i>	<i>Mars</i>	<i>5.000 €</i>		
<i>Bashkëpunimi dhe koordinimi i trajnimeve me zyrat rajonale</i>	<i>Janar-dhjetor</i>				

❖ **Sektori i arsimit të përgjithshëm**

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja financiare	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/ Sfidat
Edukim të barabartë për të gjithë pa dallim etnie; Ngritja e cilësisë; Bashkëpunimi ndërinstitucionale	<i>Bashkëpunimi me KEDP (Komitetin Drejtues të Projektit, KAGSH, ZRA, DKA dhe shkollat në përgjithësi)</i>			SAP	<i>Vazhdimi i reformës shkollore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversita r; Monitorim i procesit mësimor;</i>	<i>Zvogëlimi i donacioneve në Kosovë dhe mospërfshirja e gjithë komunitetit. Mungesa e përsosurisë të kualifikuar mësimor; Mungesa e mjeteve financiare;</i>
	<i>Analiza e suksesit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë dhe përfundim të vitit shkollor</i>			SAP		
	<i>Lëvizja e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë dhe të dytë</i>			SAP		
	<i>Vizita në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës, speciale dhe private</i>			SAP		
	<i>Programet dhe planet mësimore dhe implementimi i tyre</i>			SAP		
	<i>Hartimi i dokumentacionit shkollor, ende të papërfunduar</i>			SAP		
	<i>Punë në komisione të ndryshme brenda Departamentit dhe MASHT-it dhe bashkëpunimi me Ministrinë tjera</i>			8400 €		
<i>Vizitë pune në Shqipëri, Maqedini, Bosnje e vende tjera me karakter informativ dhe bashkëpunimi</i>				SAP		

I; Hartimi i programeve të përbashkëta; Vetëdijësimi i nxënësve nga rreziku; Vlerësim sistematik; Infrastruktura ligjore	Organizimi i intervistave, kontratave për drejtorë dhe zv.drejtorë me rastin e skadimit të kontratave			SAP	Zgjedhje e kuadrove cilësore dhe zbatim i procedurës ligjore; Masovizimi i arsimit në diasporë; Rezultate cilësore dhe kosto më të lirë;	Mungesa e komunikimit me shtetet e rajonit dhe më gjerë; Moszbatimi i i plotë i rregullores së KSHAM-it lidhur me trajnimin dhe licencimin e personelit arsimor.
	Aktivitetet e ndryshme rreth parandalimit të braktisjes së shkollës		1000 €	SAP		
	Analiza e suksesit dhe vështirësitë në sferën e arsimit (tribuna dhe debate)			SAP		
	Bashkëpunimi ndërsektorial dhe në mes të njësive për specifika të veçanta			SAP		
	Hartimi i programit të edukimit parashkollor dhe vërejtjet e sygjerimet nga terreni		23000 €	SAP		
	Përgatitja dhe mbajtja e Olimpiadës „Lojërat pa kufij dhe aktivitete tjera të kësaj fushe			SAP		
	Puna në hartimin e kurrikulës së re të arsimit plotësisht në Diasporë dhe hartimi i komisioneve për hartimin e teksteve të reja shkollore		50000 €	SAP		
	Bashkëpunimi ndërministror Kosovë,Shqipëri,Maqedoni dhe institucione tjera relevante për Diasporën në përgjithësi		20000 €	SAP		
	Organizimi i seminarit profesional me mësuesit e Diasporës gjatë pushimeve			SAP		
	Vizitë shkollave në Diasporë dhe insitucioneve shtetërore arsimore për zgjerimin e rrjetit shkollor		5000 €	SAP		
	Punë në licencimin dhe organizimin e institucioneve të arsimit privat			SAP		
	Vlerësimi sistematik i punës së njësive, punëtorëve dhe drejtorëve e zv.drejtorëve të shkollave dhe përpjekjet për implementimin e Rregullores së KSHAM-it për licensimin e mësimdhënësve			SAP		
	Puna në hartimin e legjislacionit arsimor në përgjithësi dhe ndërrimi i ligjit në fuqi aty ku nuk mund të zbatohet		1500 €	SAP		
	Bashkëpunimi me Qeverinë, Parlamentin, Ministrinë e Financave dhe donatorët për zgjerimin e infrastrukturës shkollore, sidomos shkollat që punojnë në tri ndërrime		5000 €	SAP		
Punë në finalizimin e Strategjisë në Arsimin Parauniversitar			SAP			

✚ Sektori i arsimit profesional

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja financiare	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/Sfidat
Ngritja e cilësisë në arsimin	Rishikimi i planprogrameve për të gjitha profilet e AP	Janar-prill	40.000€			
	Pregatitja e provimeve përfundimtare,11,12 dhe 13-të	Janar-prill	40.000€			

profesional(plan programeve,vlerësimët. Themelimi i I Këshillit të Arsimit dhe Aftësimët Profesional. Zhvillimi I Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare të Kosovës. Miratimi i ligjit per Kualifikime nga Kuvendi i Kosovës. Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të Arsimit jo formal. Hartimi i Strategjisë së Ndërmarrësisë Hapja e Zyres Qendrore për firmat ushtrimore	Diskutimet publike lidhur me rishikimin dhe vlerësimin	maj	35.000€	SAP-GTZ Sektori i Arsimit Profesional	Përfundimi i Programeve dhe vlerësimeve të kl 11,12 dhe 13-të; Funksionimi i KAAP; Hapja e Zyres Qendrore per firma ushtrimore Hartimi i Strategjisë për Ndermarresi. Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm të arsimit joformal	Buxheti, Administrata dhe personeli,
	Legjisllacioni:U.A. për provimet përfundimtare,U.A. për formimin e këshillit të AAP, U.A. për funksionimin e KAAP,Modifikimi i ligjit per Kualifikime,U.A.për futjen e udhezimeve ne karrierë në kuadër te planprogrameve,	Janar,shkurt ,qershor.Korrik	5.000€			
	Procesi i implementimit të planprogrameve të rishikuara për kl.11,12 dhe 13-të(trajnimi i mësimeve),	Qershor - Korrik	3000€			
	Formimi i këshillit të Arsimit dhe Aftësimët Profesional dhe veprimi i tij ne vitin 2007 si vit provues.	Shkurt - dhjetor	80.000€			
	Redaktura,lektorimi dhe botimi i planprogrameve.	Shkurt - Prill	35.000€			
	Harmonizimi i punëve me ZRA-të dhe ngritja e stafit profesional.	janar- dhjetor	5000€			
	Aktivitete rreth regjistrimit të nxënësve në shkolla profesionale	Prill,maj				
	Bashkërenditje e punës me ZRA dhe ngritja e stafit profesional	Janar - Tetor	2000€			
	Vazhdimi i projekteve me partnerët e arsimit profesional (GTZ, SwissContact, KosVET, Kultur Kontakt, Norgesvele, Sida, ...)	Jan - Dhjetor	20.000€			
	Punëtorja lidhur me Kornizën e Kualifikimeve Kombëtare	qershor	10.000€			
	Raportet javore, mujore dhe vjetore	Janar - Dhjetor				
	Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore (trajtime , vizita studimore, pjesëmarrje në konferenca vendore dhe ndërkombëtare etj)	Janar- Dhjetor	Donatorët + MASHT-4000€			
	Hapja e firmave te reja ushtrimore neper SHP	Janar - Dhjetor	Donatorët			
	Strategjia për Ndërmarrësi	Janar - Dhjetor	5.000€+Donatorët			
	Aktivitete rreth arsimit joformal	Jan - Dhjetor	30.000€			
	Jan -Dhjetor	20.000€				
	❖ Zhvillimi i teksteve shkollore për arsim joformal					

❖ **Sektori për komunitete dhe çështje gjinore**

Objektivat	Aktivitetet e planifikuara	Afati	Kostoja	Përgjegjësia	Rezultatet e pritshme	Vështirësitë
Integrimi i komunitetit RAE	Mësimi intensiv në 9 komuna,monitorimi, administrata, testi vlerësues, koordinimi, raportimi,hartimi i strategjisë për integrim të komunitetit RAE në pjesëmarrje në mbledhje dhe punëtori për integrim	Tetor ,07 korrik - 08	90.000 Euro	MASHT,	545 nxënës do të kryejnë nga dy klasa gjatë një viti shkollor	Rrogat e arsimtarëve

<i>Sigurimi i teksteve</i>	<i>Përkthimi i teksteve nga gjuha shqipe në gjuhët boshnjake dhe turke për klasat 3, 4 dhe 8, lekturimi, shtypja, redaktimi</i>	<i>Dhjetor – nëntor</i>	<i>50000 €</i>	<i>MASHT</i>	<i>Pajisja e nxënësve të klasave të 3, 4 dhe 8 –a me tekste sipas planit dhe programit të ri</i>	<i>Vonesë në përkthimin,</i>
<i>Sigurimi i teksteve</i>	<i>Shpallja e konkursit për tekste për grupet nacionale të lëndëve. Recenzimet lekturimi, shtypja për lëndët e grupeve njënacionale (gjuhë boshnjake, turke, histori, edukatë figurative dhe muzikore)</i>		<i>72000€</i>	<i>MASHT, Sektori për komunitete</i>		
<i>Përsosja dhe lehtësimi i procesit arsimor</i>	<i>Sigurimi i lektyrës dhe planeve e programave mësimore për profesorët e shkollave në gjuhën boshnjake Përkthimi i planeve dhe programeve mësimore për profesorët, lektura, korrekturadhe shtypja</i>	<i>Janar 2007 – shtator 2007</i>	<i>6.000€</i>	<i>MASHT, , “Libri Shkollor”</i>	<i>Mësimi më cilësor në bazë të planeve dhe programeve mësimore</i>	<i>Buxheti, vonesa e përkthimeve, shtypja</i>
<i>Ngritja e cilësisë</i>	<i>Identifikimi i nevojave përcaktimi i prioriteteve, Mbledhjet me partnerë</i>	<i>2007</i>		<i>MASHT,</i>	<i>Aftësimi i arsimtarëve. Përmirësimi i kushteve të punës</i>	
<i>Aftësimi i arsimtarëve</i>	<i>Trajnimi i arsimtarëve për mendimin kritik, lexim dhe shkrim: për boshnjakë dhe turq Formimi i 3 (2+1)grupeve me nga 30 arsimtarë</i>	<i>2007</i>	<i>10250 €</i>	<i>MASHT, KEC, DKA, ZRA</i>	<i>Përmirësimi i kualitetit të mësimit dhe zbatimi i metodave të reja</i>	
<i>Projekt multietnik</i>	<i>Identifikimi i nxënësve të moshës parashkollore Kurse kundër analfabetizmit me vajza dhe gra</i>	<i>2007</i>	<i>7200€</i>	<i>MASHT, OJQ</i>	<i>Dinë të lexojnë dhe të shkruajnë</i>	<i>Motivim i pamjaftm</i>
<i>Arsimimi komunitetit</i>	<i>Trajnimet me arsimtar dh nxënës, programet sportive, kurse të ndryshme Vizitë shkollave në të cilat mësojnë përfaqësues të komuniteteve të ndryshme, monitorimi Hapja e grupeve të lëndëve në Fakultetin e edukimit në Prizren në gjuhën boshnjake dhe turke</i>	<i>2007</i> <i>2007/8</i>	<i>7500€</i>	<i>MASHT, UNICEF, OSBE Sektori për komunitete Departamenti i arsimit</i>	<i>Krijimi i marrëdhënie tolerante ndërnrjerëzore, Efikasiteti dhe efektiviteti i procesit arsimor Kuadri i kualifikuar mësimor për lëndët deficitare</i>	

❖ **Zyra për Drejtat e Njeriut**

<i>Objektivat</i>	<i>Aktivitet e planifikuara</i>	<i>Afati</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e</i>	<i>Sfidat</i>
<i>Promovimi i barazisë gjinore</i>	<i>Botimi i doracakëve për barazi gjinore për</i>	<i>Shkurt</i>		<i>MASHT</i>	<i>Ngritja e cilësisë në mësim</i>	
<i>Promovimi i barazisë gjinore në UP</i>	<i>Aktivitete për integrimin e barazisë gjinore në UP</i>	<i>Mars</i>		<i>MASHT</i>	<i>Krijimi i njësisë akademike të grave në UP</i>	
<i>Ngritja e vetëdijes për barazi gjinore</i>	<i>Organizimi i trajnimeve për edukatore te nivelit parashkollor dhe mësimdhënësit e arsimit fillor</i>	<i>Mars-prill</i>		<i>MASHT</i>	<i>Aftësimi i mësimdhënësve për integrimin e barazisë gjinore</i>	

	<i>Organizimi i javës se arsimit për të gjithë</i>	<i>Prill 2007</i>		<i>MASHT</i>	
<i>Shënimi i datave që promovojnë të drejtat e njeriu</i>	<i>Organizimi i 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të gruas</i>	<i>Mars 2007</i>		<i>MASHT</i>	<i>Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të gruas</i>
<i>Ngritja profesionale e mësimitdhënësve</i>	<i>Organizimi i trajnimeve për mësimitdhënësit që zbatojnë lenden “ Aftësitë për jetën “</i>	<i>Janar-shkurt 2007</i>		<i>MASHT UNICEF</i>	<i>Aftësimi i mësimitdhënësve për lëndën“ Aftësitë për jetë”</i>
<i>Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore</i>	<i>Organizimi i aktiviteteve për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore</i>	<i>Maj 2007</i>		<i>MASHT</i>	<i>Ngritja e vetëdijes për dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore</i>
<i>Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore</i>	<i>Vazhdon faza e dytë e projektit për ngritjen e vetëdijes për trafikimin me qenie njerëzore</i>	<i>Qershor 2007</i>		<i>IOM</i>	<i>Trajnimi i drejtorëve dhe mësimitdhënësve te shkollave</i>
<i>Ngritja e vetëdijes së fëmijëve për të drejtat e tyre</i>	<i>Botimi i Konventës për Drejtat e Fëmijëve 5)</i>	<i>Tetor – nëntor,</i>		<i>MASHT</i>	<i>Rritja e njohurive të fëmijëve dhe nxënësve për drejtat e tyre</i>
<i>Shënimi i festave ndërkombëtare për të DNJ</i>	<i>Aktivite të ndryshme për festat ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut</i>	<i>Nëntor-Dhjetor</i>		<i>MASHT</i>	<i>Shënimi i festave të ndryshme</i>
	<i>Organizimi i Olimpiadës së Fëmijëve</i>	<i>M-qershor</i>		<i>MASH</i>	
<i>Punësimi i këshilltarit për të drejtat e fëmijëve</i>	<i>Bashkëpunimi i ngushtë me këshilltarët për të drejtat e fëmijëve në kuadër të shkollave</i>	<i>Janar, Nëntor</i>		<i>MASHT</i>	<i>Rritja e rolit të Këshilltarëve për DF në shkolla</i>
<i>Parandalimi i punës së fëmijëve</i>	<i>Puna në grupin ndërministror për parandalimin e punës së rëndë të fëmijëve</i>	<i>Prill-maj</i>		<i>Grupi ndërministror</i>	<i>Adresimi në problemit të punës së rëndë të fëmijëve</i>
<i>Parandalimi i trafikimit të fëmijëve</i>	<i>Puna në grupin ndërministror për parandalimin e trafikimit të fëmijëve</i>	<i>Shkurt-mars</i>		<i>Grupi ndërministror</i>	<i>Trajtimi i problemit të trafikimit</i>
<i>Raportimi për konventat ndërkombëtare</i>	<i>Raportimi për Konventën për Drejtat Ekonomike , Sociale dhe Kulturore</i>	<i>Deri në mars 2007</i>		<i>MASHT</i>	
<i>Raportimi për konventat ndërkombëtare</i>	<i>Raportimi për Konventën për Drejtat Minoriteteve</i>	<i>mars</i>		<i>MASHT</i>	<i>Raportimi i aktivitetet të MASHT-it</i>

Spektori për koordinim me komuna

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja	Përgjegjësi	Rezultatet e pritura	Vështirë
Bashkërendimi i aktiviteteve MASHT-KPAK Ngritja e cilësisë në arsim përmes bashkëpunimit shkollë-familje Vetëdijësimi i arsimtarëve dhe komunitetit për rëndësinë e partneritetit në edukim	Mbledhja e të dhënave për suksesin e nx. në gjysmëvjetorin e parë (2006/07) dhe gjysmëvjetorin e dytë	Janar –shtator		SKK	Mbajtja e Mbledhjeve të Rregullta tëKPAK Ndihma e prindërve vullnerat në aktivitetet që organizon shkolla	
	Mbledhje te rregullta me KPAK-në	Jan - Dhjetor	30.000€	SKK		
	Mbledhje informative me drejtorë shkollash për rëndësinë dhe aktivitetet e KPASH-së -vizitë pune shkollave	Janar - Shkurt		SKK		
	Hartimi dhe shpërndarja e një formulari për regjistrimin e prindërve vullnetarë në shkollë	Prill - Dhjetor		SKK		
	Bashkërendim i punëve me ZRA dhe DKA për regjistrimin e nxënësve	Jan - Dhjetor	40.00€	SKK		
	Trajnimeve me prindër dhe arsimtarë-Partneriteti në edukim	Qersh - Gusht		SKK		
	Bashkërendim i punëve me ZRA dhe DKA për regjistrimin e nxënësve	Jan - Dhjetor		SKK		
	Bashkëpunimi me OJQ	Jan - Dhjetor		SKK		
	Përgatitjet për vitin e ri shkollor 2007/08	Shtator		SKK		

❖ DEPARTAMENTI I ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/
Licencimi i patentave dhe përfitimi i inovatorëve; Integrimi i plotë në sistemin e Bolonjës; Menaxhim më i mirë i IAL; Integrimi i Arsimit të lartë	Formimi i bordit të AAK-së;konkursi për personelin profesional dhe administrativ të AAK-së; Trajnimi i anëtarëve vendorë të Bordit të AAK-së)	-I-VI-	100.000 €	DALSH/MASHT		Mungesa e ekspertizës; Mungesa e mjeteve Themelohet AAK; fillon akreditimi; Ekziston QTT dhe vepron; Përmirësohet et implementimi i
	Themelimi i QTT-së ;konkursi për drejtor, personelin profesional dhe administrativ, si dhe trajnimi i stafit të zgjedhur	-VI-	100.000 €	DALSH		
	Themelimi i Qendres Kosovare për Arsim të Lartë, Hulumtim dhe Teknologji Ndërkombëtare	-V-VII		DALSH		
	Themelimi i Këshillit Qendrorë të Shkencës	-I-III		DALSH		
	Bashkëpunimi me njësitë akademike të UP-së	-I-XII-				
	Ndihmë financiare për botimin e revistave shkencore		28200 €			
	Vazhdim i punës së „Grupit të Dublinit" për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve si dhe për, „Kornizën konceptuale për udhëzime në karrierë"	-I-XII-	24.000 €			
	Vizita të ndryshme të zyrtarëve të DALSH në IAL dhe BrAL		7500 €			

<p>në sistemin evropian të shkollimit ; Zhvillimi ekonomik;</p> <p>Ngritja e cilësisë së studimeve . Qasje e AL në hulumtim dhe teknologji ndërkombëtare</p>	<i>Njohja (nostrifikimi) e dokumenteve të institucioneve të jashtme të AL</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>DALSH</i>	<p><i>Bolonjës;</i> <i>Ngritet cilësia e kërkimeve shkencore;</i> <i>Rregullohet funksionimi i sektorit privat të AL</i></p>
	<i>Ndarja e bursave për studentet që studiojnë jashtë vendit</i>	<i>-X-XII-</i>	<i>50.000€</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Trajnimi i anëtarëve të komisionit për nostrifikim si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me ENIC/NARIC Austria</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>DALSH</i>	
	<i>Hartimi dhe dorëzimi i raportit për funksionimin e BprAL-ve</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>DALSH</i>	
	<i>Bashkëpunimi me donatorë (Zyra Amerikane Austriak,e, etj.)</i>	<i>-VI-VII-të</i>	<i>100.000€</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Projekti i Promovimit të procesit të Bolonjës</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>8.850€</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Partneritet me Tempus, WUS, Banka Botërore, USAID, etj. për sigurimin e mjeteve për mbështjeten financiare të AAKdhe QITT-së</i>	<i>-III-XII-</i>	<i>28.200€</i>		
	<i>Aktivitetet të DALSH-it lidhur me çështjet studentore</i>	<i>-X-</i>	<i>2.000 €</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Vizita studimore të stafit të DALSH-it në vendet e jashtme</i>	<i>-IX-</i>	<i>3000 €</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Binjakëzimet e Universitetit dhe ose fakulteteve të UP-së me ato në rajon</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Stimulimi i IAL për përtëritjen e kuadrut dhe për ngritjen e cilësisë</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>10.00€</i>	<i>DALSH</i>	
	<i>Përgatitjet për regjistrimin e studentëve në vitin akademik 2007/08</i>	<i>-VI-X-të</i>	<i>2.000€</i>	<i>DALSH</i>	

DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCEVE

❖ Sektori i buxhetit dhe financave

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi</i>	<i>Afati</i>	<i>Çmimi</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet</i>	<i>Vështërsitë</i>
	<i>- Formulimi i planit për rrjedhën e parasë</i>	<i>Janar</i>		<i>SBF</i>		
<i>Hartimi i buxhetit vjetor</i>	<i>- Hartimi i raportit vjetor financiar dhe raporteve periodike</i>	<i>Janar, Prill, Korrik, Tetor</i>		<i>SBF</i>	<i>Dokumenti i raportit</i>	
	<i>Zotimi i mjeteve buxhetore</i>	<i>Jana- Dhjetor</i>		<i>SBF</i>	<i>Fletë zotimet</i>	
	<i>Përgatitja e lëndëve për pagesa</i>	<i>Jan- dhjetor</i>		<i>SBF</i>		
<i>Menaxhimi i buxhetit të v 2007</i>	<i>Takime pune me zyrtarët përgjegjës të njërive buxhetore lidhur me kërkesat e para buxhetore</i>	<i>Prill</i>		<i>SBF</i>		
	<i>Hartimi i kërkesave të para buxhetore, futja e të dhënave në sistem të thesarit (MEF)</i>	<i>Maj- Qershor</i>		<i>SBF</i>	<i>Formularët PCF dhe të PIP</i>	
	<i>Mbushja e arkës dhe zbraza sipas procedurave në fuqi</i>	<i>Shk-Dhjetor</i>		<i>SBF</i>		
	<i>Çertifikimi i pagesave</i>			<i>SBF</i>		
	<i>Tërheqja dhe kthimi i avancave</i>	<i>Shk Dhjet.</i>		<i>SBF</i>		
	<i>Hartimi i buxhetit për vitin 2008</i>	<i>Sht-dhjetor</i>		<i>SBF</i>	<i>Dokumeti i buxhetit vjet.</i>	
	<i>Bashkëpunimi me njësitë buxhetore</i>	<i>Jan. dhjetor</i>		<i>SBF</i>		

❖ **BUXHETI I
PLANIFIKUAR PËR
vitin. 2007**

<i>NJËSITË BUXHETORE</i>	<i>SHUMA E BUXHETIT TË PLANIFIKUAR</i>	<i>% e Pjesëmarrjes</i>	<i>Nr. i punëtorëve</i>
<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	
<i>Universiteti I Prishtinës</i>	<i>12,253,571.00</i>	<i>35.7</i>	<i>1955</i>
<i>Qendra e Studentëve</i>	<i>1,962,153.00</i>	<i>5.7</i>	<i>249</i>
<i>Institetet</i>	<i>1,059,067.00</i>	<i>3.1</i>	<i>94</i>
ARSIMI I LARTË	15,274,791.00		
<i>Biblioteka Kombëtare-Universitare</i>	<i>668,039.00</i>	<i>1.9</i>	<i>105</i>
<i>Arsimi Special</i>	<i>1,642,647.00</i>	<i>4.8</i>	<i>260</i>
<i>Trajnimet</i>	<i>240,000.00</i>	<i>0.7</i>	<i>0</i>
<i>Planprogramet</i>	<i>961,000.00</i>	<i>2.8</i>	<i>0</i>
ARSIMI TJETËR	3,511,686.00		
<i>Administrata Qendrore</i>	<i>15,105,456.00</i>	<i>44.1</i>	<i>240</i>
<i>Zyra e Ministrisë</i>	<i>147,906.00</i>	<i>0.4</i>	<i>9</i>
<i>Marrëveshjet bilaterale</i>	<i>250,000</i>	<i>0.7</i>	
ADMINISTRATA ARSIMORE	15,253,362.00		
MASHT-I	34,289,839.00	100.0	2912
<i>Pagat dhe meditet</i>	<i>9,872,000.00</i>		
<i>Mallrat dhe shërbimet</i>	<i>5,925,272.00</i>		
<i>Shpenzimet e komunalisë</i>	<i>1,771,000.00</i>		
<i>Investimet kapitale</i>	<i>16,721,567.00</i>		

Sektori i administratës

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja	Përgjegjësia	Rezultatet e	Vështirësitë/
	<i>Kompletimi me kuadro në MASHT, sipas organogramit</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>		<i>Sektori i administratës</i>		
	<i>Trajnimi i kuadrave dhe adaptimi i tyre në zvillimin e reformave</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Vlerësimi i punës së të punësuarëve në MASHT</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Harmonizimi i vendeve të punës me koeficient për pages të punëtorëve</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Harmonizimi i pushimeve vjetore</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Raportet e punës tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor</i>	<i>Mars; Qer; Dhj.</i>				
	<i>Vlerësimet e punës pas periudhës tremujore</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Shqyrtimi dhe përgatitja e materialeve për publikimin e konkurseve</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Përgatitja e kontratave</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Përgatitja e vendimeve për punë jashtë orarit</i>	<i>Jan - Dhjetor</i>				
	<i>Konsultimet dhe këmbimi i përvojave me zyrtarët administrativ ZRA-ve</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Rishikimi dhe plotësimi i përshkrimeve të vendeve të punës</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				

❖ Sektori për informim dhe marrëdhënie me publikun

Objektivat	Veprimi/Aksioni	Afati kohor	Kostoja financiare	Përgjegjësia	Rezultatet e pritura	Vështirësitë/ Sfidat
<i>Komunikimi i rregullt me publikun dhe mediat-transparenca; Krijimi i bazës së të dhënave; Publikimi – afirmimi i të arriturave të MASHT</i>	<i>Monitorimi i shtypit, kontakte me gazetarë</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>3500 €</i>	<i>SIMP</i>	<i>Krijimi i besueshmërisë në opinion; Lehtësimi i punës në marrjen e të dhënave të arkivuara. Shfrytëzimi i tyre sipas nevojës; Prezentimi i punës së MASHT, sukseseve, të</i>	<i>Mungesa e mjeteve financiare e, dezinformatat-shkrimet tendencioze keqinterpretimet nga ana e disa përfaqësuesve të mediave; Problemet teknike.</i>
	<i>Furnizimi i web-faqes me informacione</i>	<i>Jan- Dhjetor</i>	<i>5000 €</i>			
	<i>Përcjellja e aktiviteteteve të ministrit</i>	<i>Jan- Dhjetor</i>	<i>-</i>			
	<i>Përcjellja e takimeve, seminareve, konferencave, tryezave të ndryshme</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>2000 €</i>			
	<i>Përgatitja e informatave javore</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>-</i>			
	<i>Bashkëpunim me TV (emisione edukativo-arsimore)</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>4000 €</i>			
	<i>Regjistrimi i materialeve audio-vizuele</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>4000 €</i>			
	<i>Përgatitja e planit javor të departamenteve dhe sektorëve të MASHT</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>				
	<i>Ndjekja e trajnimeve të ndryshme</i>	<i>Gusht - Dhjetor</i>	<i>6000 €</i>			
	<i>Ndjekja e trajnimeve të ndryshme</i>	<i>Gusht - Dhjetor</i>				
<i>Publikimi i aktiviteteteve kryesore të MASHT në gazetën "Shkëndija"</i>	<i>Jan – Dhjetor</i>					
<i>Planifikimi i punës tremujore dhe përgatitja e raporteve javore</i>	<i>Jan – Dhjetor</i>	<i>200 €</i>				

	<i>Bashkëpunim me zyrat e informimit të institucioneve të ndryshme</i>	<i>Janar- Dhjetor</i>	<i>3000 €</i>		<i>arriturave etj.</i>	
	<i>Botimi i buletinit të MASHT në etapa të ndryshme kohore</i>	<i>Maji; Shtator</i>	<i>2000 €</i>			
	<i>Shpërndarja elektronike e artikujve të arsimit për zyrtarët e MASHT</i>	<i>Janar - Dhjetor</i>	<i>3000 €</i>			
	<i>Prezantime të aktiviteve të MASHT</i>	<i>Shkurt – shtator</i>	<i>3500 €</i>			

✚ DEPARTAMENTI I PROKURIMI

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi/Aksioni</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e</i>	<i>Vështirësitë/</i>
<i>Zbatimi i ligjit të prokurimit 2003/17; Përgatitja në mënyrë profesionale të gjithë dokumentacionit, formularëve që kërkohet gjatë zbatimit të procedurave për prokurim; furnizim, shërbime, shërbime të konsulentëve, Konkurs projektimi, punë, punë me koncesion, pasuri e paluajtshme; Formimi i komisioneve me ekspert të profileve përkatëse si dhe vlerësimi i operatorëve ekonomik në bazë të kriterëve të kërkuara</i>	<i>Përgatitja e dokumentacionit për kuotim të çmimeve deri në vlerën 500 euro</i>	<i>Jan-qershor; Nëntor</i>	<i>2000€</i>	<i>Departament i i prokurimit</i>	<i>Zbatimi i procedurave të prokurimit për realizimin e tenderëve të paraqitura në planifikimin përfundimtar të prokurimit; Ndërtimi i shkollave të cilave u është dhënë prioritet do të bashkëngjitet lista me emra të shkollave dhe me vlerë; Ndërtimi i objekteve: bashkëngjitet lista me emra dhe me vlerë</i>	<i>Mungesë e stafit; Mungesë e zyrës për arkivimin e dokumentacionit.</i>
	<i>Përgatitja e dokumentit standard deri në vlerën 10.000 euro</i>	<i>Shk - Dhjetor</i>				
	<i>Përgatitja e dokumentit tenderik për të gjitha procedurat e prokurimit</i>	<i>Janar – Dhjetor</i>				
	<i>Hapja e ofertave sipas datave të parapara në dokumentacion</i>	<i>Shkurt – Dhjetor</i>				
	<i>Formimi i komisioneve vlerësuese</i>	<i>Shk-Dhjetor</i>				
	<i>Mbajtja e evidencës për lëndët të cilat prokurohen</i>	<i>Jan - Dhjetor</i>				
	<i>Kompletimi i dosjes së tenderëve për të gjitha lëndët</i>	<i>Ja - Nëntor</i>				
	<i>Njoftimi publik i ftesës për tenderë</i>	<i>Janar Dhjetor</i>				
	<i>Njoftimi publik për dhënie të kontratës</i>	<i>Jan – Dhjetor</i>				
	<i>Kompletimi i lëndëve dhe përcjellja në financa për pagesë</i>	<i>Janar; Mars – Prill; Qer-Dhj.</i>				

✚ DEPARTAMENTI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE TEKNIKE

❖ Sektori i infrastrukturës

<i>Objektiva</i>	<i>Aktivitet e planifikuara</i>	<i>Afati</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgj</i>	<i>Rezultatet</i>	<i>Vështirësitë /</i>
	<i>Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për renovim dhe zgjerim.</i>	<i>Janar</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		
	<i>Përcaktimi i prioritetëve për investime në renovim dhe zgjerim të shkollave.</i>	<i>J-shkurt,</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		<i>Kuadri dhe koordinimi me DKA</i>

Ngritja e cilësisë së infrastrukturës shkollore	<i>Hartimi i standardeve te projekteve për ndërtimin e objekteve shkollore</i>	<i>J. Nëntor</i>	<i>35,000.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>Ekspertet nga Buxheti</i>
	<i>Punimi i një programi (bazë e të dhënave) për objektet shkollore si: Viti i Ndërtimit, viti i renovimit, Incizimi i gjendjes ekzistuese (</i>	<i>Janar-Qershor</i>	<i>5,000.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>/</i>
	<i>Menaxhimi i pasurisë shkollore (hapësirat shkollore – objektet, dhe menaxhimi i hapësirës se lirë te shkollës - patundshmëria).</i>	<i>Janar-Dhjetor</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		<i>Koordinimi MASHT-DKA</i>
	<i>Mbledhja e te dhënave nga Komunat për ndërtimin e objekteve te reja shkollore-kërkesat.</i>	<i>Janar-Mars</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		<i>/</i>
	<i>Përpilimi i listës prioritare për ndërtimin e objekteve te reja shkollore.</i>	<i>J qershor</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		<i>/</i>
	<i>Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacioneve dhe i projekteve me paramasa dhe paralogarit për objektet shkollore.</i>	<i>Janar-Mars</i>	<i>10,000.00 €</i>	<i>Infras</i>		<i>Buxheti</i>
	<i>Vlerësimi dhe përgatitja e materialeve për tenderim.</i>	<i>Sh Mars</i>	<i>8,000.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>Mungesa e projekteve</i>
	<i>Mbikëqyrja dhe inspektimi i punëve ndërtimore në objekte shkollore.</i>	<i>J.Dhjetor</i>	<i>50,000.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>Buxheti</i>
	<i>Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacioneve dhe i projekteve me paramasa dhe paralogarit për objektet shkollore.</i>	<i>Qershor-Shtator</i>	<i>9,500.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>Mungesa e projekteve dhe buxheti</i>
	<i>Mbikëqyrja e investimeve kapitale për ndërtimin e objekteve të veçanta.</i>	<i>J.Dhjetor</i>	<i>25,000.00€</i>	<i>Infras</i>		<i>Kuadri dhe buxheti</i>
	<i>Rregullimi i hapësirës shkollore për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.</i>	<i>J Dhjetor</i>	<i>150,000.0 0€</i>	<i>Infras</i>		<i>Projektet dhe mungesa buxhetore</i>
	<i>Inspektimi i të gjitha objekteve shkollore private.</i>	<i>J.Dhjetor</i>	<i>/</i>	<i>Infras</i>		<i>/</i>
<i>Përgatitja e projekteve tipike për shkollat fillore dhe të mesme si: 5 klasë, 9 klasë, 12 klasë, 16klasë, 24 klasë. etj</i>	<i>Janar-Qershor</i>	<i>350,000.0 0€</i>	<i>Infras</i>		<i>Buxheti</i>	

➤ **Sektori për mbështetje teknike 2007**

<i>Objektivat</i>	<i>Veprimi/Aksioni</i>	<i>Afati</i>	<i>Kostoja</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Rezultatet e pritura</i>	<i>Sfidat</i>
<i>Evitimi i problemeve që kanë të bëjnë me Teknologjinë Informative</i>	<i>Rregullimi i kompjuterëve dhe i printerëve sipas nevojës</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>10.000€</i>	<i>Njësa e TI</i>	<i>Krijimi i kushteve të mira për punë, komunikim më të shpejtë ndërministror</i>	
	<i>Kontrollimi dhe mirëmbajtja e rrjeti të Internetit</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Publikimi i Web faqes me të dhëna të reja</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Instalimin e softverve të ndryshëm varësisht prej kërkesave</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Rregullimin e zërimit në dhomën e takimeve</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Mirëmbajtja dhe rilokimi i telefonave</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Rregullimin e INTRA-NET-it</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Trajnimi i stafit të TI.</i>	<i>-I-XII-</i>				
<i>Realizimi i transportit të zyrtarëve të</i>	<i>Sigurimi i transportit për zyrtarët e MASHT-it</i>	<i>-I-XII-</i>		<i>Nj. e Transportit</i>	<i>Mirëmbajtja e veturave, sigurimi i transportit për punën</i>	
	<i>Sigurimi i transportit për ekspertët vendor dhe ndërkombëtar</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Regjistrimin e të gjitha automjeteve që posedon MASHT-i</i>	<i>-I-XII-</i>				
	<i>Servisimi i rregullt i të gjitha automjeteve që posedon MASHT-i</i>	<i>-I-XII-</i>				

<i>MASHT-it</i>	<i>Nxjerrja e kilometrave, shpenzimeve të derivateve të naftës, si dhe përcjelljen e faturave të servisimit</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>205.000€</i>		<i>e zyrtarëve në terren</i>
	<i>Kontrollimin e automjeteve dhe auto parkut</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Blerja e dy veturave për nevojat e MASHT-it</i>	<i>-I-XII-</i>			
<i>Sigurimi i materialit harxhues</i>	<i>Pranimi i materialit hargjues dhe shpërndarja e tij sipas kërkesave</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>40.000€</i>	<i>Nj. e Furnizimit</i>	<i>Furnizimi i depos, pranimi i dhe shpërndarja e materialit harxhues tek zyrtarët e MASHT</i>
	<i>Furnizimi i depos me material harxhues</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Mirëmbajtja e depos</i>	<i>-I-XII-</i>			
<i>Krijimi i kushteve të mira për punën e Zyrtarëve të MASHT-it</i>	<i>Mirëmbajtja e objektit të MASHT-it (mirëmbajtja e rrymës elektrike, e ashensorit, gjeneratorit, ujit, nxemjes qëndrore)etj.</i>	<i>-I-XII-</i>	<i>150.000€</i>	<i>Nj. e invent. dhe mirëmbajtjes</i>	<i>Krijimi i kushteve të mira për punë të zyrtarëve të MASHT-it Mirëmbajtja dhe menaxhimi i inventarit</i>
	<i>Përcjellja, inspektimi dhe regjistrimi i inventarit, punimi i barkodeve dhe vënia e tyre</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Regjistrimi i të dhënave të pasurisë në programin e Free-balancit</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Akomodimi i punëtorëve nëpër zyra sipas nevojës</i>	<i>-I-XII-</i>			
	<i>Krijimi I hapsirave për zyrtarët e MASHT-it</i>	<i>-I-XII-</i>			

KAPITULLI I DYTË

RAPORTI I PUNËS SË MASHT-it PËR VITIN 2007

🚧 Aktivitetet e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë z.Agim Veliu

MASHT, përkundër sfidave dhe mundësive, gjatë vitit 2007 vazhdoi punën në funksion të konsolidimit të sistemit arsimor në bazë të trendeve europiane, reformave në drejtim të ngritjes së cilësisë, por edhe të arritjes së synimeve dhe objektivave të parapara, konform strategjive të përcaktuara e të miratuara në Kuvendin e Kosovës dhe programit të Qeverisë së Kosovës.

MASHT ka punuar në bazë të planit vjetor të punës si dhe sipas prioriteteve që i ka përcaktuar Qeveria e Kosovës për fushën e arsimit.

Ndër prioritetet e MASHT-it në të cilat është punuar me përkushtim e përgjegjësi, ishin: vazhdimi i implementimit të standardeve, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, ngritja e cilësisë së mësimi, përfundimi i Strategjisë së Arsimit Parauniversitar, thellimi i bashkëpunimit me donatorët e partnerët e arsimit kosovar, sigurimi i kushteve për arsimimin e minoriteteve dhe integrimi i tyre në sistemin arsimor të Kosovës, etj.

Ndër aktivitetet që shënojnë këtë periudhë të punës janë edhe: raportimi për gjendjen në arsimin parauniversitar në Kuvendin e Kosovës, prezantimin publik i Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të ministrave të arsimit të Evropës, në seminare etj.

Gjatë vitit 2007, ministri Veliu ka realizuar takime, vizita dhe aktivitete të rëndësishme në planin ndërkombëtar e vendor, në funksion të bashkëpunimit me partnerët dhe donatorët për zhvillimin e arsimit të Kosovës.

Këtë vit shkollor, në sektorin parauniversitar kemi rreth 440,000 nxënës (përfshirë edhe fëmijët e moshës parashkollore) të cilët mësojnë në 1,117 institucione edukative-arsimore me rreth 27,000 të punësuar.

Qeveria e Kosovës ka aprovuar Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, dokumentin që skicon rrugën e zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen. Ky dokument është rezultat i një procesi me pjesëmarrje të gjerë të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe parasheh masa konkrete dhe të afatizuara, si dhe zotime buxhetore për avancimin e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Një pjesë e masave kanë të bëjnë me sigurimin e një menaxhimi cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit që nënkupton angazhimin e mëtutjeshëm në:

- *hartimin e legjislacionit në harmoni me normat e BE-së;*
- *profesionalizimin e udhëheqjes arsimore në të gjitha nivelet përmes programeve aftësuese;*
- *ndërtimin e një infrastrukture për përpunimin e të dhënave në arsim;*
- *delegimin më të madh të kompetencave dhe të përgjegjësi në nivel shkolle, etj.*
- *Nevojën e ngritjes së investimeve në arsim, në veçanti në arsimin parauniversitar, ngase të gjitha nevojat e sektorit të arsimit parauniversitar i mbulojmë me një buxhet prej rreth 99.000.000 € që paraqet rreth 4.2% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Me gjithë faktin se ky parametër shpenzues është mbi mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian (4%), e në veçanti mbi mesataren e shumicës së vendeve të rajonit, duhet të kemi parasysh se kemi numrin më të madh të të rinjve në Evropë dhe, njëkohësisht BPV-në më të ulët.*

Strategjia e arsimit parauniversitar parasheh rritjen e buxhetit për arsimin parauniversitar deri në 133.000.000 € në vit brenda periudhës 2008-2012 që, në varësi nga trendi i zhvillimit ekonomik, përbën 4.46-4.73 % të BPV.

Infrastruktura është investimi më i madh që na pret në pesëvjeçarin vijues, ndërsa, sipas kalkulimeve tona, do të na kushtojë rreth 215.000.000 € ose 88% të shumës prej 245.000.000 €, që parashihet për implementimin e Strategjisë së Arsimit Paruniversitar. Nga kjo shumë, synohet që rreth 56.000.000 € të sigurohen nga donatorët, e që paraqet një obligim afatgjatë për Kosovën.

➤ **Grupi i MASHT-it për status dhe bisedime**

Statusi politik i Kosovës ishte prioritet i prioritetëve, prandaj në qershor të vitit 2005, me vendim të posaçëm është themeluar grupi i punës i cili ka punuar konceptin bazë për bisedime eventuale me palën serbe në fushën e arsimit.

Grupi ka përgatitur dokumente relevante ligjore dhe strategjike për negociatorët kosovarë. Po ashtu Grupi i ekspertëve të MASHT-it ka përgatitur pozicionin negociues, qëndrimet, konceptet dhe interesat e palës kosovare për bisedime eventuale për fushat kryesore të arsimit.

➤ **Sigurimi i cilësisë**

Është një fushë ku MASHT ka punuar me përkushtim, por duhet bërë edhe shumë punë për të ndërtuar një sistem të krahasueshëm me vendet tjera.

MASHT ka zhvilluar kurrikulat e reja për të gjitha nivelet, me pjesëmarrje aktive të ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë; ka hapur tregun e teksteve mësimore; ka ndërtuar sistemin e ri për edukimin e mësimdhënësve; ka organizuar, përkrahur dhe financuar trajnime të mësimdhënësve në shërbim; ka ndërtuar kapacitete për organizimin e testeve kombëtare në arsim, etj. Por mund të bëjmë më shumë në këtë drejtim, duke i kushtuar më shumë kujdes cilësisë së punës që bëjmë dhe efekteve që ajo ka në klasë, në mesin e nxënësve. Për ta arritur këtë duhet ta kuptojmë të gjithë se ndryshimet në arsim, e në veçanti ato që kanë të bëjnë me cilësinë, paraqesin një proces që e karakterizon nevoja për përtëritjen e kohëpaskohshme të disa hapave reformues, ndërsa efektet e këtij procesi shihen vetëm pas një kohe relativisht të gjatë. Strategjia e Arsimit Parauniversitar riafirmon përcaktimin tonë që të gjithë fëmijëve në Kosovë t'u ofrojmë arsimim cilësor dhe të orientuar kah shkathhtësitë, e që paraqet edhe një lloj obligimi ndërkombëtar karshi politikave të proklamuar nga UNESCO.

➤ **Infrastruktura shkollore**

Gjatë viteve 2006-2007 me investime të MASHT-it janë ndërtuar dhe rinovuar një numër i madh i shkollave.

Janë ndërtuar 14 objekte shkollore në vlerë 6,700,196.27 €,

Janë ndërtuar (faza e dytë), meremetuar 4 objekte në vlerë prej 779,702.14 €,

Janë rinovuar dhe ndërtuar anekse në 26 shkolla në vlerë 2,282,867.48 €

Janë në ndërtim 17 objekte shkollore, konvikte në vlerë 6,459,956.85 €

Gjithsej vlera e investimeve kapitale të MASHT-it në objekte arsimore në vitet 2006-2007 është mbi 16.000.000 €.

Përmirësimi i infrastrukturës për këtë periudhë përfshinë rritjen e hapësirës shkollore për 16.465 m², ndërtime të reja si dhe anekse 1.264 m². Vazhdimi i projekteve të filluara më 2006 dhe 2007, shton hapësirën shkollore edhe për mbi 51.549 m².

➤ **Arsimi i Komuniteteve**

Në Kosovë janë krijuar kushte optimale për organizimin e mësimin në gjuhët e komuniteteve, por këto kushte nuk shfrytëzohen nga të gjithë. Përderisa, mësimi në gjuhën boshnjake dhe turke organizohet normalisht, te komuniteti serb akoma vërehet një përcaktim për të funksionuar në kuadër të një sistemi arsimor paralel, të kontrolluar nga Beogradi.

Kjo është një çështje që do të zgjidhet bashkë me statusin përfundimtar të Kosovës, por MASHT do të vazhdojë përpjekjet për ndërtimin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës, i cili do ta respektojë diversitetin e segmenteve të ndryshëm të shoqërisë kosovare.

Në vitin 2007 kanë arritur gjithsej 12 dorëshkrime në gjuhën boshnjake dhe 18 dorëshkrime në gjuhën turke, të cilat presin të vlerësohen nga juritë profesionale. Nga Bosnja dhe Hercegovina janë siguruar tekste për nxënësit goranë të klasës së katërt të fshatit Restelicë, komuna e Sharrit (ish-Dragash), kurse për nxënësit që ndjekin mësimet në gjuhën turke janë marrë tekste shkollore nga Turqia, të cilat janë lejuar të përdoren si tekste plotësuese, pasi nuk pajtohen me planet dhe programet mësimore të Kosovës.

Janë botuar planet dhe programet për arsimin e përgjithshëm (1-13) në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën turke, planet dhe programet për arsimin joformal (1-9), planet dhe programet për arsimin profesional dhe planet dhe programet për arsimin parafillor.

Është hartuar dhe është miratuar nga MASHT-i dokumenti “Strategjia për integrimin e komuniteteve romë, ashkalinj dhe egjiptianë”(komponenta e arsimit).

Është përfunduar projekti i mësimin intensiv për nxënës të komuniteteve RAE në nëntë komuna (Prishtinë, Prizren, Pejë, Burim, Shtime, Lipjan, Fushë-Kosovë, Therandë dhe Gjakovë). Në këtë projekt janë përfshirë gjithsej 652 nxënës.

Në fillim të këtij viti shkollor (2007/2008) MASHT-i ka siguruar falas tekste shkollore për nxënësit me gjendje jo të mirë materiale.

Për nxënësit boshnjakë nga klasa 1-4 janë dhuruar falas 125 komplete tekstesh shkollore, kurse për nxënësit që ndjekin mësimet në gjuhën turke janë dhuruar 90 komplete tekstesh shkollore.

Është botuar edhe dokumentacioni i nevojshëm pedagogjik për nxënësit që ndjekin mësimet në gjuhët boshnjake dhe turke (ditarë, dëftesa, libra amë).

Në vitin shkollor 2007/08 në Fakultetin e Edukimit të Prizrenit është hapur dega e Teknologjisë dhe e Informatikës në gjuhën boshnjake, në të cilën janë regjistruar 20 studentë, ndërkaq në Universitetin e Prishtinës me mësim në gjuhën shqipe janë regjistruar sipas kuotave pjesëtarë të komuniteteve boshnjakë, turq dhe RAE, me qëllim të ngritjes arsimore të tyre.

✓ **MASHTN gjatë vitit 2007 ndër të arriturat kryesore, numëron:**

- *Miratimi nga Qeveria e vendit i Strategjisë afatmesme të Arsimit Parauniversitar 2007-2017, bërja publike e saj dhe hartimi i Planit të Zbatimit*
- *Rritja e pagave për mësimdhënësit e arsimit parauniversitar*
- *Rishikimi i bazës juridike për licencimin e mësimdhënësve dhe themelimi i Këshillit për licencimin e mësimdhënësve në arsimin parauniversitar*
- *Dorëzimi i raportit të punës për 2007 dhe planit të punës për 2008*

- Nënshkrimi i Marrëveshjes me Bankën Botërore për projektin në vlerë 6.4 milion euro
- Janë ndarë bursa për 40 studentë të Kosovës që studiojnë në fusha deficitare jashtë vendit
- Realizimi i reformimit të administratës në MASHT (risistemimi pas vlerësimit të punës)
- Përfundimi me sukses i vitit shkollor dhe akademik 2006/2007
- Mbajtja për herë të dytë e Testit të Maturës
- Mbajtja e Testit të Arritshmërisë për kl. 9
- Regjistrimi në klasët e X-ta
- Përgatitjet për vitin e ri shkollor dhe akademik
- Marrja e vendimit për implementimin e klasës së V-të, që shënon përmbylljen e reformës në sistemin e arsimit parauniversitar
- Themelimi i Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP)
- Hapja e Qendrës për Orientim në Karrierë
- Vazhdimi i bashkëpunimit dhe projekteve me donatorët, si: Banka Botërore, GTZ, Norges Vele, Austri, etj.
- Ka përfunduar me sukses projekti TEMPUS “Integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë” (HAEL)
- Janë hartuar dhe miratuar 4 politikat për integrimin e Kosovës HEAL
- Vazhdon programi për aftësim dhe rikualifikim (PARK), pas fazës pilotuese të suksesshme
- Është nënshkruar marrëveshja teknike me organizatën daneze DANIDA
- Ndarja e teksteve falas për nxënësit e shkollave të Kosovës në vlerë 350.000 €
- Funkcionalizimi i Agjensionit të Akreditimit të Kosovës
- Zgjedhja e Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK), fillimi i punës së IPK dhe përzgjedhja e Bordit shkencor, Bordit udhëheqës dhe ekspertëve të IPK
- Vazhdimi i implementimit të standardeve në pikat që kanë të bëjnë me lëmin e arsimit, (të gjitha minoritetet janë të integruara në sistemin arsimor të Kosovës, përveç atij serb)
- Ndarja e 150.000 € për ndërtim apo renovim të hapësirës shkollore për nxënësit minoritarë dhe ata të kthyer
- Përgatitja e dokumentacionit shkollor (diploma, çertifikata, rexhista, etj) në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjak
- Botimi i 3 librave në gjuhën boshnjake, sigurimi i teksteve shkollore nga buxheti i Kosovës dhe shpërndarja falas për 74 nxënës goranë, publikimi i plaprogrameve për Klasat IX dhe V
- Debatimi për arsimimin e romëve, testimi dhe administrimi i mësimin intensiv për komunitetin RAE në 6 komuna të Kosovës
- Botimi i teksteve shkollore në gjuhën turke për klasat 1,2,6 dhe 7, ndërkaq në procedurë të botimit janë edhe tekstet për klasat 3, 4 dhe 8
- Trajnimi “Drejt një shkolle efektive për të gjithë” (TESFA) për mësimdhënës dhe trajnerë të trajnerëve për mësim special
- Fillimi i reformimit të Qendrave burimore,
- Formimi i grupit punues për unifikimin e shkrimit Brajl
- Përpunimi i softuerit për fëmijët me nevoja të veçanta, etj.

- Është siguruar baza juridike për shkollat speciale dhe është kompletuar programi edukativ për këto shkolla
- Në Parlament është miratuar Ligji për Provimin Përfundimtar dhe të Maturës, ndërsa janë në Qeveri Ligji për Kualifikimet profesionale, Projektligji për Institutin Albanologjik dhe Projektligji për Arsimin Lokal; gjithashtu, janë hartuar mbi 64 udhëzime administrative, 162 vendime, etj.
- Janë nënshkruar 3 Memorandume të Mirëkuptimit me partenrët ndërkombëtarë e vendorë; disa janë në proces të nënshkrimit.
 - **Aktivitete tjera:**
- Rishikimi i buxhetimit të Strategjisë së Arsimin Parauniversitar 2007-2017; sipas planit zbatues për fazën e parë kërkon mjete në shumë prej 240.000.000 €.
- Me udhëheqjen e PTK u shqyrtua mundësia e kyçjes së internetit në shkollat e Kosovës
- Grupi i hulumtuesve shkencorë të IPK realizoi vizitë studimore në Itali
- Reagimi lidhur me konkurset e Institucioneve Private të Arsimin të Lartë
- Për herë të katërt në Kosovë shënohet Dita e Evropës – 9 Maji
- U mbajt Akademi solemne me rastin e 7 Marsit- Ditës së Mësuesit, dhe 120 vjetorit të shkollës shqipe.
- Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës i ofron ndihmë Arsimin Profesional në Kosovë
- Më 22 janar, në të gjitha shkollat ora e parë iu kushtua jetës dhe veprës së Presidentit të parë të vendit dr. Ibrahim Rugova
- Vizita KK të Istogut dhe pjesëmarrja në shënimin e 15 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve të shkollës shqipe në Uçë të Istogut
- 15 Studentë të UP trajnohen 2 javë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë
- 23 nxënës të shkollave të Kosovës shpallen kampion bote për mësim të gjuhës gjermane
- U mbajt takim dyditor i grupit konsultativ ndërministror të Kosovës për hartimin e programeve prioritare për përfitim nga fondet e IPA-s 2008
- MASHT dhe Fondacioni Konrad Adenauer shqyrtojnë mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm
- Fillon hartimi i Kornizës së monitorimit në arsim
- Aktivitete të ndryshme me rastin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve
- Për të tretin vit u përmyll me sukses “Java e arsimin për të gjithë”
- MASHT dhe OJQ “Terre des homes” shtojnë përkujdesjen për fëmijët delikuentë
- Prezantohet projekti “Edukimi i Vajzave të Komuniteteve RAE”
- U mbajt Panairi Kombëtar i Firmave Ushtrimore
- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve – Ndikimi në Arsimin e Lartë
- Prezantimi i programit SMIA – Sistemi Menaxhues i Informacioneve të Arsimin
- Vazhdon Procesi i Kopenhagës lidhur me Kualifikimet në Arsim, etj.

✚ Zyra e Sekretarit të Përhershëm

Zyra e SP në MASHT gjatë periudhës kohore ka kryer këto punë dhe aktivitete:

- *ka përcjellur, monitoruar të gjitha aktivitetet e zhvilluara në MASHT,*
- *ka përcjellur zbatimin e ligjshmërisë në të gjitha fushat,*
- *ka vërtetuar dhe lëshuar dokumentacion të shumtë shkollor,*
- *ka shqyrtuar kërkesa dhe marrë vendime të shumta të palëve të interesuara,*
- *ka organizuar dhe monitoruar punën e tërësishme në MASHT,*
- *ka organizuar pritje për shumë zyrtarë të Qeverisë së Kosovës,*
- *ka organizuar takime të shumta për zyrtarë të organizatave qeveritare ose joqeveritare, të jashtme dhe të brendshme që zhvillojnë aktivitete në fushën e arsimit.*
- *ka marrë pjesë në takime rajonale, vizita studimore, etj.*

❖ Zyra për planifikim dhe analizë

Kjo zyrë ka realizuar të gjitha objektivat e parapara me planin dhe programin e punës për vitin 2007:

- *Ka përgatitur raportet mujore, tremujore dhe raportin vjetor të punës së MASHT-it për vitin 2007*
- *Ka hartuar plane të rregullta mujore dhe tremujore të punës së MASHT-it*
- *Ka përgatitur planin vjetor të MASHT-it për vitin 2008 si dhe ka përcaktuar Prioritetet e MASHT-it për vitin 2008 dhe periudhën afatmesme 2007-2011;*
- *Ka marrë pjesë në hartimin e Planit Strategjik të Qeverisë së Kosovës 2007-2013, si dhe në hartimin e Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2006-2017;*
- *Ka marrë pjesë në grupin ndërministror për hartimin e Strategjisë për Tregun e Punës;*
- *Ka përgatitur analiza dhe komente të kohëpaskohshme të punës së MASHT-it*
- *Ka menaxhuar realizimin e projektit: Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim.*

Ndër aktivitetet konkrete nga ky projekt do të veçonim:

- *Dizajnimi i programit të SMIA-s , instalimi i tij në sobwerin e MASHT-it; instalimi i programit në zyrat e drejtorive komunale; është në proces instalimi në të gjitha shkollat e Kosovës.*
- *Është bërë instalimi i programit në mbi 50% të shkollave.*
- *Zyra për Planifikim dhe Analizë, përkatësisht njësia a statistikave në bashkëpunim me UNICEF-in ka realizuar programin DEV-INFO , nga i cili program do të finalizohen dy dokumente: një doracak “Statistikat në arsim gjatë viteve shkollore 2004-05; 2005-06 dhe 2006-07” dhe një CD që prezanton bazën dhe burimin e të dhënave për vitet e cekura shkollore.*
- *Ka përgatitur Memorandumin e Mirëkuptimit për Programin KOS-ESTIA i cili memorandum është nënshkruar nga Ministri Agim Veliu*
- *Pjesëmarrje në seminarin e vendeve të Ballkanit për tolerancë ndëretnike, mbajtur në Bansko të Bullgarisë (16-19.02.2007)*
- *Pjesëmarrje në seminarin e vendeve të Ballkanit për komunikim pa dhunë, mbajtur në Durrës, Shqipëri (23-27.05.2007)*

- *Po ashtu kjo zyrë ka marrë pjesë në grupin punues për hulumtimin e tregut të punës; ka marrë pjesë në administrimin e testit të maturës dhe të kl. 9 dhe 12 -të. Ka bërë përpunimin dhe dërgimin e formave për të dhënat statistikore për vitin shkollor 2007/08 si dhe përpunimin e të dhënave për sukses të gjysmëvjetorit të dytë dhe fund vitit. Ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Banka Botërore lidhur me treguesit (indikatorët) arsimor.*
- *Ka përgatitur treguesit statistikore për të gjitha nivelet e shkollimit për vitin shkollor 2007/2008.*
- *Pjesëmarrje në intervistimin e kandidatëve për drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme*

❖ Zyra ligjore

Ka realizuar pothuajse në tërësi planin e paraparë për vitin kalendarik 2007.

Zyra ligjore ka punuar edhe në:

- *Ligjin mbi maturën, që është përfunduar nga grupi punues qeveritar;*
- *Ligjin për Institutin Albanologjik, që është përfunduar nga komisioni dhe pret tek Ministri për nënshkrim;*
- *Ligjin mbi arsimin lokal, që pret tek Ministri për nënshkrim*
- *Ligjin mbi Financimin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës*
- *Është përfunduar drafti i parë i Ligjit mbi Kualifikimet.*
- *Janë hartuar 4 udhëzime administrative*
- *Pjesëmarrje në komisionet: për parashtresa dhe ankesa, nostrifikim, për hartimin e udhëzimeve administrative si dhe komisioni për vlerësimin e librit shkollor për klasën e katërt*
- *Janë hartuar 7 Udhëzime Administrative të cilat janë nxjerrë nga Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional, 9 Udhëzime Administrative të cilat janë nxjerrë nga Ligji mbi Edukimin Parashkollor, 3 Udhëzime Administrative të cilat janë nxjerrë nga Ligji mbi Arsimin e Lartë, dhe katër Udhëzime të tjera Administrative nga lëmi të përgjithshme arsimore.*
- *Ka përfunduar MASHT-in në 46 seanca gjyqësore në KPMK, në gjykata të ndryshme nëpër Kosovë.*
- *Janë nxjerrë 123 vendime, dhe 93 shkresa të ndryshme*

Gjithashtu ka bërë monitorimin e implementimit të Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative

❖ Zyra e inspeksionit

Zyra e inspeksionit ka kryer këto punë dhe aktivitete:

- *Ka mbajtur takimet e rregullta mujore me inspektorë rajonal të arsimit*
- *Ka bërë inspektimin emergjent në shkollën e mesme “Hoxhë Tahsini” në Obiliq*
- *Ka bërë inspektime kontrolluese në: gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, shkollën fillore në Skromë – Vushtrri; shkollat e mesme profesionale: ekonomike dhe bujqësore në Prishtinë.*
- *Ka inspektuar Fakultetin e Edukimi në: Gjilan, Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë; Fakultetin e Biznesit në Pejë; Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj; BPrAL “Kolegji i arteve dhe shkencave sociale”. Ka kryer inspektime fragmentare në: Fakultetin Juridik, BPrAL: “AAB”, “Kolegji për Biznes”,*

kolegjin “Viktoria”, “Universiteti i Prizrenit”; Akademinë e Studimeve të Avancuara Universitare me seli në Prishtinë si dhe në shkollën e mesme profesionale “Lasgush Poradeci” në Kijevë.

- *Ka realizuar vizita në DKA, në: Prizren, Dragash, Suharekë*
- *Ka realizuar një vizitë në Shqipëri, për shkëmbim përvojash*
- *Ka shqyrtuar 375 parashtresa dhe ankesa*
- *Ka nxjerrë 167 vendime; 138 rekomandime; ka verifikuar 1987 dokumente.*
- *Ka bërë verifikimin e dokumenteve nga zyra e UNMIK-ut dhe atyre nga SHPK-ja.*
- *Ka kontaktuar drejtorët e shkollave të mesme në regjionin e Prishtinës dhe Gjilanit;*
- *Ka inspektuar çështjen e intervistimit në komunën e Gjilanit.*
- *Ka verifikuar saktësinë e “Diplomave” të lëshuara nga Instituti për studime bashkëkohore “Dardania” me seli në Prishtinë*
- *Ka inspektuar 3 shkolla fillore në Prishtinë,*
- *Ka vizituar 3 Drejtori Komunale të Arsimit,*
- *Ka vizituar 3 Zyre Rajonale të Arsimit,*
- *Ka përgatitur raporte dhe rekomandime të ndryshme gjatë inspektimit.*

✚ Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar

Gjatë vitit 2007 kjo zyrë ka realizuar takime dhe aktivitete të shumta:

- Është mbajtur takimi me CIDA/KEDP, lidhur me përgatitjet për organizimin e seminarit me temën “Tregimi për Projektin e KEDP-së në Kosovë”*
- Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Ambasadës Holandeze në Shkup, lidhur me transferin e studentëve të mjekësisë.*
- Është mbajtur seminari në Strugë me dy grupet e ekspertëve të arsimit të lartë në kuadër të projektit TEMPUS, mbi vizitat studimore të kryera në Universitetin e Lubjanës në Slloveni dhe atë të Korintit në Greqi.*
- Janë mbajtur takime të rregullta me stafin e rektoratit, lidhur me bashkëpunimin në mes MASHT dhe UP në fushën e marrëdhënieve me jashtë.*
- Është realizuar takimi me shefin e Zyrës Gjermane në Kosovë z. Eugen Wolfarth, lidhur me aplikacionin e MASHT për anëtarësim të plotë në Procesin e Bolonjës.*
- Pjesëmarrje në takimin e Bordit të Projektit Shumëdimensional me Qeverinë Austriake në Vjenë me ç’rast edhe është bërë përzgjedhja e menaxherit të projektit.*
- Është realizuar takimi me z. Christoph Pradier dhe z. Blerim Saqipi nga OSBE-ja, lidhur me aplikacionin e MASHT-it në UNDP për këshilltar ndërkombëtar të Ministrisë.*
- Është mbajtur takimi themelues për funksionalizimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.*
- Është mbajtur seminari i organizuar nga WYG dhe AIE, lidhur me Integrimet Evropiane.*
- Është duke u punuar në Programin për Afësimin e Arsimtarëve pa Shkëputje nga Puna.*
- Është mbajtur takimi i Panelit të Bursave në mes MASHT, UP dhe KEDP*
- Është mbajtur takimi me Ambasadorin e OSBE-së Werner Wnendt, lidhur me koordinimin e aktiviteteve në arsimin e lartë në mes MASHT dhe OSBE.*

-Është përgatitur dhe mbajtur me sukses Konferenca Ndërkombëtare në Prishtinë me temën “Politikat Kombëtare për Integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë”.

-Është mbajtur takimi me përfaqësuesen e ETF znj. Lida Kita dhe përfaqësuesin e APE z. Ahmet Kosumi lidhur me projektet e IPA-s.

-Është realizuar takimi me majorin e KFOR-it austriak Friedl, lidhur me bashkëpunimin e ndërsjellë.

-Është realizuar takimi me përfaqësuesit e USAID dhe implementuesve të projektit për rivlerësim dhe ridizajnim të organizatave (kryesisht lidhur me UP).

-Është mbajtur takimi i Komisionit Parlamentar lidhur me Ligjin mbi Arsimin Privat në Kosovë, si dhe takimi i grupit punues për arsimin privat.

-Është mbajtur takimi me profesorin në Departamentin e Psikologjisë Moshe Landsman lidhur me përmirësimin e kurrikulit për studime MA.

-Është mbajtur intervistimi i kandidatëve për projektin e përbashkët MASHT-Qeveri dhe UP për dërgimin e 18 studentëve në trajnim-specializim dhe aftësim diplomatik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

-Është realizuar takimi me Susan Htton dhe Tom Gougeon nga KEDP lidhur me aftësimin e mësimeve në kuadër të PAPSHP.

-Është mbajtur takimi me koordinatorin e Projektit me Austrinë z. Johann Gunther, lidhur me shpalljen e konkursit për stafin administrativ të AAK.

-Është mbajtur takimi me znj. Marion Habermüller, lidhur me prezantimin e projektit të KulturKontakt dhe Swisskontakt për firmat ushtarore.

-Është mbajtur takimi me Asociacionin Konrad Adenauer Stiftung, lidhur me partneritetin dhe bashkëpunimin me KAS-GTZ-MASHT në fushën e arsimit.

-Është mbajtur takimi i Bordit të ERI SEE në Vjenë, lidhur me aktivitetet në vazhdim të ERI SEE dhe dakordimin që në Kosovë të mbahet një seminar i ERI SEE me temën “Barazia në Arsim”, tetor 2007.

-Pjesëmarrje në Konferencën e OECD në Vjenë me temën “Arsimi gjithëpërfshirës”. Më 4-5 qershor 2007 është organizuar Konferenca e OECD në Trondheim të Norvegjisë me temën “Barazia në Arsim”.

-Janë mbajtur takimet e Grupit Punues të Arsimit për PVE.

-Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e ESIB (ESU European Students Union) dhe përfaqësuesit e Parlamentit të Studentëve të UP.

-Kjo zyrë ka realizuar edhe këto aktivitete që dalin nga fushëveprimtaria e saj, si: takimi me znj. Veva Ruiz Calavera, shefe e njësisë për Kosovën në Departamentin e Zgjerimit të Komisionit Evropian në Bruksel; ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Këshillit Amerikan dhe Fondacionin Kosovë-Amerikan të Arsimit (KAEP) lidhur me dërgimin e studentëve nga Kosova për të studiuar në Amerikë; ka mbajtur takim me znj. Elisabeth Sorantin-sekretare e përgjithshme e programit CEEPUS, lidhur me mundësinë që Kosova dhe studentët kosovarë të aplikojnë në programet e CEEPUS; është mbajtur takimi i panelit intervistues për pozitën e ndihmë-menaxherit të projektit me Austrinë; është realizuar vizita e Ministrit të Shkencës dhe Kërkimeve shkencore të Austrisë z. Johannes Hahn në Qeveri të zv. Kryeministri z. Lutfi Haziri dhe zv. Ministri i Arsimit z. Fevzi Berisha, lidhur me projektin e përbashkët të Qeverisë së Austrisë dhe Ministrisë së Arsimit të Kosovës.

-Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar është realizuar trajnimi i mësimdhënësve për zbatimin e Projektit për Hulumtimin e të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në 8 shkolla.

❖ Zyra për integrim evropian

Zyra për integrim evropian gjatë vitit 2007 i ka përmbushur në tërësi objektivat dhe detyrat e parapara në planin e saj të punës, e që dalin nga Plani i Veprimit për Partneritet Evropian:

- *Është bërë plotësimi i pyetësorëve lidhur me standardet e ministrive, janë dhënë informacione plotësuese për përgatitjen e raportit për Komisionin Evropian, si dhe për Këshillin e Sigurimit në janar 2007.*
- *Janë përgatitur dhe mbajtur 12 takime të Grupit Punues të Arsimit në lidhje me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE);*
- *Përgatitja e raporteve për Ministrin sa i përket progresit, sfidave/ vështirësive për implementimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian.*
- *Pjesëmarrje në hartimin e Strategjisë për Trajnime mbi Çështjet Evropiane në Kosovë 2008/2009, në bashkëpunim me: AIE; WYG – DFID dhe ministrinë tjera*
- *Pjesëmarrje në seminarin hapës të Shkollës Kosovare për Integrim Evropian, Durrës- Shqipëri si dhe në ligjeratën e hapur nga Presidenca e radhës së BE-së Gjermania – në kuadër të Shkollës për Integrim Evropian.*
- *Plotësimi i pyetësorit sa i përket Integrit Evropian, i dalë nga projekti “Kosova në raport me Proceset e Integrit Evropian”*
- *Pjesëmarrje në organizimin dhe realizimin e shënimit “9 Maji- Dita e Evropës”;*
- *Është përgatitur raporti tremujor për Komisionin Evropian mbi vlerësimin e veprimeve sipas PVPE ;*
- *Pjesëmarrje në trajnimin me temën “Trajnimi mbi komunikimin, monitorimin dhe raportimin”.*
- *Pjesëmarrje në takimin ndërmjet AIE dhe Ministrive tjera mbi përgatitjen e raportit të dytë narrativ të PVPE, për Komisionin Evropian.*
- *Pjesëmarrje në takimin me përfaqësuesit nga Fondacioni Evropian për Trajnime Agjencioni për Integrim Evropian, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës.*
- *Përgatitja e raportit mbi vlerësimin teknik të kërkuar nga UNMIK-u, sa i përket pikës “A”, ku janë publikuar të gjitha njoftimet në media të minoriteteve.*
- *Pjesëmarrje në Konferencën Rajonale “EJL në Procesin e Integrit Evropian”;*
- *Pjesëmarrje në trajnimin mbi Programimin e IPA-s për hartimin e projekteve;*
- *Pjesëmarrje në takimin e ekspertëve të Grupit Punues të MASHT-it, Ministrive tjera dhe partnerëve të tjerë në Kosovë për Zhvillime të Resurseve Njerëzore (ZHRNJ).*
- *Përgatitja e raportit vjetor për Komisionin Evropian mbi Zbatimin e Planit për Partneritet Evropian (PVPE);*
- *Takim me projekt menaxheret e (HD) “Humman Dinamics” mbi informimin e implementimit të projektit “Support to European Integration”.*

- *Pjesëmarrje në takim pune mbi draftimin e raportit të progresit për Komisionin Evropian, për periudhën tetor 2006 – qershor 2007.*
- *Takim informues me zyrtarë të lartë të Agjencionit Evropian dhe zyrtarë të Komisionit Evropian mbi mënyrën e gjetjes dhe mbushjes së aplikacionit të TAIEX-it.*
- *Pjesëmarrje në konferencën “Bashkëpunimi Rajonal për Zhvillimin dhe Integrimin Evropian”*
- *Plotësimi dhe dërgimi i “Matricës Raportuese të Ekstraktit të PVPE” me të dhënat lidhur me veprimet përkatëse, për zbatimin e standardit të parë; plotësimi dhe dërgimi i pyetësorëve për standardet, si vlerësimi teknik i cili shërben për përgatitjen e raportit të rregullt që kërkohet nga Këshilli i Sigurimit;*
- *Pjesëmarrje në trajnimin me temën “Përpilimi i politikave të organizuara nga Agjensioni për Integrim Evropian”; Pjesëmarrje në punëtorinë mbi “Iniciativën e Reformave në Arsim në Evropën Juglindore – ERI SEE”, organizuar nga Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Zyren e Kryeministrit (ZKBNDR) dhe OSBE;*
- *Pjesëmarrje në seminare për shërbyesit civil të përfshirë në bashkëpunim ndërkombëtar dhe dialog rajonal;*
- *Takim pune në Ohër, organizuar nga AIE; takim me përfaqësues të lartë të AIE – drejtorin e Zyres për Informim dhe Trajnime – nga AIE ;*
- *Takim pune në MASHT rreth Strategjisë së Trajnimeve për Integritet Evropian. Nën mbikqyrjen e AIE këto trajnime organizohen nga B&S Europe, Human Dynamics, dhe WYG International.*
- *Në bashkëpunim me AIE dhe Human Dynamics është mbajtur trajnimi në lidhje me IPA*
- *Mbajtja e ushtrimit “Coaching” mbi IPA në bashkëpunim me ekspertin nga Human Dynamics*
- *Pjesëmarrje në takimin e 13-të të Mekanizmit Përcjellës për Procesin e Stabilizimit Asocimit (MPSA)*
- *Pjesëmarrje në punëtorinë “Hapat e ardhshëm drejt hartimit të Planit të Veprimit të Partberitetit Evropian” (PVPE).*

❖ *Zyra e auditimit*

Qëllimi i zyrës së auditimit është vendosja e efikasitetit më të madh operacinal, rrespektimi i rregullave nga njësitë buxhetore të MASHT-it me qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimeve që u ofron shfrytëzuesve dhe qytetarve të Kosovës. Auditimi ndihmon në përmbushjen e synimeve duke ofruar një qasje të qëndrueshme dhe të disiplinuar në vlerësimin dhe përmirësimin e efektshmërisë së menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve udhëheqëse.

Zyra e auditimit gjatë vitit 2007 ka kryer auditime në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe shkencore që kanë qenë të planifikuara për këtë vit, si:

- *Auditimi në shkollat profesionale; fushëveprimi i auditimit ka qenë: të hyrat vetanake për vitin 2006;*
- *Auditimi në shkollat speciale dhe klasat e bashkangjitura; fushëveprimi i auditimit ka qenë: buxheti dhe shpenzimet për vitin 2006/07;*
- *Auditimi në shkollën speciale “Nëna Terezë” në Prizren; fushëveprimi i auditimit ka qenë: shpenzimet për vitin 2006 dhe tremujorin e vitit 2007;*
- *Auditimi në shkollën fillore “Thimi Mitko” në Gjiçan.*

- *Auditimi në Qendrën e Studentëve, lidhur me buxhetin, shpenzimet petty cash, të hyrat vetanake për vitin 2006 dhe tremujorin e vitit 2007;*
- *Janë bërë përgatitjet për auditim në Universitetin e Prishtinës dhe në Bibliotekën Kombëtare.*

Punët e kryera gjatë muajve nëntor –dhjetor janë :

- *Përgatitje rreth përpilimit të planit strategjik të auditimit 2008/2010 dhe përgatitja e planit vjetor të punës së njësive të auditimit të mbrendshëm për vitin 2008.*
- *Përcjellja e implementimit të rekomandimeve në njësitë buxhetore të Ministrisë në të cilat është kryer auditimi*

Objektiv i auditimit në Administratën Qendrore të MASHT-it është:

- *Prokurimi*
- *Buxheti*
- *Personeli*
- *Petty cashi dhe*
- *Njësia e transportit*

Punët administrative

- *Është bërë një analizë rreth raportit të auditorëve gjeneral për rekomandimet e dhëna në Administratën Qendrore të MASHT-it*
- *Po ashtu, kjo zyrë ka marrë pjesë në seminare për masat antikorruption;*
- *Ka marrë pjesë në trajnimet për mbështetje të mëtejshme për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe auditimin e mbrendshëm të udhëhequr nga një ekip auditësh me mjaft përvojë nga kompania Human Dynamics.*

DEPARTAMENTI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

- ❖ **Sektori i planprogrameve** është ndër sektorët më të rëndësishëm në fushëveprimtarinë e zhvillimit të arsimit. Me tri njësitë në kuadër të këtij sektori:

- *Njësia e Zhvillimit të Planprogrameve*
- *Njësia për Standarde dhe Vlerësim*
- *Njësia për Tekste dhe Burime të Planprogrameve*

faktikisht e vënë vulën e procesit të reformave arsimore në të tri nivelet e shkollimit, përcakton çasjen dhe kahjet e zhvillimit të planprogrameve, vënë bazat e standardeve të përmbajtjes dhe të arritshmërisë si në vijën vertikale, ashtu edhe në atë horizontale si dhe kontribuon në zhvillimin e teksteve dhe burimeve të tjera për realizimin e planprogrameve.

➤ Njësia e Zhvillimit të Planprogrameve

- *Botimi i planprogrameve për mësimin joformal për klasat 4,5,9,13*
- *Botimi i planprogrameve për lëndën e gjuhës shqipe për komunitetet joshqiptare për klasat 3,4,5,8,9,12,13*
- *Përkthimi dhe botimi i planprogrameve për lëndët e përgjithshme në klasat 13 të arsimit profesional në gjuhët e minoriteve.*
- *Përkthimi i planprogrameve në gjuhët e minoriteteve për mësimin joformal dhe lëndët e përgjithshme të arsimit profesional.*

- *Përkthimi i planprogrameve për edukimin parashkollor në gjuhët e minoriteteve.*
- *Hartimi i planprogrameve për klasën 10 të shkollave të mesme të muzikës dhe artit dhe për klasën 11 të shkollës së mesme të mjekësisë (dorëzimi i drafteve të para për diskutim)*
- *Hartimi i projektit dhe dorëzimi për miratim lidhur me monitorimin e zbatimit të planprogrameve, metodologjisë, vlerësimit dhe teksteve shkollore.*
- *Hartimi dhe përgatitja e planprogramit për diasporë (drafti i parë për diskutim).*
- *Organizimi dhe mbajtja e seminarit informativ për mësimdhënësit e klasës së V-të;*
- *Rishikimi i standardeve të përmbajtjes dhe arritshmërisë në nivele për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë (gjimnazet).*
- *Redaktimi i planprogramit për mësimin shqip në diasporë*
- *Seminar me ekspertët e planprogrameve, trajnimeve dhe me mësimdhënësit, mbajtur nga një eksperte nga SHBA; përvoja të mira të SHBA-ve në standardet e programeve të edukatës qytetare dhe letërsisë.*
- *Përgatitja e planit të veprimit për zhvillimin e planprogrameve për edukimin parashkollor 0 -3 vjeç (Plani i veprimit dhe bashkëpunimi me UNICEF-in).*
- *Pjesëmarrja e ekspertëve të planprogrameve në takime, seminare dhe konferenca me karakter profesional (lidhur me planprogramet).*
- *Vizita studimore të ekspertëve të planprogrameve në Gjermani dhe Irlandë (përvoja të mira në këto shtete për zhvillimet e reformave të kurrikulave).*
- *Hartimi i planit të veprimit për rishikimin e Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës (jemi vonuar në këtë aktivitet, i cili është paraparë edhe në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar. Arsyeja është angazhimi i një numri të madh ekspertësh dhe çështja financiare).*
- *Hartimi planit vjetor për Sektorin e Planprogrameve për vitin 2008.*

➤ *Njësia për Standarde dhe Vlerësim*

Sipas planit të dinamikës së punës në vitin 2007 nga kjo zyrë janë kryer këto punë dhe aktivitete:

- ✓ *Përgatitja dhe angazhimi i grupit të ekspertëve për provimin e maturës.*
- ✓ *Dizajnimi i testit të klasës 9 për 2007 dhe i testeve për të gjitha tipet e gjimnazeve dhe shkollave profesionale.*
- ✓ *Grumbullimi i shënimeve për nxënësit e klasës 9, klasës 12 dhe klasës 13- të .*
- ✓ *Realizimi i punëtorive me hartuesit e kërkesave për klasat 12 dhe 13.*
- ✓ *Punëtori në nivel të MASHT-it dhe Universitetit për definimin e modaliteteve për maturën.;*
- ✓ *Përgatitja e një materiali në formë të “Lifletës” për informim lidhur me Testin Kombëtar dhe Testin e Maturës.*
- ✓ *Përgatitja e materialit për administruesit, vëzhguesit, drejtorët e shkollave, drejtorët komunal dhe zyrtarë të MASHT.*
- ✓ *Përgatitja e broshurës me udhëzime për kujdestarë të klasave të 9-ta.*
- ✓ *Përkthimi i testit në gjuhët: turke dhe boshnjake.*
- ✓ *Administrimi i Testit të Maturës dhe i Testit Kombëtar pas kl.9.*
- ✓ *Publikimi i rezultateve të Testit të Maturës (raporti përfundimtar).*

- ✓ *Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve të Testit Kombëtar për klasën e 9-të.*
- ✓ *Zhvillimi dhe administrimi i Testit të Maturës për kl.12 dhe 13 në afatin e dytë, gusht 2007.*
- ✓ *Vlerësimi dhe shpallja i rezultateve të Testit të Maturës për klasat 12 dhe të 13;*
- ✓ *Përgatitjet për formimin e komiteteve të lëndëve për klasat 5, 9 dhe 12/13 (2008).*
- ✓ *Formimi i grupeve punuese.*
- ✓ *Takime me anëtarët e komiteteve të lëndëve dhe caktimi i orarit.*
- ✓ *Formimi i tabelës së specifikave.*
- ✓ *Fillimi i përpilimit të kërkesave sipas tabelës së specifikave për nivelin e I-rë.*
- ✓ *Takim pune i anëtarëve të Nj.V.S. me anëtarët e komiteteve lëndore për realizimin e detyrave.*
- ✓ *Rishikimi i kërkesave për nivelin e parë (kl. e 5-të- 2008) me anëtarët e Nj.V.S.*
- ✓ *Rishikimi i kërkesave për nivelin e dytë (kl.e 9-të-2008) me anëtarët e Nj.V.S. (kordinatori me ekspertët lëndorë.*
- ✓ *Formimi i bankës së kërkesave për nivelin e parë. (kl. e 5-të-2008).*
- ✓ *Rishikimi i kërkesave.*
- ✓ *Përkthimi i kërkesave për nivelin e II-të. (kl. e 9-të-2008).*
- ✓ *Formimi i formave ekuivalente për testin e nivelit të II-të. (kl. e 9-të - 2008).*
- ✓ *Punë në komisionin rreth avancimit të disa nxënësve në klasa dhe profile të ndryshme në shkollat e përgjithshme dhe në ato profesionale.*
- ✓ *Puna rreth hartimit të Udhëzimit Administrativ për Monitorim.*
- ✓ *Vizitë studimore 5 ditore jashtë vendit (në Gjermani) i disa anëtarëve të Nj.V.S.*

➤ *Njësia për Tekste dhe Burime të Planprogrameve*

Fushëveprimtaria e Njesisë për Tekste dhe Burime të Planprogrameve është që të koordinojë dhe monitorojë punën rreth përgatitjeve dhe botimit të teksteve dhe mjeteve mësimore.

Nga punët dhe aktivitetet e realizuara në këtë vit shkollor nga kjo fushë (e që janë të parapara edhe me planin e punës) do të prezantonim:

- ✓ *Botimin e teksteve mësimore për klasën e pestë të shkollës fillore, që ndërthën në vete një procedurë mjaftë të gjatë, si:*
- ✓ *Shpalljen e konkursit për tekestet shkollore për klasën e pestë.*
- ✓ *Pranimin e 26 dorëshkrimeve të teksteve shkollore për klasën 5, sipas konkursit të shpallur nga MASHT si dhe i dorëshkrimeve të teksteve shkollore për klasën 5, për gjuhën boshnjake dhe gjuhën turke.*
- ✓ *Dorëzimi i listës së recensentëve për miratim dhe përgatitja e dorëshkrimeve për vlerësim; përgatitja e planit për një diskutim publik për tekestet alternative.*
- ✓ *Vlerësimi i dorëshkrimeve dhe miratimi për botimin e teksteve të klasës së V-të.*
- ✓ *Përkthimi i disa teksteve shkollore në gjuhët e minoritetit boshnjak dhe turk.*

Ndër aktivitetet tjera të kësaj njësie do të veçonim edhe:

- ✓ *Vlerësimi dhe botimi i fletoreve të punës për disa lëndë mësimore për shkollën fillore, shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë.*
- ✓ *Komunikimi me shtëpitë botuese dhe autorët e teksteve shkollore.*
- ✓ *Botimi i disa teksteve shkollore nga gjuhët mësimore të minoriteteve në gjuhët boshnjake dhe turke.*
- ✓ *Librat e botuara për shumicën e lëndëve mësimore të klasës V-të.*

- ✓ *Leja për botimin e fletoreve të punës për disa lëndë mësimore në klasat përkatëse.*

❖ *Sektori për trajnime*

Sektori për trajnime edhe gjatë vitit 2007 ka pasur agjendë shumë të dendur, si në arsimin e përgjithshëm ashtu edhe në arsimin profesional. Do të veçonim vetëm aktivitetet kryesore, si:

- ✓ *Gjatë vitit 2007, në arsimin e përgjithshëm janë trajnuar 641 mësime në programin “Mësime me nxënësin në qendër”, ndërsa 10 grupe të MKLSH nga KEC janë duke vazhduar trajnimin.*
- ✓ *Ndërsa, sa i përket trajnimeve në kuadër të shkollave profesionale janë trajnuar gjithsej 639 mësime, drejtorë, etj., prej tyre në metodikë- didaktikë 375 mësime; didaktikë profesionale (trajnim i trajnerëve) 60 trajnerë; udhëheqës arsimorë në shkollat profesionale 100 udhëheqës arsimor. Gjithsej në arsimin profesional janë trajnuar 535 mësime. Në shkollat fillore janë trajnuar 104 mësime mentor.*
- ✓ *Projekti, gjegjësisht tema “Trafikimi i qenieve njerëzore” është duke u zhvilluar në lidhje ndërlëndore në lëndët edukatë qytetare, biologji, histori dhe gjeografi për klasat 6,7 dhe 11, dhe janë mbajtur takime të vazhdueshme me organizatën për migrim IOM, për vazhdimin e trajnimit të mësimeve.*
- ✓ *Është realizuar trajnimi për trajnerë: “Trafikimi i qenieve njerëzore”; janë trajnuar edhe 20 drejtorë të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta. Janë trajnuar 61 mësime për kundërtrafikim në rajonet e Pejës dhe Gjakovës.*
- ✓ *Në Prishtinë dhe Pejë është mbajtur trajnimi i trajnerëve klasor për Edukatën Qytetare për klasat 3,4,5. Në këtë seminar kanë marrë pjesë 52 trajnerë klasor.*
- ✓ *Është duke vazhduar mini-projekti për parandalim të trafikimit të qenieve njerëzore, në kuadër të të cilit janë trajnuar 122 drejtorë dhe mësime të gjuhës shqipe dhe të artit, të klasës së tetë.*
- ✓ *Janë trajnuar 42 mësime të shkollave të mesme të ulëta për kundër-trafikim.*
- ✓ *Është realizuar takim me Organizatën për Migrim për vazhdimin e trajnimeve me mësime (Ed. Qytetare, histori dhe gjeografi kl 6,7,8,10 dhe 11). Më 14 nëntor në MASHT janë certifikuar 21 pjesëmarrës nga ata për monitorues të trajnimeve nga MASHT-USHPAK dhe CRS me temën: Roli i prindërve në shkollë.*
- ✓ *Programi “Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit” ka filluar me 10 grupe, nga muaji qershor vazhdon çdo muaj nga dy ditë, gjithsej 12 ditë trajnimi dhe 2 ditë monitorimi, ku përfshihen rreth 270 mësime. 96 mësime kanë përfunduar trajnimin e Mendimit Kritik; janë duke vazhduar edhe 30 grupe në nivel Kosovë.*
- ✓ *Është mbajtur trajnimi me drejtorët e shkollave të rajonit të Pejës dhe të Gjakovës në kuadër të projektit “Trafikimi i qenieve njerëzore”. Gjatë muajit nëntor ka vazhduar trajnimi i Mendimit kritik me 20 grupe në nivel Kosovë.*

Sektori për trajnime ka realizuar edhe këto aktivitete:

- ✓ *Takim me grupin, komitetin drejtues për kundërtrafikim më 3 korrik dhe vazhdimi i projektit deri në prill 2008 me trajnime në fushat për kundërtrafikim në shkollë të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.*

- ✓ *Ka organizuar seminar për monitorim dhe vlerësim nga njësia për standarde dhe vlerësim si dhe seminar informativ për klasën e pestë (në seminar kanë marrë pjesë 70% e mësimeve të klasave të V-ta).*
- ✓ *Është mbajtur seminar në Strugë për mbrojtje të ambientit, organizuar nga OJQ “DEA” (trajnim të trajnerëve).*
- ✓ *Janë mbajtur takime të Këshillimit për Shqyrtimin e mesimeve për hartimin e doracakut për licencimin e mesimeve. Grupi punues për licencim ka mbajtur takime për hartimin e kerterëve për licencimin e mesimeve .*
- ✓ *Është realizuar takim me perfaqësuesit e Planit zhvillimor Strategjik të Kosovës me Halit Kadriun dhe Silva Matushova për të filluar projektin: Asistenca teknike e Strategjisë së Planit Zhvillimor të Kosovës- Agjencioni për Rindërtim Evropian nga Bashkësia Evropiane për ngritje të kapaciteteve në MASHT.*

❖ *Sektori i arsimit të përgjithshëm*

Në kuadër të Sektorit të Arsimit të Përgjithshëm veprojnë disa njësi si:

- *Njësia për edukim parashkollor*
- *Njësia për arsim fillor*
- *Njësia e arsimit të mesëm të ulët*
- *Njësia e arsimit të mesëm të lartë*
- *Njësia e arsimit special*
- *Njësia për shkollat promovuese të shëndetit*
- *Njesisë së SHSHMP në diasporë*
- *Njësia për nostrifikim.*

Njësia për edukim parashkollor

Në kuadër të njesisë për edukim parashkollor janë realizuar këto punë dhe aktivitete:

- ✓ *Hartimi i Kurrikulës për grupmoshën 1-3 (niveli i parë)*
- ✓ *Përgatitje rreth mbajtjes së serisë së dytë të trajnimit të 225 edukatorëve për fillimin e realizimit të Kurrikulës për grupmoshën 1-3 (niveli i parë)*
- ✓ *Po punohet në standardet e zhvillimit dhe të nxënies në fëmijërinë e hershme të Kurrikulit të Ri parashkollor*
- ✓ *Hartimi i dokumentacionit pedagogjik për nivelin e kopshtit*
- ✓ *Botimi i revistës “Bota Parashkollore”*
- ✓ *Bashkëpunimi me donatorët që ndihmojnë arsimin parashkollor*
- ✓ *Janë dhënë rekomandimet për licencimin e 16 institucioneve parashkollore private*
- ✓ *Janë licencuar shtatë institucione parashkollore private*
- ✓ *Në kuadër të projektit “Mozaiku” ka filluar monitorimi i grupeve në Pejë dhe Prishtinë*
- ✓ *Është realizuar një vizitë studimore në Turqi*
- ✓ *Vazhdon bashkëpunimi me OJQ “RTM”, ku po realizohet trajnimi i drejtorëve të IP.*
- ✓ *Takime me OJQ rreth realizimit të projektit “Mozaiku” dhe vazhdimin të projekteve tjera.*
- ✓ *Ka vazhduar me sukses realizimi i projektit “Mozaiku” për edukimin ndërkulturor në edukimin parashkollor si dhe zgjerimi i tij.*

- ✓ *Ka vazhduar me sukses realizimi i projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës Parashkollor” si dhe zgjerimi tij edhe në një institucion tjetër parashkollor.*
- ✓ *MASHT në bashkëpunim me MSH, IKSH, UNICEF-in etj. kanë ripërpunuar fletëpalosjet “Prindësia e mirë”.*

Në bashkëpunim me OJQ të ndryshme: SCK, FSDEK, RTM etj. gjatë vititi janë realizuar trajnime të shumta nga fusha të ndryshme si psh.

- ✓ *Të drejtat e fëmijëve*
- ✓ *Zgjedhja e konflikteve*
- ✓ *Tema nga arsimi gjithëpërfshirës parashkollor etj.*
- ✓ *Janë realizuar takime të rregullta pune me kolegjiimin e drejtorëve të institucioneve parashkollore.*
- ✓ *Janë këmbyer reciprokisht përvojat me vende të ndryshme (janë realizuar vizita studimore jashtë vendit) si dhe është binjakëzuar institucioni parashkollor i Pejës me një institucin parashkollor në Londër.*
- ✓ *SCK ka filluar ndërtimin e institucionit parashkollor në Obiliq.*

➤ *Njësia për arsim fillor*

Planifikimi dhe realizimi i procesit të zgjedhjes së drejtorëve dhe zv.drejtorëve Organizimi i tryezës “Hulumtimi i mundësive për ngritjen e cilësisë në mësim” Pjesëmarrje në komisionin bazë për riorganizimin e rrjetit shkollor

Janë bërë të gjitha përgatitjet për hartimin e Planit dinamik për përfundimin e vitit shkollor

Ka përfunduar “Java e Arsimit për të gjithë”

Është nxjerrë UA për formimin e grupit punues për kl. V-të

Vizitë pune në Shqipëri me Qendrën e të drejtave të Fëmijëve-Prishtinë.

➤ *Njësia e arsimit të mesëm të ulët*

Kjo njësi gjatë vitit 2007 ka zhvilluar aktivitete të shumëta si:

- ✓ *Pjesëmarrje në hartimin e Kornizës së Strategjisë për integrimin e komuniteteve RAE në arsimin kosovar.*
- ✓ *Takimet e rregullta me CRS-në, ku është diskutuar për draftin mbi “Parandalimin e braktisjes së shkollës nga vajzat”, i cili i dedikohet komunitetit RAE në Kosovë.*
- ✓ *Pjesëmarrje në grupin punues “Orientimi në Karrierë”, me ç’rast është analizuar puna mujore e Qendrës Kombëtare për Karrierë.*
- ✓ *Takimet e rregullta në Qendrën për Orientimin në Karrierë. Nga MASHT është paraparë që dy ditë në javë një zyrtar ta mbajë këtë qendër dhe të merret me këshillime.*
- ✓ *Janë trajnuar mësimdhënësit e klasave të nënta për lëndën zgjedhore “Edukimi në Karrierë”; trajnimi është mbajtur nga një ekspert slloven.*
- ✓ *Bashkëpunimi me OJQ-të: MRE, Kosvet, CRS për realizimin e projekteve.*
- ✓ *Pjesëmarrje në përmbylljen e projektit nga CRS “Kundër braktisjes së vajzave nga shkollat” të komunitetit RAE.*
- ✓ *Vizitë pune në Qendrën Didaktike, ku me rastin “Java e arsimit për të gjithë”, u mbajt tryeza e rrumbullakët me përfaqësuesit e arsimit për rajonin e Ferizajit.*
- ✓ *Vizitë studimore në shkollat fillore dhe të mesme në Angli dhe Slloveni.*

- ✓ *Pjesëmarrje në komisionin vlerësues dhe auditimin nëpër qendrat komunale për punësim.*
- ✓ *Seleksionimi i mësimdhënësve për mbajtjen e trajnimit për lëndën zgjedhore “Edukimi në Karrierë”.*
- ✓ *Vijimi i rregullt në trajnimin për “Udhëheqje arsimore”.*
- ✓ *Shpërndarja e librave në shkollat fillore të cilat ishin dhuratë nga SHBA-ja.*
- ✓ *Bashkëpunim me UNDP me qëllim të krijimit të themeleve për qeverisje të mirë.*
- ✓ *Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët me temën: “Delikuenca e të miturve në Kosovë”, trajtimi familjar, ligjor, rrethi shoqëror, shkolla, Institucionet shtetërore dhe OJQ-të”.*
- ✓ *Në kuadër të programit “Trajnimi mbi Ndërmarrësi” janë caktuar mësimdhënësit e shkollave fillore të Kosovës të cilët do ta ndjekin trajnimin dyditor.*

➤ ***Njësia e arsimit të mesëm të lartë***

Në njësin e arsimit të mesëm të lartë janë realizuar këto aktivitete:

- ✓ *Janë përgatitur dëftesat për kl.e 13 të gjimnazeve dhe shkollave profesionale, diplomat për shkollat profesionale, si dhe dëftesat për klasat 6-9 edhe në gjuhët boshnjake dhe turk.*
- ✓ *Është bërë korrigjimi i librave amë për gjimnaze dhe shkolla profesionale*
- ✓ *Janë përgatitur certifikata për instruktor*
- ✓ *Është hartuar kodi i mirësjelljes*
- ✓ *Është përgatitur Strategjia për Nxënësit e Kthyer nga Jashtë*
- ✓ *Është në proces ristrukturimi i rrjetit të ri shkollor si dhe ndarja e gjimnazeve nga shkollat e mesme të larta profesionale*
- ✓ *Janë realizuar vizita pune në institucionet private parauniversitare*
- ✓ *Janë realizuar vizita në Muzeun Etnologjik, Muzeun Kombëtar dhe në burgun e Prishtinës me nxënësit me hipërenergji të shkollave të mesme të Prishtinës.*
- ✓ *Pjesëmarrja në komisionin për nostrifikimin e dokumenteve*
- ✓ *Hartimi i “UA për ndarjen e shkollave”*
- ✓ *Shqyrtimi i drejtimeve të gjimnazeve*
- ✓ *Është punuar në “Ligjin e Maturës”*
- ✓ *Është bërë ndryshimi i UA për organizimin e ekskursioneve*
- ✓ *Janë shqyrtuar kërkesat dhe janë dhënë vendimet për realizimin e ekskursioneve*
- ✓ *Është përgatitur kalendari për vitin shkollor 2007-2008.*

➤ ***Njësia e arsimit special***

Njësia e arsimit special ka zhvilluar veprimtarinë e saj për këtë vit në harmoni me planin e punës dhe objektivat e parapara në të. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të realizuara do të veçonim:

- ✓ *Emërimi i ekspertëve për unifikimin e shkrimit të Brajl-it*
- ✓ *Takimi i Grupit Punues për realizimin e Konferencës për Unifikimin e Brail-it*
- ✓ *Në bashkëpunim me FSDEK-un është realizuar trajnimi “Zhvillimi Profesional IV”, me module të veçanta për çdo muaj.*
- ✓ *Është bërë intervistimi dhe përzgjedhja e 18 trajnerëve për trajnimet TESFA si dhe e mësuesve itinerar (udhëtues).*

- ✓ *Takim lidhur me planifikimin për organizimin e Institutit Veror, tema e të cilit është “Vështirësitë në matematikë”, ku do të përfshihen 110 pjesëmarrës.*
- ✓ *Intervistimi i kandidatëve për mësimdhënës në Arsim Special*
- ✓ *Mbajtja e trajnimeve për drejtor të shkollave të rregullta për njoftim rreth punës së Qendrave Burimore.*
- ✓ *Trajnimi i drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme për Arsimin inkluziv dhe Qendrat Burimore, Strategjinë mbi Arsimin Parauniversitar (Trajnimi i 180 Drejtorëve të shkollave të rregullta në regjionin e Pejës, Prishtinës, Mitrovicës dhe Ferizajt, organizuar nga FSDEK-u II dhe Njësia e arsimit special/MASHT*
- ✓ *Trajnimi i Stafit të Qendrës Burimore në Prizren për gjithëpërfshirjen dhe barazinë në arsim*
- ✓ *Strategjia e arsimit parauniversitar (janë trajnuar 37 pjesëmarrëse të Qendrës Burimore në Prizren)- NJAS/MASHT, FSDEK-u II*
- ✓ *Trajnimi i mësimdhënësve të rregullt në Programin TESFA (drejt një shkolle efektive për të gjithë); në 7 Regjione të Kosovës (janë trajnuar dhe certifikuar afër 150 mësimdhënës për temat që trajtojnë gjithëpërfshirjen në arsim)*
- ✓ *Vizita studimore në Finlandë për mësimdhënësit udhëtues që janë punësuar në Qendrat Burimore, Prizren, Prishtinë, Pejë, me ç’rast 6 mësimdhënës itinerar kanë vizituar Qendrat Burimore dhe për së afërmi janë njoftuar me punën e mësuesit itinerar.*
- ✓ *Pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare për zhvillimin e gjuhës së shenjave (njohja me trendët bashkëkohorë të zhvillimit të gjuhës së shenjave në Finlandë, Australi etj.)*
- ✓ *Emërimi dhe nxjerrja e vendimeve për Ekipet Profesionale Vlerësuese në 7 Regjione të Kosovës (identifikimi dhe vlerësimi i FNV në Kosovë mbi bazën profesionale)*
- ✓ *Mbyllja e buxhetit për shërbime dhe mallra; drejtorët e shkollave speciale dhe klasave të bashkangjitura kanë realizuar buxhetin për shërbime dhe mallra deri me datën 20 nëntor 2007.*
- ✓ *Shënimi i javës për të drejtat e njeriut, me ç’rast është mbajtur gara me temën “Të drejtat e mia”, ku nxënësit me nevoja të veçanta kanë bërë gara në foto, vizatim në disa formate; me 07.12.2007 janë ndarë shpërblimet në MASHT.*
- ✓ *Në bashkëpunim me zyren e personelit janë përgatitur kontratat për mësimdhënësit e shkollave speciale dhe klasave të bashkangjitura*

➤ ***Njësia për shkollat promovuese të shëndetit***

Aktivitet më të rëndësishme të njësisë për shkollat promovuese të shëndetit për vitin 2007 janë:

- ✓ *Organizimi i takimeve të rregullta të Komitetit Ndërministror, çdo muaj;*
- ✓ *Organizimi i aktiviteteve me rastin e 24 marsit-Ditës TB, 31 Majit- Ditës kundër duhanit, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik;*
- ✓ *Punë rreth përgatitjes së projekt propozimit për filtrimin e ujit në shkolla;*
- ✓ *Mbledhja e të dhënave për gjendjen e ujit dhe sanitacionit në shkollat e Kosovës;*
- ✓ *Takim me OSCE dhe shërbimin policor për prezentimin e projektit për nevojën e pakësimit të drogës;*

- ✓ *Takimi me grupin punues të strategjisë të shkollave promovuese të Shëndetit, për hapat e mëtutjeshëm të Strategjisë SHPSH;*
- ✓ *Takim në IKSHP, ku është bërë prezentimi i detyrave të parapara nga ana e përfaqësuesve të institucioneve, që janë përfshirë në projektin e BB për parandalimin e gripit të shpendëve;*
- ✓ *Në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë është përgatitur lifleta me informata për fëmijë për parandalimin e gripit të shpendëve;*
- ✓ *Organizimi i aktiviteteve për shënimin e Ditës Botërore të Shëndetësisë (7 Prilli). Organizimi i aktiviteteve në shkollat e mjekësisë (loja shpërblyese për ESE-në më të mirë) si dhe Vlerësimi i ese-së më të mirë në kuadër të lojës shpërblyese;*
- ✓ *Takim me drejtorët komunal të arsimit, prezentimi i draftit të Strategjisë dhe shpërndarja e draftit në komuna;*
- ✓ *Takim në IKSHPK për formimin e Këshillit organizativ për aktivitetet me rastin e ditës botërore të luftës kundër duhanit, si dhe përgatitja e shkresës për shkollat fillore dhe të mesme për shënimin e ditës botërore të luftës kundër duhanit.*
- ✓ *Përgatitja e një shkrese drejtuar MKRS, departamentit të rinisë nga MASHT-i për realizimin e mjeteve për lektorimin e dokumentit të Strategjisë SHPSH;*
- ✓ *Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, me moton: si ta zbatojmë dhe implementojmë ligjin për duhanin?*
- ✓ *Pjesëmarrje në manifestimin në Mitrovicë, ku pas realizimit të suksesshëm të projektit “ Menagjimi i riskut me plumb ” ,dy shkolla promovuese kanë organizuar manifestimin duke shfrytëzuar qasjen e shkollave promovuese të shëndetit.*
- ✓ *Pjesëmarrje në Konferencën QPEA,(Qendra këshilluese për prindër dhe arsimtarë) në Prishtinë, ku është prezentuar puna e qendrës në regjionin e Ferizajit.*
- ✓ *Takim me grupin punues të Komunikimit për gripin e shpezëve lidhur me përpilimin e Strategjisë Komunikuese për Kontrollin e Gripit të Shpendëve.*
- ✓ *Pjesëmarrje në prezentimin publik të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar;*
- ✓ *Pjesëmarrje në takimin në IKSHPK, lidhur me formimin e Grupit Strategjik nga Qeveria për hartimin e Strategjisë Gjithëpërfshirëse për Ethet Hemoragjike- Crime Congo.*
- ✓ *Pjesëmarrje në punëtorinë me grupin punues për gripin e shpendëve , rreth analizimit të materialeve të përgatitura për parandalimin e gripit të shpendëve.*
- ✓ *Takim pune i grupit punues për planin e veprimit për periudhën 5 vjeçare të Strategjisë së SHPSH-së, si dhe caktimi i prioritetëve të strategjisë*
- ✓ *Prezentimi i projektit : ballafaqimi i të rinjve të Kosovës me stresin dhe pasojat e stresit, ku Komiteti ndërministror ka vlerësuar se ky hulumtim i plotëson kriteret për miratim.*
- ✓ *Përgatitja e shkresës për hulumtimin “ Ballafaqimi i të rinjve të Kosovës me stresin dhe pasojat e stresit”, në shkollat e mesme të Kosovë.*
- ✓ *Pjesëmarrje në administrimi i testit të arritshmërisë dhe testit të maturës.*
- ✓ *Takimi i grupit për Kontrollin e duhanit, ku është bërë, shqyrtimi i rregullores së punës dhe vendimit të kryeministrit për anëtarësinë dhe detyrat e punës së këshillit.*
- ✓ *Organizimi i punëtorisë njëditore për rishikimin e dokumentit të Planit të Veprimit të Strategjisë SHPSH, dhe mundësia e inkorporimit të komenteve shtesë për finalizimin e të njëjtit.*
- ✓ *Konkretizimi i aktiviteteve të përcaktuara si dhe njoftimi, lidhur me procedimin e Udhëzimit administrativ për duhanin.*

- ✓ *Pjesëmarrje në aktivitetin e realizuar nga OJQ “Miqte e Shëndetit”, me ç’rast është organizuar kuizi i diturisë në mes të tri shkollave fillore të Prishtinës, në shënimin e ditës së Objektivit të Gjashtë të Mijëvjeçarit - luftës kundër HIV/AIDS, në kuadër të javës së varfërisë.*
- ✓ *Takimi me grupin punues të planit të veprimit, ku është diskutuar për përgatitjet dhe organizimin e grupit për hartimin e buxhetit të plani i veprimit të Strategjisë për SHPSH 2007-2017;*
- ✓ *Në bashkëpunim me Departamentin e mjekësisë sociale organizimi i aktiviteteve me rastin e ditës ndërkombëtare kundër HIV/AIDS në shkollat fillore dhe të mesme të rajonit të Prishtinës, me qëllim të ngritjes së njohurive lidhur me HIV/AIDS.*
- ✓ *Organizimi i punëtorisë për buxhetimin e planit të veprimit të Strategjisë për SHPSH 2007-2017.*
- ✓ *Pjesëmarrje në trajnimin “Mendimi kritik të shkrim leximit” (MKLSH).*

❖ Njësia për Shkollën Shqipe të Mësimit Plotësues në Diasporë

➤ *Njësia për Shkollën Shqipe të Mësimit Plotësues në Diasporë ka realizuar të gjitha objektivat e parapara në planin e punës për vitin 2007. Ndër aktivitetet më të rëndësishme të kësaj njësie është planifikimi, përgatitja dhe realizimi i seminarit të tretë me radhë me mësuesit e Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues në Diasporë, mbajtur me 23-25 korrik në Durrës, organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës bashkë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, në të cilin morën pjesë rreth 100 mësues e veprimtarë të Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues nga gjithë diaspora, si dhe ekspertë e zyrtarë nga Kosova dhe Shqipëria. Aty u trajtuan tema të ndryshme me interes për përfshirjen e fëmijëve nga diaspora në mësim plotësues, për rëndësinë e mësimit plotësues në ruajtjen e gjuhës, traditës dhe kulturës shqipërate, përkatësisht për lidhjen e mësimit plotësues me atdheun; për format e ndryshme të organizimit të mësimit plotësues, varësisht specifike të shtetit përkatës si dhe për çasje specifike metodologjike për planifikimin, organizimin dhe realizimin e mësimit plotësues në diasporë; si dhe për plane, programe dhe tekste mësimore unike (me standarde përkatëse) për gjithë diasporën shqiptare ku organizohet mësimi plotësues.*

- *Janë grumbulluar materialet profesionale të Seminarit 3 dhe po bëhen gati për botim. Grupet profesionale të punës për hartimin e Kurrikulës së Shkollës Shqipe të MP në diasporë tashmë kanë dorëzuar materialet përkatëse dhe gjatë ditëve vijues materialet e sintetizuara në një draft do t’i dërgohen edhe MASH të Shqipërisë dhe të Maqedonisë për konsulencë-kontribute apo edhe miratim. Projekti definitivisht duhet të botohet deri në fund të vitit 2007.*
- *Ndër projektet tjera të kësaj njësie do të theksonim edhe: “Atdheu në zemër 2008”. Është hartuar dhe është hedhur në shqyrtim-diskutim në qarqe të SHSHMP në diasporë koncepti i takimeve me nxënës të diasporës, me titull “Atdheu në zemër 2008”. Reagimet kanë qenë mjaft pozitive dhe miratuese; mbetet të miratohet në nivele përkatëse të MASHT të Kosovës.*
- *Vazhdon të mbahet një korrespondencë dhe komunikim mjaft dinamik me të gjitha qarqet shkollore në diasporë. Kanë arritur dhe po arrijnë edhe përgjigjet e para të formularëve-modeleve përkatëse për mbledhjen e të dhënave për SHSHMP në diasporë për këtë vit shkollor si dhe raportet e punës për vitin*

2006/2007. Kjo punë nuk ecën dot sipas dinamikës së paraparë dhe në mungesë të instrumentit të detyrimit mësuesit dhe mësueset, përkundër deklarimeve plot patetike të atdhedashurië, s'i plotësojnë dhe dërgojnë me kohë të dhënat. Ka të ngjarë që edhe shume sosh nuk i posedojnë fare këto të dhëna apo i kanë jo në nivel profesional, meqë de jure pothuaj nuk i monitoron askush.

- Vizitë shkollave shqipe të mësimi plotësues në diasporë në Gjenevë për nder të Festës së 28 Nëntorit, me ftesë të LAPSH "N. Frashëri" si dhe shoqatave kulturore shqiptare. Në fokus të komunikimit-veprimtarive ishte përcaktimi i shumë detajeve lidhur me projektin e perbashket me MASHT të Kosovës (tashmë të miratuar) për vizitën e 50 nxënësve shqiptare të Gjenevës në Kosovë në mars të vitit 2008. Për nevojat e kesaj shkolle MASHT ka dërguar edhe një sasi librash-lektyre shkollore.
- Është mbajtur një lidhje-korespondence mjaft funksionale edhe me grupin e mësuesve shqiptare nga Suedia, lidhur me organizimin e konkursit të dijes të nxënësve shqiptar "Suedia 2007". Garat janë mbajtur më 24 nëntor 2007 dhe sipas raporteve të para në to morën pjesë rreth 15 ekipe dhe dolën mjaft të suksesshme (shih: <http://modersmal.skolutveckling.se/albanska/>)

➤ **Njësia e arsimit privat**

Komisioni për licencim ka bërë rivlerësimin e dokumentacionit të institucioneve private të arsimit që kanë aplikuar për licencë si dhe ka hartuar vendimet përkatëse. Po ashtu ka bërë shqyrtimin e ankesave eventuale si dhe ka realizuar vizita në terren.

Është realizuar monitorimi i IALP.

Është formuar komisioni dhe vazhdon punën për zbatueshmërinë e ligjit nga IAP.

Janë realizuar vizita në institucione parashkollore private.

❖ **Sektori i arsimit profesional**

Projektet dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2007 nga ky sektor janë:

Është bërë rishikimi i planprogrameve për kl.e 10-të

Është formuar KAAP (Keshilli i Arsimit dhe Aftësimi Profesional), me përbërje prej 15 anëtarëve; është përpiluar rregullorja e punës dhe planifikimi i buxhetit për 2008. Zhvillimi i Kornizës së Kualifikimeve Kombëtare, në kuadër të së cilës është bërë përshkrimi i 7 niveleve të KKK.

Ligji për kualifikime Kombëtare i Kosovës është dorëzuar në Parlament nga MASHT, por ende nuk është miratuar.

Është hartuar Strategjia për ndërmarrësi si dhe drafti final për standardet kombëtare për Arsim dhe Aftësim në ndërmarrësi.

Është bërë vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i nxënësve për nivelet e arsimit profesional.

Nga grupi punues është hartuar planprogrami për firmat ushtrimore dhe pritet të zbatohet në fillim të vitit shkollor.

Është hapur konkursi për pranimin e kordinatorit për zyrë qendrore të firmave ushtrimore.

Në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve u mbajt panairi për firmat ushtrimore.

Është përgatitur konkursi për regjistrimin e nxënësve në shkolla profesionale.

Ka filluar arsimi joformal në shkollat profesionale. Profilet të cilat janë ofruar të organizohen për të rritur janë profile programi i të cilave është i hartuar konform standardeve evropiane (programe modulare). Janë hartuar plan-programet për të tri nivelet dhe shkollat në të cilat janë shpallur konkurset i plotësojnë kushtet, si: mësimdhënës të trajnuar, kabinete dhe hapësirë për implemetimin e tyre. Janë rishikuar të gjitha planprogramet të hartuara më parë nga grupi i ekspertëve të angazhuar nga MASHT.

Është përpiluar konkursi plotësues për regjistrimin e nx. në kl.10.

Janë trajnuar të gjithë mësimdhënësit të cilët do t'i zbatojnë planprogramet për kl.e 10-të (210 për didaktikë profesionale dhe 40 për firmat ushtrimore).

Në kuadër të projekteve ETF janë organizuar vizitat studimore në Danimarkë për përfitim të njohurive për AP, familjarizimin me përvojat daneze për këtë lloj arsimimi. Norgesvulle ka vazhduar aktivitetet me arsimin joformal për profilin e fermerit.

Eco-neti dhe Swisscontacti kanë hapur zyren qendrore për firmat ushtrimore në kuadër të shkollës ekonomike "H.K.Prishtina" në Prishtinë.

OEK ka nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me OE të Dortmundit, ku parashihet që përmes kësaj marrëveshje Oda e Dortmundit t'ju ofrojë eksperiencat e tyre dhe trajnime të ndryshme me anën të ekspertëve të tyre profesional .

Projektligji për kualifikime është i gatshëm dhe është dorëzuar në Zyren e Kryeministrit, pritet të kalojë në Parlament.

❖ Sektori për komunitete

Bazuar në planin vjetor të punës dhe konform standardeve, ky sektor ka vazhduar punën në realizimin e objektivave të paraparë:

- *Është punuar Draft Strategjia për integrimin e RAE*
- *Është siguruar dokumentacioni pedagogjik për nxënësit në mësimin intensiv*
- *Vizitë shkollave fillore në Lubinjën e Epërme dhe të Ulët "7 Shtatori" në Vitomiricë, shk. fill. " Fan Noli", në Dobrushë, me mësim në gjuhën boshnjake.*
- *Vizitë shkollave: "Dr. Ali Sokoli" në Prishtinë shk.fill. "Emin Duraku" në Prishtinë dhe shkollave për mësim intensiv të komunitetit RAE në Shtime.*
- *Është vizituar Fakulteti i Biznesit në Pejë, me mësim në gjuhën boshnjake.*
- *Janë siguruar të ardhurat për 4 arsimtarë të cilët punojnë në mësimin intensiv në Pejë, për periudhën 5 mujore, nga ana e Drejtoratit për komunitete DKA.*
- *Takime me AGEF-in, Edukatorin, OSBE-në, CRS-në dhe IOM -in lidhur me planifikimin e aktiviteteve për vitin 2008*
- *Dorëzimi i dorëshkrimeve në bazë të tenderit për grupin kombëtar të lëndëve (Gjuhë boshnjake, Histori, Edukatë muzikore dhe Arti; gjithsej 14 dorëshkrime).*
- *Organizimi i debatit për arsimimin e RAE, në kuadër Ditës Ndërkombëtare të Romëve, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës.*
- *Sigurimi i teksteve nga buxheti i Kosovës dhe ndarja falas e 74 kompleteve nga Bosnja dhe Hercegovina për nevojat e fëmijëve goran të kl.IV nga fshati Restelicë, komuna e Dragashit*
- *Pjesëmarrje në një punëtori në Beograd në lidhje me iniciativat me reformat arsimore në Evropën Juglindore.*

- *Përgatitja e teksteve për shtyp për klasat 3, 4, dhe 8 me mësim në gjuhën boshnjake (përkthimi, lektura, recensionet)*
- *Pjesëmarrje në takimin e parë të ekspertëve me temën "Krycja e minoriteteve etnike në shoqëri" në Torino të Italisë, në organizim të ETF-së*
- *Pjesëmarrje në konferencën për edukimin parashkollor të turqve dhe boshnjakëve, organizuar nga Parlamenti i Kosovës dhe OSCE.*
- *Monitorimi dhe administrimi në lidhje me përfundimin e mësimit intenziv të RAE në 9 komuna;*
- *Ka dalë nga shtypi "Čitanka za 3-ći razred" (Libër leximi për klasën e tretë të shkollës fillore me mësim në gjuhën boshnjake), me autorë boshnjakë të Kosovës.*
- *Pjesëmarrja në seminarin në Strugë lidhur me "Strategjinë për integrimin e komunitetit RAE", komponenta e arsimit, drafti përfundimtar.*
- *Është mbajtur seminar në Prizren për mësuesit të cilët do të punojnë me klasat e pesta me mësim në gjuhën boshnjake dhe turke.*
- *Janë bërë përgatitjet për mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta për arsimimin e komuniteteve (të gjitha nivelet), organizuar nga MASHT, OSBE, UNICEF.*
- *Punë në përgatitjen për shtyp të teksteve për klasat 3, 4 dhe 8 me mësim në gjuhën boshnjake.*
- *Pjesëmarrje në Konferencën për pajtim dhe kthim, në organizim të "Partner Kosova" dhe USAID.*
- *Përgatitje për vitin e ri shkollor (caktimi i nxënësve për marrjen e teksteve falas, furnizimi me inventar, regjistrimi i nxënësve, sistematizimi i personelit mësues dhe zyrtarëve në ZRA etj.)*
- *Në OSBE është mbajtur ceremonia përfundimtare me rastin e përfundimit të projektit trevjeçar të mësimit intensiv për romë, ashkalinj dhe egjiptas. Projekti është implementuar në 9 komuna në bashkëpunim me MASHT, OSBE, DKA.*
- *U janë shpërndarë falas 439 kopje të teksteve nga klasa 1-9 nxënësve të cilët e kanë përfunduar mësimin intensiv për komunitetin RAE dhe kanë vazhduar shkollimin e rregullt në 9 komuna.*
- *Shtëpia botuese "Libri shkollor" ka shtypur 3 tekste në gjuhën boshnjake për nevoja të nxënësve të kl.7 dhe 8.*
- *Janë realizuar vizita në: shkollën e mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" në Prishtinë, mësimi në gjuhën boshnjake; shk. fill. "Planjani" në Planjë, mësimi në gjuhën boshnjake, në komunën e Prizrenit; shk. fill. "Motrat Qiriazit" në Prizren, me mësim në gjuhën turke.*
- *Janë mbajtur tryeza të rrumbullakëta për arsimimin e boshnjakëve, turqve dhe goranëve, të organizuara nga MASHT-i, OSBE-ja, UNMIK-u dhe UNICEF-i. Qëllim ka qenë përmirësimi i cilësisë së arsimit të këtyre komuniteteve.*
- *Është mbajtur seminari për Kornizën e Konventës për mbrojtjen e pakicave kombëtare në organizim të OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, ku sektori ka marrë pjesë në hartimin e raportit të parë për Këshillin e Evropës lidhur me arsimin.*
- *Është pajisur me banka dhe karrige aneksi i shkollës fillore "7 Shtatori" në Vitomiricë, ku mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe boshnjake.*

- *Pjesëmarrja në Mbledhjen e dytë të ekspertëve në Torino të Italisë, me temën “Minoritetet etnike dhe gjithëpërfshirja shoqërore”, ku është prezentuar puna për arsimimin e komunitetit.*
- *Janë publikuar 4 tekste për nevoja të nxënësve me mësim në gjuhën boshnjake, për klasat e: 2, 3, 4, dhe të 8, në botim të shtëpive botuese “ Libri shkollor “ dhe “Dukagjini”.*
- *Janë publikuar këto planprograme mësimore për mësim në gjuhën boshnjake:*
 1. *Kurrikulumi për arsimin parashkollor*
 2. *Standardet për arsimin parashkollor*
 3. *Planprogrami mësimor për klasën e 3 për mësim joformal*
 4. *Planprogrami mësimor për klasën e 9.*
- *Është shpërndarë një numër i konsiderueshëm tekstesh falas nxënësve të familjeve që kanë pozitë jo të mirë materiale nga radha e boshnjakëve dhe e turqve nga klasa e 1-4.*
- *Është publikuar Strategjia për integrimin e komunitetit RAE, komponenta e arsimit, të cilën e ka nënshkruar Ministri Agim Veliu, ndërsa është punuar në bashkëpunim me Qeverinë, SOROS-in dhe OSBE-në. Dokument Strategjia është përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhën serbe, në gjuhën rome dhe në gjuhën angleze.*
- *U janë shpërndarë rreth 3000 libra nxënësve të shkollave fillore me mësim në gjuhën boshnjake, me përmbajtje të lloj-llojshme si lekturë, dhuratë nga letrari boshnjak Ragip Sijariq, i cili jeton në Suedi.*
- *Janë përgatitur (përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën boshnjake dhe janë lektuar) dhe dorëzuar në shtyp në “Libri shkollor“ planprogramet mësimore për arsimin joformal për këto klasa: 1-2, 4, 5, 6,7 dhe 8. Janë në shtypje e sipër dhe do të jenë të gatshme deri më 20.12. 2007.*

❖ *Zyra për të drejtat e njeriut*

Aktivitetet e zhvilluara në sferën e çështjeve gjinore

- *Në bashkëpunim me Rektoratin dhe KEDP është arritur marrëveshja për punësimin e një zyrtari për barazi gjinore i cili do të punojë në kuadër të Qendrës për Drejtat e Njeriut në UP.*
- *Hartimi i tri projekteve për donatorë (projektet e hartuara kanë të bëjnë me promovimin e drejtave të fëmijëve dhe barazinë gjinore të cilat janë paraparë me planin vjetor të punës).*
- *Është organizuar trajnimi për mësimdhënësit për programin “Parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore”. Janë trajnuar dhe certifikuar 20 trajnerë për çështje gjinore dhe çështje të trafikimit me qenie njerëzore, të cilët do ta shpërndajnë informacionin tek mësimdhënësit tjerë.*
- *Hartimi i raportit për Zyrën për Integritim Evropian lidhur me përfshirjen e të drejtave të njeriut dhe çështjeve gjinore në planprogramet shkollore.*
- *Punë në hartimin e Programit Kosovar për Barazi Gjinore; NJDNJ e ka bërë draftin e parë për fushën e arsimit.*
- *Është hartuar raporti për standardin e II që ka të bëjë me përfshirjen e çështjeve gjinore në planprograme.*

Aktivitetet e zhvilluara në sferën e kundër-trafikimit

- *Pjesëmarrje në takimet ndërministrore kundër trafikimit me qenie njerëzore.*
- *Pjesëmarrje në punëtorinë njëditore për hartimin e aktiviteteve në fushën e luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, që do të realizohen për vitin 2007-08 nga Qeveria dhe ministrinë përkatëse.*
- *Organizimi i trajnimit për mësimdhënësit që zhvillojnë lëndën “Aftësitë për jete”. Trajnimi është mbajtur në 3 rajone dhe janë trajnuar 100 mësimdhënës nga të gjitha rajonet e Kosovës.*
- *Vlerësimi i filmit dokumentar “ Rekrutimi”, filmi dokumentar është realizim i IOM-it. MASHT.*
- *U organizua trajnimi për 200 shkolla dhe mësimdhënës për lëndën “ Aftësitë për jetën. Mësimdhënësit janë trajnuar për 6 modulet e parapara sipas programit të lëndës.*
- *Janë bërë përgatitjet për organizimin e trajnimeve për parandalim të trafikimit me qenie njerëzore. Janë përzgjedhur shkollat që do të përfshihen në trajnim dhe janë bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e trajnimeve.*
- *Shqyrtimi dhe aprovimi i projektit “Parandalimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit”, si dhe është mbajtur takim me konsulentin nga Finlanda, ku janë prezantuar aktivitetet që ka paraparë MASHT për vitin 2007 në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.*
- *Përgatitja e raportit gjashtëmujor për punën në parandalimin e trafikimit.*
- *Organizimi dhe realizimi i shënimit të Muajit Antitrafikim, me ç’rast MASHT realizoi një varg aktivitete në shkollat e nivelit parauniversitar. Kjo flet shumë për rezultatet e MASHT-it në integrimin e të drejtave të njeriut në sistemin arsimor, në trajnimet për fushat e caktuara dhe në bashkëpunimin efikas me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare në realizimin e projekteve të arsyeshme në shkolla.*
- *U finalizua marrëveshja e bashkëpunimit MASHT-MVPT. Marrëveshja ka të bëjë me projektet e Qendrës për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit që realizohen në shkolla.*
- *Bashkëpunim me MKRS dhe Ministrinë e Drejtësinë në realizimin e aktiviteteve në fushën antitrafikim.*

Aktivitetet e zhvilluara në lëmin e të drejtave të fëmijëve, nxënësve dhe studenteve, në sferën antidiskriminim dhe në atë të aftësisë së kufizuar

- *Ka përfunduar raportin për Konventën për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe i është dorëzuar UNIMIK-ut për shqyrtim.*
- *Monitorimi i projektit:” Fëmijët janë e ardhmja e Kosovës”; projektin po e zbaton SHPK në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale.*
- *Pjesëmarrje në grupet punuese për hartimin e Strategjisë së Qeverisë për të drejtat e njeriut.*
- *Pjesëmarrje në takimet e Këshillit Drejtues të projektit ”Edukimi për paqe dhe tolerancë”, ku është prezantuar puna në kuadër të këtij projekti dhe planet për të ardhmen.*
- *U punua në përshtatjen e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve për moshën e parashkollorëve dhe fillorëve, e që pritet të financohet nga OSBE.*

- *Vlerësimi i dokumentit “Llista e punëve të rënda të fëmijëve”, që e nxori grupi ndërministror i udhëhequr nga MPMS dhe ILO-IPEK.*
- *Pjesëmarrje në konferencën e organizuar nga “Nisma e të rinjve për drejtat e njeriut”. Në konferencë janë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me llogaridhënien, barazinë dhe sundimin e ligjit.*
- *Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e udhëzimit administrativ për përdorimin e gjuhëve zyrtare.*
- *U mbajt “Java e arsimit për të gjithë”. Në kuadër të kësaj jave janë organizuar tryeza të rrumbullakëta në 6 rajone, janë vizituar rreth 20 shkolla fillore, është bërë vizita e fëmijëve në institucione, janë organizuar aktivitete në nivel shkollave.*
- *Vlerësimi i projektit të OJQ –së “Qendra për Këshillim, Hulimtim dhe Trajtim Psikologjik” e Ferizajt, lidhur me parandalimin e dhunës në shkolla.*
- *Monitorimi i projektit të SHPK-së “ Të rinjtë janë e ardhmja e Kosovës”, i cili pritet të përfundojë së shpejti.*
- *Pjesëmarrje në takimin e parë të Këshillit Drejtues për projektin “ Përkrahje e sistemit të drejtësisë për të mitur në Kosovë”. Në takim është diskutuar lidhur me punën e këtij këshilli si dhe për rëndësinë e projektit.*
- *Pjesëmarrje në punëtoritë e organizuara për Strategjinë për të drejtat e njeriut. Në punëtori është punuar në grupe për hartimin e planit të zbatimit të strategjisë.*
- *U finalizua marrëveshja e mirëkuptimit në mes të Zyrës për Qeverisje të Mirë/ ZKM, MASHT-it dhe Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve. Marrëveshja ka për synim fuqizimin dhe realizimin e programin për të drejtat e fëmijëve të ofruar nga Qendra për të Drejtat e Fëmijëve.*
- *U shënuar 1 Qershorit- Dita Ndërkombëtare të Fëmijëve, me ç’rast 120 fëmijë të klasave të para i priti Kryeministri dhe Ministri i Arsimit me zyrtarë nga ZKM dhe MASHT. MASHT u ofroi fëmijëve nga një pako me tekste dhe mjete mësimore.*
- *U mbajt Konferenca për të drejtat e fëmijëve, e organizuar nga ZQM, MASHT dhe Qendra për të Drejtat e Fëmijëve. Fëmijët e nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët e udhëhoqën konferencën dhe paraqitën kumtesat e tyre për gjendjen e të drejtave të fëmijë në Kosovë si dhe rekomandimet për avancimin e të drejtave të tyre. NJDNJ në MASHT ndau dhurata, si: libra, fletore, lapsa, goma, fletore vizatimi, ngjyra për fëmijët pjesëmarrës.*
- *U mbajt Olimpiada e Fëmijëve Parashkollor.*
- *U realizua punëtorja në MASHT lidhur me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve. U punua në rekomandimet e Këshillit të Evropës lidhur me këtë konventë.*
- *Pjesëmarrje në Konferencën për prezantimin e Listës së Punëve të Rrezikshme të Fëmijëve në Kosovë. U dhanë rekomandime për dokumentin, priten masat për zyrtarizimin e dokumentit final dhe masat për zbatimin e tij.*
- *Me rastin e përvjetorit të Ligjit Kundër Diskriminimit, Kryeministri i Kosovës e ka shpallur Javën Kundër Diskriminimit (19-25 shtator), e që u shënuar me një varg aktivitete të ndryshme.*

- *Organizimi i punës së komisionit për vlerësimin e eseve të nxënësve.*
- *Me iniciativë të ZQM/ZKM, më 17 tetor u shënua Dita për Mundësi Profesionale për Personat me Aftësi të Kufizuara, ku të gjitha ministratë janë obliguar të pranojnë për një ditë pune nga dy persona me aftësi të kufizuara.*
- *Pjesëmarrje aktive në takimet për hartimin e Strategjisë për të drejtat e fëmijëve*
- *Në kuadër të Ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, u organizua gara shkollore për foton dhe vizatimin më të mirë. Ky aktivitet u realizua me nxënësit e shkollave speciale dhe u mbështet financiarisht nga OSBE.*
- *NJDNJ, MASHT në bashkëpunim me Zyrën Maqedone të Prishtinës po angazhohet për pjesëmarrjen e nxënësve tanë në garën ndërkombëtare të vizatimit që mbahet në Maqedoni. Tani nxënësit po aplikojnë për të hyrë në garë dhe pasi të dorëzohen punimet në Maqedoni, komisioni i atjeshëm na e kthen informatën nëse ndonjë nga nxënësit tanë janë kualifikuar për garë. Nëse po, nxënësit do të kenë rastin që në muajin maj prej datës 23-30 të qëndrojnë në Maqedoni, ku së bashku me fëmijët nga vendet e ndryshme të Evropës do të garojnë për 25 punimet më të mira në vizatim.*

Aktivitete të tjera:

- *Shpërndarja e kalendarit me vizatimet e nxënësve fitues të garës së vizatimit e cila është realizuar në bashkëpunim me MEM, e që kishte për qëllim promovimin e idesë për ruajtjen e energjisë.*
- *Pjesëmarrje në hartimin e kornizës së monitorimit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar.*
- *Pjesëmarrje në komisionin për risistematizimin e vendeve të punës brenda MASHT-it.*

❖ Sektori për koordinim me komuna

Janë mbajtur takime: me drejtorët komunalë, ndërkomunalë në Deçan dhe Mitrovicë; me z. Agim Rexhepin, kryetar i shoqatës “Miqte e Amerikës, miqtë e Bill Klintonit”; në Gjakovë në kuadër të projektit “Java e Arsimit për të gjithë”; në zyrën e TMK-së në kuadër të projektit “Edukimi për rrezikun nga minat”; me OJQ: CRS, SHPA- Ferizaj; në zyrën ndërlidhëse të Shqipërisë; në shtëpinë botuese “Libri Shkollor” (dokumentacioni pedagogjik); në shkollën fillore “Selman Riza” në Fushë Kosovë, në kuadër të projektit për RAE; me grupin e punës për hartimin e dokumentacionit pedagogjik.

Pjesëmarrje në: seminarin dyditor, organizuar nga MASHT dhe USHPAK në Prizren; seminarin për themelimin e Këshillave prind- arsimtarë, mbajtur në Durrës; seminarin katërditor i organizuar nga MASHT dhe UNICEF në Strugë, për monitorimin e planprogrameve; seminarin me grupin e punës për hartimin e një doracaku në kuadër të projektit “Parandalimi i braktisjes së shkollës nga vajzat” të komuniteteve RAE; Mbledhja dhe kompletimi i listës së të dhënave për punimet e nxënësve “Dita e Tokës”, për Zyrën Amerikane

Vizitë studimore në Maqedoni, lidhur me parandalimin e braktisjes së shkollës nga vajzat e komuniteteve RAE.

Vizitë pune në shkollën e mesme “Mihail Grameno”-Rahovec.

Vizitë pune në shkollën fillore të fshatit Medvec- Lipjan, për ndarjen e mini granteve.

Shqyrtimi i kërkesave të ardhura nga shkollat pilot për projektin RAE, për mini grantet.

Sistemimi i ankesave dhe kërkesave të ardhura nga DKA dhe ZRA.

Mbledhje informative me drejtorë shkollash për rëndësinë dhe aktivitetet e KPA-ve në nivel shkolle.

Punëtori njëditëshe, Vila “Gërmia”, Prishtinë.

Takim pune me OJQ-USHPAK.

Kontrollimi dhe përgatitja e listës së nxënësve për në Greqi.

Takim në vila “Piknik” Prishtinë, lidhur me Strategjinë për media dhe komunikim.

Punëtori dyditëshe, organizuar nga CRS me temën “Kosova dhe partnerët strategjikë”.

DEPARTAMENTI I ARSIMIT TË LARTË

Është përgatitur drafti i parë i Ligjit për Financimin e Arsimit të Lartë.

Në kuadër të Programit pa Shkëputje nga Puna, i cili realizohet në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit ka filluar kursin grupi i dytë në drejtimin klasor.

Vazhdon projekti për Asoacionin për Trajnim Akademik (ATA)

Është bërë perurimi i zyrave për nevojat e Parlamentit Studentor si dhe akomodimi i stafit.

Janë mbajtur takime të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport me përfaqësuesit e Agjencionit të Akreditimit.

Vazhdimi i punës së Këshillit të Ekspertëve sipas planit për implementimin e QITT-së.

Është dorëzuar në Parlament për miratim Korniza Kombëtare e Kualifikimeve.

Janë organizuar punëtori të grupit për promovimin e Bolonjes, në Strugë

Në kuadër të komisionit për shqyrtimin e kërkesave për licencimin dhe ri-licencimin e Bartësve Privat të Arsimit, janë inspektuar institucionet private të arsimit të lartë.

Është mbajtur takim i komisionit dhe janë shqyrtuar kërkesat e studentëve për lirim nga pagesa e semestrit.

Është përgatitur lista e kandidatëve të mundshëm nga MASHT për KKSH, ku kanë aplikuar katër minoritarë, është bërë adresimi në Qeveri dhe Kuvend për miratim; pritet edhe emërimi dy kandidatëve nga jashtë.

Është mbajtur konferenca ndërkombëtare për integrimin e arsimit të lartë në Zonën Evropiane të AL.

Janë realizuar vizita në UP në lidhje me projektet, posaqërisht Projektet e Programit Tempus të cilat janë duke u zhvilluar pa vështirësi.

Po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me UP dhe IPAL rreth përgatitjeve për regjistrimin e studentëve të rinj në këtë vit akademik si dhe përgatitja me kohë e Udhëzimeve Administrative.

Janë përgatitur dhe miratuar nga Ministri tri Udhëzime Administrative të nevojshme për fillimin e vitit të ri akademik: UA për Aplikimin e Pagesave të Studentëve në Universitetin e Prishtinës, UA për krijimi dhe funksionimi i skemës për dhënien e bursave, shpërblimeve dhe formave të tjera të mbështetjes financiare në Universitetin e Prishtinës, dhe UA për krijimin dhe funksionimin e programit për asistencë financiare në Universitetin e Prishtinës.

DAL ka qenë i kyçur në fillimin e punës së Agjencisë së Akreditimit të Kosovës . Po ashtu ka përgatitur konkursin për stafin administrativ dhe zëvendës menaxherin e

projektit shumëdimensional për partneritet institucional me Austrinë në fushën e Arsimit të Lartë.

Janë mbajtur takime: me përfaqësuesit e USAID lidhur me prezantimin e projektit të tyre për ristrukturimin e UP; të Grupit për Promovimin e Procesit të Bolonjës (GPPB); me Dekanin e Fakultetit të Mjekësisë dhe përfaqësuesit e ATA-s, lidhur me pagesat e mësimdhënësve që kanë mbajtur mësim me studentët e transferuar nga Universiteti i Tetovës; në Rektorat lidhur me përgatitjet për regjistrimin e studentëve të rinj dhe amendamenti i Udhëzimeve Administrative; me përfaqësuesit e MSH dhe Fakultetit të Mjekësisë (drejtimi i infermierisë) lidhur me dhënien e pëlqimit për organizimin e studimeve Bachelor në Infermieri; me Bordin e KIJAC (Institutit i Gazetarisë dhe Komunikimit i Kosovës). Ky seminar ka qenë vazhdimësi e Konferencës Ndërkombëtare të organizuar në Prishtinë lidhur me hartimin e politikave nacionale për integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë; me znj. Keiko Miwa nga Banka Botërore, lidhur me projektet e ardhshme të Bankës Botërore në Arsimin e Lartë; Bordit të PAPSHP lidhur me analizën dhe vlerësimin e përfundimit të fazës Pilot I; Bordit të PAPSHP, lidhur me analizën dhe vlerësimin e përfundimit të fazës Pilot II; në Rektorat me Rektorin dhe Pro-Rektorin për çështje akademike lidhur me propozimin e UP për regjistrimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2007/2008. U mbajt seminari tre ditor në Mitrovicë me temën “Zhvillimi i politikave për integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë”.

Është mbajtur takimi informues për vizitën studimore dhe trajnimin e 21 hulumtuesve të rinj të IPK-së në Milano të Italisë.

Është realizuar takimi me anëtarin e Këshillit Kombëtar të Cilësisë (Bordit të AAK) prof. Helmut Konrad dhe menaxherin e projektit prof. Johan Guenther, lidhur me shkëmbimin e informatave dhe raportimin nga mbledhja e Bordit të Agjencisë për Akreditim të Kosovës.

Është realizuar takimi me përfaqësuesin e OSCE- zyra për planifikim dhe zhvillim (KCPSED) Kosovo Centre for Police Safety z. Andrew Gridinsky, lidhur me akreditimin e programeve për shkollën e policisë për drejtimit: polici, dogana, oficerë korrektimi dhe oficerë për emergjencë. Është realizuar takimi me përfaqësuesit e OSCE z. Christoph Pradier dhe z. Blerim Saqipi, lidhur me planifikimin e buxhetit të OSCE për vitin 2008 për Arsimin e Lartë.

Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e SBASHK-ut lidhur me fillimin e vitit të ri shkoll.07/08.

Është shpallur konkursi plotësues për regjistrimin e studentëve në UP për vitin akademik 07/08.

Është mbajtur takimi i Grupit për Promovimin e Procesit të Bolonjës dhe i Projektit për integrimin e Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Është mbajtur takimi me përfaqësuesin e Departamentit për Zgjerim z. Apriou Arnoud, përfaqësuesin e zyrës rajonale të TEMPUS z. Stefan Dukandijev dhe atë të zyrës së TEMPUS-it në Kosovë znj. Lindita Tahiri lidhur me prioritetet e MASHT për Arsimin e Lartë.

Është mbajtur takimi i Këshillit Drejtues i Programit për Aftësim dhe Rikualifikim të mësimdhënësve (PARK), lidhur me hartimin e Memorandumit të ri të Mirëkuptimit në mes MASHT dhe UP si dhe caktimin e kurseve të reja.

Është mbajtur takimi i Komisionit Qendror për Nostrifikim.

Është mbajtur takimi me përfaqësuesit e Bankës Botërore: Ranjit Nayak, Keiko Miwa dhe znj. Sachiko lidhur me grantin e ri të Bankës Botërore.

Është mbajtur Konferenca Ndërkombëtare për Vlerësim dhe Akreditim të institucioneve të arsimit të lartë.

Është mbajtur takimi i Këshillit Drejtues të Projektit Shumëdimensional për Partneritet Institucional në mes MASHT dhe Ministrisë së Arsimit dhe asaj të Punëve të Jashtme të Austrisë dhe Agjencisë për Zhvillim të Austrisë lidhur me implementimin e projektit. Është realizuar diskutimi publik në kuadër të Projektit për Promovimin e Procesit të Bolonjës.

Është realizuar takimi me z. Steven Douglas Crow, anëtar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë (Agjencia e Akreditimit e Kosovës) dhe znj. Karyn Posner Mullen, Drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në Zyrën Amerikane në Prishtinë.

Është mbajtur takimi i Komisionit për përzgjedhjen e zyrtarit të prokurimit për projektin EPIP II të Bankës Botërore.

Është mbajtur takimi i grupit punues për kornizën e programit të IPA-s.

Është mbajtur takimi i komisionit përzgjedhës për vijuesit e PARK dhe takimet e Bordit të PARK.

Është mbajtur Tryeza e Paktit të Stabilitetit në Tiranë.

Është mbajtur intervista për përzgjedhjen e drejtorit të PARK/ Zyrtarit administrativ dhe 4 koordinatorëve.

Pjesëmarrje ne punëtorinë për zhvillimin e Strategjisë së Universitetit të Prishtinës, mbajtur në Ohër të Maqedonisë.

Pjesëmarrje në konferencen ndërkombëtare në Tiranë për qasje mbarësektoriale në Arsim.

Takim i Bordit të Qendrës nismëtare të Biznesit.

Takim me përfaqësuesit e komisionit evropian, në lidhje me donacionet për arsimin e lartë.

Është duke u punuar ne themelimin e Qendrës për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe teknogjisë si dhe të Qendrës për Teknologji dhe Inovacione.

Trajnim në zyrën ENIC NARIC AUSTRIA- Ministria e Arsimit, Austri:

- Sistemi austriak i arsimit të lartë

- Fushat e veprimtimit të ENIC NARIC, Austria

MASHT ka ndarë 45 bursa për studentët tanë që studiojnë jashtë; 16 bursa për nivelin bachelor, 18 bursa nivelin master, dhe 6 për doktoraturë; si dhe 6 bursa për studentë nga Maqedonia, të cilët studiojnë në Kosovë.

Pjesëmarrjet e rregullta në Këshillin Administrativ të Qendrës së Studentëve

Pjesëmarrje në takimet e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lirim nga pagesa e semestrit;

Përgatitja e broshurave: „Bolonja për këmbësorë” si dhe „Lisbona për Këmbësorë

Është mbajtur takimi i komisionit për ndryshimin e UA për nostrifikim.

Janë nostrifikuar një numër i diplomave të fituara në Institucionet e Arsimit të lartë jashtë vendit.

Përgatitja dhe mbajtja e takimit të Komisionit Qendror për Barasvlerë dhe Nostrifikim.

Universiteti i Prishtinës

Stafi menaxhues gjatë vitit 2007 ndërmoi një varg aktivitete të rëndësishme për jetësimin e reformës së nisur në Universitetin e Prishtinës

Aktivitetet e realizuara të parapara në planifikimin 2007 nga UP-së, janë:

- *Hartimi i planit të veprimt për 2007*
- *Miratimi i planit të buxhetit të Universitet nga Këshilli Drejtues i UP-së*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i raporteve periodike mbi realizimin e mjeteve buxhetore dhe të hyrave vetanake për vitin 2007*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i raportit mbi realizimin e mjeteve buxhetore dhe të hyrave vetanake për vitin 2007*
- *Shqyrtimi i propozimbuxhetit të Universitetit të Prishtinës për periudhën 2008 - 2010*
- *Nxjerrja e Rregullores mbi procedurat për shqiptimin e masave ndaj stafit akademik të UP-së në rastin e konstatimit të plagjiaturave*
- *Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për të ardhurat personale*
- *Plotësimi i Rregullores për kriteret për ndarjen e bursave, shpenzimeve dhe formave tjera të mbështetjes financiare të Universitetit të Prishtinës*
- *Nxjerrja e Vendimit për lartësinë e bursës për vitin 2007*
- *Nxjerrja e Rregullores mbi kompensimin e punës së komisioneve të cilat themelohen në nivel të Universitetit të Prishtinës*
- *Hartimi dhe zbatimi i politikave për mbrojtjen e pronës intelektuale*
- *Shqiptimi i masave ndaj stafit akademik në rastin e konstatimit të cenimit të kodit për ruajtjen e etikës profesionale*
- *Shqyrtimi i një numri të madh të kërkesave dhe ankesave të ndryshme drejtuar Këshillit Drejtues të UP-së, etj.*

Stafi menaxhues, pasi analizoi planet dhe programet ekzistuese për nivelin bachelor dhe master të miratuara nga viti 2002 e më vonë, me qëllim të konstatimit të shpërputhjeve eventuale me rekomandimet që burojnë nga Deklarata e Bolonjës, mori vendimin që Senatin të UP-së t'i propozojë marrjen e vendimit për ristrukturimin e planeve mësimore. Kështu, të gjitha planet e studimeve sipas njësive akademike për nivelin bachelor u miratuan përfundimisht në shtator të vitit 2007 dhe të gjitha njësitë akademike filluan vitin akademik me plane dhe programe të ristrukturuara.

Deri në fillimin e vitit akademik 2007/2008 pjesa dërmuese e njësive akademike i ristrukturoi planet mësimore për studimet master, të cilat edhe u shqyrtuan dhe u aprovuan në Senatin e UP-së. Pjesa e mbetur e njësive akademike është në përfundim të propozimeve të planeve të studimeve, të cilat pritet të miratohen gjatë janarit 2008. Senati i Universitetit të Prishtinës, e miratoi vendimin për kushtet e regjistrimit në studimet master, më 24.12.2007.

Në mbështetje të rekomandimeve të MASHT-it, në tremujorin e parë të vitit 2007 u hartua Rregullorja për kushtet dhe kriteret për pranimin e studentëve në studimet themelore, në harmoni me propozicionet e reja të miratuara nga MASHT-i, me të cilat parashihej respektimi i pikëve të fituara nga provimi i maturës, e cila u miratua nga Senati i UP-së 27.04.2007.

Senati i Universitetit të Prishtinës, pas analizave të hollësishme e miratoi Vendimin për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore - bachelor më 19.09.2007.

Rregullorja mbi studimet e doktoratës është hartuar në tremujorin e parë të vitit 2007 dhe e njëjta është miratuar nga Këshilli Drejtues i UP-së më 27.04.2007.

Pas miratimit të planeve për studimet e doktoratës, Fakulteti Ekonomik i UP-së, ka filluar implementimin e Rregullores së re në këto studime.

Të gjitha zgjedhjet e personelit akademik, në vitin 2007 janë bërë në përputhje me dispozitat e Statutit dhe të dispozitave ligjore në fuqi.

Përtëritja e stafit akademik me kuadër të ri - me asistentë të rinj dhe asistentë në të gjitha njësitë akademike, e veçmas në Fakultetin e Mjekësisë.

Është ngritur Bordi i Qendrës për përsosmëri në mësimdhënie në Fakultetin Filozofik, i cili ka përpiluar Strategjinë e ngritjes së platformës për ofrimin e kurseve për aftësimin e vazhdueshëm të stafit akademik në fushën e mësimdhënies. Kanë filluar aktivitetet me 40 grupe dhe ka bërë aftësimin e mbi 30 mësimdhënësve për organizimin e kurseve me të rritur.

Është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet MASHT-it dhe UP-së për bashkëfinancim të zhvillimit të programeve për aftësimin e mësimdhënësve kosovarë pa shkëputje nga puna, që organizohet në Fakultetin e Edukimit. Planet janë miratuar nga Senati i UP-së, janë pranuar vijuesit, janë siguruar mjetet dhe ka filluar puna.

➤ **Zgjerimi i hapësirës universitare**

Është bërë zgjerimi i hapësirës mësimore për 1650 metra katror me mbindërtimin e godinës së Fakultetit Filozofik si dhe rikthimit të objektit "Konaku" për nevojat e Fakultetit të Arteve dhe Administratës Qendrore të UP-së.

Është siguruar hapësirë shtesë me lirim të hapësirave të cilat shfrytëzoheshin si bufe nëpër njësitë akademike.

Janë hartuar projekte ideore dhe detale për objektet: Fakulteti i Edukimit, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit.

Është siguruar truall për ndërtimin e objekteve të reja në: Gjakovë (1 ha e 20 ari) dhe Ferizaj (3 ha).

Është rinovuar hapësira infrastrukturore në Fakultetin e Edukimit – Qendra në Prishtinë, Prizren, Gjilan dhe Gjakovë, në Fakultetin e Mjekësisë, në Fakultetin Ekonomik etj.

Angazhimi i kompanisë MMM (Mobile Sanitary Service – Member of ADCO grup) për mirëmbajtjen e objekteve dhe të hapësirës të UP-së.

➤ **Riorganizimi i shërbimit të financave**

Riorganizohet shërbimi për financa me qëllim të realizimit më të efektshëm të mjeteve buxhetore si dhe menaxhimit të suksesshëm të të hyrave nga mjetet e participimit nga ana e studentëve, duke iu vënë kod të veçantë secilës njësi të Universitetit, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 6/ 2007 – Standardi i unifikuar për numra referent për grumbullimin e të hyrave publike, i cili ka filluar të zbatohet nga 1 janari i vitit 2008 Identifikimi i nevojave të fakulteteve për punë profesionale e praktike

Është bërë shqyrtimi analitik i planeve të studimit për konstatimin e nivelit të planifikimit të aftësimit praktik të studentëve sipas fushave të studimit. Në harmoni me këtë është bërë rivlerësimi i mundësive të njësive akademike me pajisje të nevojshme dhe mjete për punë mësimore praktike me studentë. Veçmas është analizuar çështja e pajisjeve e disa njësive akademike me substanca të nevojshme kimike, si bie fjala FSHMN, Edukimi, Mjekësia, Bujqësia etj. Gjatë vitit 2007 këtyre njësive iu është

kushtuar përparësi për furnizim me kemikalje dhe mjete tjera të nevojshme për punë praktike.

Është bërë Informim i studentëve dhe personelit akademik për mënyrën e llogaritjes dhe peshën ECTS-it dhe planifikimin e aktiviteteve të shprehura në orë pune, me rastin e ristrukturimit të planeve të studimit sipas njësive akademike.

➤ ***Disejtimi dhe plotësimi i Sillabuseve (programeve)***

Janë hartuar programet sipas standardeve të nxjerra nga Senati dhe stafi menaxhues i UP-së dhe të njëjtat janë publikuar në web faqen e UP-së.

Në muajin nëntor është formuar ekipi për vlerësim, i cili kishte udhëzime të qarta për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë dhe mirëvajtjen e mësimit nëpër njësitë akademik. Ekipi ka raportuar rregullisht lidhur me angazhimin e mësimeve për mbajtjen e mësimit dhe realizimit të aktiviteteve tjera nga fushëveprimi i tyre.

➤ ***AKTIVITETET TJERA NË FUSHËVEPRIMTARINË E UNIVERSITETIT***

Gjatë Universitetin Veror të Prishtinës 2007 janë organizuar 15 kurse nga fusha të ndryshme: juridik, ekonomi, arkeologji, sociologji, shkencë teknike dhe natyrore si dhe kulturë fizike. Në UVP 2007 kanë marrë pjesë 450 studentë prej të cilëve rreth 150 studentë të huaj, 75 nga universitetet e regjionit të Ballkanit dhe 250 studentë nga Kosova. Gjatë tre javëve të UVP-së janë organizuar edhe shumë aktivitete shoqërore, kulturore, sportive si dhe janë organizuar një numër forumesh publike me tema aktuale për Kosovën dhe rajonin.

Qendra për Këshillim Akademik dhe Zhvillim të Karrierës e rrikuar Qendra për Shërbime të studentëve ka vazhduar një sërë aktiviteteve për studentët e UP-së. Ka bërë këshillimin dhe informimin e studentëve me të rehat në Universitet, ka shpërndarë lajmërimi për mundësinë e shfrytëzimit të bursave të ndryshme për studime jashtë vendit, ka ndërmjetësuar mundësi praktikash për studentët në ndërmarrje të ndryshme publike dhe private, ka kontaktuar me dekanet për organizime të aktiviteteve të ndryshme si dhe ka bashkorganizuar manifestimin dhe ndejën e fillimit të vitit akademik 2007/2008.

Meqë fondet e OSBE-se nuk janë të miratuara për vitin 2008, ekzistimi i kësaj qendre do të vëhet në pikëpyetje.

➤ ***Promovimi i Qendres së Resurseve për të rinj***

Është bërë promovimi i Qendrës së Resurseve për të rinj në Fakultetin Ekonomik si bashkëorganizim me Departamentin e Rinisë –Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, dhe të financuar nga: Granti Post-Konfliktuoz për Zhvillimin e Rinisë së Kosovës i siguruar nga Banka Botërore. Për herë të parë kjo qendër ka ndihmuar disa aktivitete të UVP 2007, duke organizuar Debatin “Jeta në Kosovë”, duke ofruar internet në shërbim për studentet e UVP-se gjatë tri javëve, duke organizuar një ekspozitë me fotografitë më të mira të UVP 2007, të bëra nga studentet për impresionet në Kosovë si dhe duke organizuar disa ndeja për studentët e UVP-së.

➤ ***Konferenca e donatorëve “Miq të UP-se”***

Me rastin e 37 vjetorit të UP-së, Zyra për Marrëdhënie me Jashtë ka organizuar një konferencë me donatorë ndërkombëtar për shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim me të ngushtë dhe konkretizim të projekteve ndërkombëtare. Në këtë konferencë janë shkëmbyer planet dhe strategjitë për vitin 2007 si dhe janë vënë një sërë kontaktesh të reja me persona përgjegjës në zyrat diplomatike për çështje të Arsimit të Lartë.

➤ ***“Summer University South Eastern Europe”***

Ky projekt është Universitet Veror i mbajtur në Budvë për 3 javë dhe është bashkëorganizuar me Universitetin e Vjenës dhe me Unversitetin Sarajevo, Universitetin Mostar, Universitetin Podgorica dhe Universitetin e Shkodrës, ku kanë marrë pjesë 6 studentë kosovarë nga Fakulteti Ekonomik I UP-se. Projekti si tërësi është koordinuar poashtu nga ZMJ e UP-së.

➤ **“Internships of UP” : 1 maj -1 tetor 2007**

Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me OSCE dhe Zyra Amerikane dhe ka pasur për qëllim t’u japë mundësi 30 studentëve të UP-së të bëjnë nga një praktikë për pesë muaj në institucione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Praktikanët kanë qenë të sistemuar në Administratën e UP-së, në banka të Kosovës, në KPA, në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës, etj. 3 studentë nga gjithsej 30 kanë arritur të punësohen në vendet ku kanë mbajtur praktikën. Projekti synohet të përsëritet sërish nga Janari 2008.

“Privat Sector Development (PSD)”, SPARK, UP dhe Oda Ekonomike

Ky projekt ofron mundësi shkëmbimi të studentëve të Ballkanit Perëndimor me qëllim që të bëhen të realizohen praktika në regjion dhe Evropë në ndërmarrjet private. PSD 1 është duke u implementuar, kurse PSD2 do të implementohet gjatë 3 viteve të ardhshme.

➤ **“Interships”: USAID, UP dhe Oda Ekonomike**

Ky projekt është në zhvillim e sipër dhe do të jetë një mundësi tjetër për praktika për studentët e UP-së në bizneset kosovare. Projekti për përformimin e Qendrës për Resurse Njerëzore, si mundësi për aktivitete për organizatat studentore si dhe grupe studentore që dëshirojnë të organizojnë aktivitete. Kjo qendër është e vendosur në Fakultetin Ekonomik (ish-Byfeja).

Projekti i USAID për përmirësimin e performancës së Universitetit të Prishtinës si dhe përmirësimin e strategjisë së UP-së.

➤ **Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me asociacionet si: ATA, DAAD, Banka Botërore, OSBE, Zyrat Diplomatie në Prishtinë dhe faktorët tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Vizita e Rektorit Prof. Dr. Enver Hasani në Saksonin e Ulët (shkurt 2007)

Nënshkrimi i tri Marrëveshjeve bashkëpunimi me: Universitetin e Hannoverit, Universitetin e Braunschweigut dhe Universitetin Teknik të Klausthalit.

2. Vizita në Paris (bashkëpunimi me Universitetin Paris VIII dhe Poitiers)

3. Vizita në Turqi (ISIK dhe Fatih University Stamboll), Trakia University (Edrenë),

4. Vizitë në Gjermani (takime me Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Regensburg)

5. Vizitë studimore në Universitetin e Peleponezit, në Greqi.

✚ INSTITUTIT ALBANOLOGJIK I PRISHTINËS

I. DEGA E GJUHËSISË me sektorët:

- *Dialektologji,; Leksikologji,; Onomastikë dhe; Kulturë e Gjuhës, organizoi:*

Tryezën shkencore me rastin e 90 vjetorit të lindjes së akademik Idriz Ajetit, 22 maj 2007.

VEPRIMTARIA BOTUESE

Botimet e veçanta

1. Materialet e sesionit shkencor mbajtur me rastin e 400-vjetorit të lindjes së Frang Bardhit.

Revistat shkencore

1. *Gjurmime Albanologjike, seria filologjike nr.36 (bashkë me degën e Letërsisë)*
2. *Gjuha shqipe 1, 2, 3 – 2007*

Publikime individuale

1. *Gjatë vitit 2007 punonjësit e Degës së Gjuhësisë kanë publikuar mbi 20 punime studimore, që janë botuar në revistat e IAP-së, revistat e ndryshme në Kosovë, në Shqipëri e gjetiu.*
2. *Në konferencat, sesionet, simpoziumet e aktivitetet e ndryshme e ndryshme shkencore që i kanë organizuar IAP, Akademia e Shkencave e Kosovës, Fakulteti i Filologjisë në Prishtinë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga punonjësit e Degës së Gjuhësisë janë lexuar mbi 20 kumtesa shkencore.*
3. *Nga këta punonjës janë shkruar edhe disa recensionet për vepra të ndryshme të botuara nga fusha e albanologjisë. Recensionet janë botuar në revista shkencore ose me rastin e promovimeve të librave nga kjo fushë.*

VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Gjatë vitit 2007 ka vazhduar puna në projektet:

1. *E folmja e Karadakut, dr. Mehmet Halimi*
2. *Fjalor onomastik i trojeve shqiptare në Mal të Zi, dr. Mehmet Ahmetaj*
3. *Gjuha e shkrimeve të vjetra (shek.XV – XVIII), dr. Ragip Mulaku*
4. *Gjuha e Gjergj Fishtës, dr. Shefkije Islamaj*
5. *Bibliografia e veprave në gjuhën standarde në fushën e gjuhësisë, mr. Ibrahim Goçi (është përfunduar)*
6. *Rreth prejardhjes së ojkonimisë së Kosovës, dr. Rexhep Doçi*
7. *Fjalori i Frang Bardhit, dr. Naser Pajazitit*
8. *Fjalor i mediave, dr. Qemal Murati*

Hulumtime individuale në biblioteka

Nga kjo degë tre punonjës kanë realizuar qëndrime hulumtuese në Tiranë, të cilat kanë qenë ditët e planifikuara për hulumtime sipas projekteve të tyre individuale. Projektet janë të miratuara nga Këshilli shkencor i Institutit, në kuadrin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

✚ II. DEGA E LETËRSISË

me sektorin e përgjithshëm organizoi sesionin shkencor:

Letërsia në shkolla dhe në fakultete, mbajtur më 14 dhjetor 2007

VEPRIMTARIA BOTUESE

Botimet e veçanta

Krijimtaria shkencore dhe letrare e Rexhep Qosjes, materiale të botuara nga sesioni i mbajtur më 2006.

Revistat shkencore

Gjurmime Albanologjike, seria filologjike nr. 36 (bashkë me degën e Gjuhësisë)

Publikime e prezente individuale

1. *Gjatë vitit 2007 punonjësit e Degës së Letërsisë kanë botuar mbi 10 punime studimore në revista shkencore e periodikë letrarë.*
2. *Janë prezentuar me mbi 20 kumtesa shkencore në seminare, simpoziume e konferenca shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare.*
3. *Nga këta punonjës janë shkruar disa recensionet për vepra të ndryshme të botuara në periodikë e gazeta nga fusha e letërsisë shqipe.*

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE

Gjatë vitit 2007 kanë vazhduar të punohen projektet:

1. *Portrete historike, akad. Rexhep Qosja*
2. *Udhëpërshkruesit francezë në trojet shqiptare, dr. Ymer Jaka*
3. *Letërsia shqipe 1939 – 1944, dr. Hysen Matoshi*
4. *Përmasa botërore e vlerës së veprës së Ismail Kadaresë, dr. Emin Kabashi*
5. *Petro Marko – jeta dhe vepra, dr. Emin Kabashi*
6. *Aspekte të mendimit kritik në vitet 30, dr. Resmije Kryeziu*

7. *Historia e letërsisë së sotme Shqipe, mr. Fadil Graçevci*
8. *Zhvillimi i kritikës letrare shqipe 1944 – 2000, mr. Arben Hoxha*

III. DEGA E FOLKLORIT

me sektorët:

- *Letërsi Popullore dhe Etnomuzikologji*

VEPRIMTARIA BOTUESE

Botimet e veçanta:

1. *Këngë popullore historike I-IV, Rr. Berisha, S. Feti, F. Syla, A. Zejnullahu, J. Ahmeti.*
- revistat shkencore
1. *Gjurmime Albanologjike, seria folklor dhe etnologji, 36 (bashkë me Degën e Etnologjisë)*
Publikime individuale
1. *Nga punonjësit e Degës së Folklorit janë paraqitur mbi 20 punime studimore në revista, periodikë e libra me studime.*
2. *Janë prezentuar mbi 30 kumtesa shkencore në simpoziume e konferenca shkencore në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Poloni, si dhe referime në tryeza që kanë organizuar festivalet e folklorit.*
3. *Janë publikuar shumë recensione për vepra të botuara nga fusha e folklorit në Prishtinë e Tiranë.*

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE

Gjatë vitit 2007 ka vazhduar puna në projektet:

Projektet individuale

1. *Femra në eposin legjendar, dr. Rrustem Berisha*
2. *Tradita muzikore gojore e fëmijëve në kontekstin e antropologjisë muzikore (ritmi, melodija, loja), dr. Rexhep Munishi*
3. *Këngë epike historike, dr. Zymer Neziri*
4. *Epika legjendare e Rugovës, dr. Zymer Neziri*
5. *Anton Çetta – jeta dhe vepra, mr. Jahir Ahmeti*
6. *Kosova; Tradita dhe bashkëkohësia (me vështrim të veçantë në folklorin), dr. Kujtim Rrahmani*
7. *Poetika e Gjëgjëzës, mr. Leontina Gega-Musa*
8. *Rrëfimi personal si lloj i letërsisë gojore, mr. Arbnora Dushi*
9. *Tradita etnomuzikore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, mr. Albin Sadiku*
10. *Format muzikor në doke, rite e zakone tradicionale në Kosovë, Bahtir Sheholli.*

Projektet e përbashkëta

1. *Fjalori i folklorit dhe i etnologjisë – IKP - IAP*
2. *Këngë historike, bleu V, dr. Zymer Neziri, dr. Adem Zejnullahu, dr. Jahir Ahmeti*
3. *Epika legjendare e Rugovës, bleu I, dr. Zymer Neziri*
4. *Fabula shqiptare, dr. Adem Zejnullahu, dr. Myzafere Mustafa*
5. *Fjalë të urta, dr. Kujtim Rrahmani, mr. Arbnora Dushi*
6. *Urime dhe mallkime, mr. Jahir Ahmeti, mr. Leontina Gega – Musa*

Hulumtime individuale në terren dhe në biblioteka jashtë vendit

1. *Nga kjo degë janë realizuar dy qëndrime të shkurtëra hulumtuese në Tiranë.*
2. *Janë realizuar ditë të punës në terren në Rugovë, Krasniqe, Lezhë, Lumë, Kurbin, Has dhe në Malësinë e Gjakovës.*

IV. DEGA E ETNOLOGJISË

VEPRIMTARIA BOTUESE

Publikime individuale

Punonjësit e kësaj dege (3 sish) janë paraqitur me kumtesa në aktivitete shkencore të organizuara në Kosovë e në Shqipëri, si dhe kanë publikuar punime studimore në revista shkencore.

VEPRIMTARIA KËRKIMORE SHKENCORE

Ka vazhduar puna në projektet:

- 1. Vende kulte në Kosovë, dr. Ukë Xhemaj*
- 2. Elemente të trashëgimisë dhe globalizimi, Lumnie Kadriu*
- 3. Dasma në Malësinë e Karadakut, Ramadan Ibrahim*

Ka përfunduar projekti i përbashkët me Institutin e Kulturës Popullore të Tiranës:

“Veshjet popullore të Kosovës”

✚ V. DEGA E HISTORISË

me sektorët: Histori e Përgjithshme dhe Arkeologji

VEPRIMTARIA BOTUESE

- botimet e veçanta;

revistat shkencore

- 1. Gjurmime Albanologjike, seria e shkencave historike 36*

Publikime individuale

- 1. Gjatë vitit 2006 punonjësit e degës së Historisë kanë marrë pjesë me mbi 20 kumtesa shkencore në konferenca e tribuna shkencore që janë organizuar në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Kroaci e Poloni.*
- 2. Po ashtu punonjësit shkencorë të kësaj dege janë prezentuar me një varg punimesh (mbi 20 punime shkencore) në simpoziume kombëtare e ndërkombëtare.*
- 3. Kanë publikuar edhe shumë studime e recensione për botime të veçanta nga fusha e historisë.*

Hulumtime për projekt

- 1. Është realizuar një qëndrim i shkurtër studimor në Shqipëri*

PROJEKTET KËRKIMORE SHKENCORE

Gjatë vitit 2007 kanë vazhduar të punohen projektet:

Projekte individuale

- 1. Kryengritja shqiptare e vitit 1912 në dokumentet serbe, dr. Zekeria Cana*
- 2. Shaban Kapuçi në kujtesën historike 1893 – 1910, dr. Muhamet Pirraku*
- 3. Plastika e kultit dhe profane e punuar në metal dhe terrakotë në Dardani gjatë kohës romake, dr. Exhlale Dobruna – Salihu*
- 5. Gjurmët epigrafike të besimeve dhe kulteve parakrishtere në Dardani, dr. Naser Ferri*
- 6. Religjioni dhe kishat në Kosovë gjatë periudhës mesjetare, dr. Lulëzim Lajçi*
- 7. Relikte të krishterimit të hershëm në Dardani, mr. Kujtime Boshtrakaj*

Projekte të përbashkëta

- 1. Çështja shqiptare në Kongreset dhe Konferencat ndërkombëtare*
 - Çështja shqiptare në Kongresin e Berlinit, dr. Shkelzen Raça,*
 - Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, dr. Xheladin Shala,*
 - Çështja shqiptare në Konferencën e Parisit, dr. Daut Bislimi,*
 - Çështja shqiptare në Konferencën e Versajës, dr. Lush Culaj.*

RAPORTI VJETOR I BKUK-së PËR VITIN 2007

✚ Hyrje

Puna dhe veprimtaria e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës gjatë vitit 2007 është realizuar në mbështetje të ligjeve dhe akteve të tjera normative që e rregullojnë veprimtarinë bibliotekare. Ky raport pasqyron punën njëvjeçare - gjatë vitit 2007, të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës (BKUK), që përfshin: realizimin e projekteve që janë paraparë të kryhen gjatë vitit 2007, si dhe të veprimtarisë së përhershme, të cilat janë në përputhje me obligimet dhe përgjegjësitë institucionale dhe të mbështetura e të financuara nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, përkatësisht Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë.

✚ Infrastruktura

Në përputhje me buxhetin e planifikuar për infrastrukturë, janë hartuar dhe realizuar projekte gjatë vitit 2007, që mbulojnë fushat si: rregullimi i enterierit të brendshëm të bibliotekës; mirëmbajtje dhe riparime teknike dhe teknologjike të objektit - ngrohje, klimatizim, pajisje elektrike; pajisje teknike dhe të inventarit; pajisje dhe menaxhim të resurseve nga fusha e teknologjisë informative etj.

✚ Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, vijon të bashkëpunojë me institucione të rëndësishme bibliotekare dhe jobibliotekare, nga përkrahja e të cilave ka përfituar edhe në fushë e aftësisë të personelit bibliotekar - në përputhje me zhvillimet e reja në fushë të bibliotekarisë. Në këtë kontekst vlen të veçohet bashkëpunimi me disa nga këto institucione.

➤ Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Kolegji Simons - SHBA

Në kuadër të Projektit për zhvillimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare, kanë qëndruar për trajnim në BKUK ekspertë amerikanë nga fusha e bibliotekarisë dhe shkencave informative të udhëhequr nga Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Kolegji Simons (ShBA).

Trajnimi i personelit është përqendruar në fushën e referencave, të katalogimit, të teknologjisë së informacionit, të zhvillimit të koleksioneve lëndore, si dhe të planifikimit të shtrirjes së rrjetit të bashkëpunimit të bibliotekave degë të Universitetit të Prishtinës me Qendrën e Bibliotekës Universitare.

➤ Biblioteka Kombëtare e Francës “Francois Mitterrand”

Si rezultat i bashkëpunimit të BKUK-së me Bibliotekën Kombëtare të Francës “Francois Mitterrand”, kanë qëndruar në BKUK, në intervale të ndryshme kohore, - z. Jean Yves Sarazin, udhëheqës i Restaurimit në Bibliotekën Kombëtare të Francës, dhe Bernard Gallois, ekspert i Restaurimit dhe Konservimit i kësaj biblioteke. Të dy ekspertët gjatë vizitave të tyre kanë mbajtur ligjërata dhe trajnime në fushën e restaurimit dhe konservimit, duke ofruar njohuri dhe ndihmë konkrete në fusha specifike. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, një udhëheqës i Restaurimit dhe Konservimit i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ka qëndruar, 3 muaj, për specializim në Bibliotekën Kombëtare të Francës në Paris.

➤ OSBE - Projekti për përmirësimin e cilësisë në BKUK

Projekti i OSBE-së, i Departamentit për Qeverisje të Mirë dhe Institucione Demokratike - Njësia për Arsimim të Lartë, ka mbështetur BKUK-në në infrastrukturë dhe në trajnime (aftësim profesional) në fushë të trajnimeve, janë sjellë tre ekspertë nga fusha e teknologjisë informative. Aftësimi ka përfshirë fushat në vijim: konfigurimin dhe manipulimin me programin Aleph 500 në modulet e Pasurimit dhe të Qarkullimit; përdorimin e sistemit menaxhues për qasje në Athens (program për menaxhimin e revistave elektronike); përdorimin e sistemit menaxhues për rezervim të kompjuterëve me anë të programit Envisionware; menaxhim të moduleve operacionale të sistemit administrativ dhe sistemit bibliotekar të Aleph 500. Në kuadër të kësaj ndihme: është bërë abonimi (falas për BKUK) në Sistemin menaxhues për qasje në Athens dhe në koleksionet e Oxfordit, si dhe vlerësim i brendshëm për aranzhim të resurseve fizike dhe digjitale të bibliotekës. Në fushë të pajisjeve teknike, BKUK ka përfituar: kompjuterë për shfrytëzim nga studentët e magjistruar dhe ata që ndjekin doktoraturën; printer të formatit A3 dhe A4, së bashku me opsionet për skanim, fax, dhe rrjetë; aparat TV me ekran të madh për shfaqje të programeve të ndryshme; proejktor LCD për nevoja të ndryshme etj.

➤ Instituti Juglindor i Universitetit të Mynihut

Në kuadër të bashkëpunimit me institucione të huaja shkencore, që është mundësuar nga komunikimi dhe ndërmjetësimi me Institutin Juglindor të Universitetit të Mynihut i dr. Enver Hoxhaj, profesor në Departamentin e Shkencave Politike të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, BKUK ka përfituar një donacion të çmuar të librave dhe revistave në gjuhën gjermane, me përmbajtje nga: gjuha, kultura, dhe historia albanologjike dhe ballkanologjike, që përbëhet nga: 113 tituj libra dhe revista, përkatësisht 215 ekzemplarë.

➤ **Biblioteka e Bashkësisë Evropiane**

Me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Iniciativës Evropiane të Kosovës, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Zyrës Ndërlidhëse të Gjermanisë, është hapur edhe Biblioteka Evropiane e Kosovës, e cila në fondin e saj fillestar tashmë do të ketë më shumë se 1500 tituj nga Evropa dhe më shumë se 2000 tituj librash elektronikë - kryesisht nga fusha e mjekësisë, psikologjisë dhe shkencave natyrore. Ky është njëri ndër projektet më të rëndësishme, që do të kontribuojë në afirmimin e kulturës evropiane, përkatësisht në fushën e integritimeve kulturore. Pra, ky është një kontribut i veçantë i Qeverisë Gjermane dhe në veçanti Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, i cili ka dhënë të hollat për të bërë pajisjen e parë me libra në këtë bibliotekë. Kjo bibliotekë studentëve u jep mundësi që të njihen me politikat evropiane, me kulturën, me çështjet ligjore dhe gjithashtu me çështjet ekonomike.

➤ **Bashkëpunimi me institucione të tjera ndërkombëtare**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës vijon të mbajë kontakte të përhershme me institucione të rëndësishme ndërkombëtare, si me: IFLA; Agjencinë Ndërkombëtare të ISBN-së, eIFL.net - udhëheqja e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, Ex-Libris (kompania për sistemin e automatizuar bibliotekar), ISMN (Agjencinë Ndërkombëtare të Numrit të Muzikës), Bibliotekën e NATO-s etj.

✓ **Bashkëpunimi me institucione të Kosovës dhe biblioteka vendëse**

Bashkëpunimi me institucionet të Kosovës dhe biblioteka vendëse dhe ato shqiptare jashtë, është realizuar në kuadër të projektit afatgjatë të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës për themelimin, zhvillimin dhe ndihmën bibliotekave të Kosovës, si dhe bibliotekave jashtë Kosovës me rëndësi kombëtare. Gjatë vitit 2007 janë nënshkruar memorandume dhe janë realizuar projekte që mbështesin bibliotekat dhe veprimtarinë bibliotekare.

➤ **Memorandumet**

-Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Kuvendin e Kosovës dhe Projektin e Unionit Evropian "Mbështetje e Mëtejme Kuvendit të Kosovës për krijimin dhe zhvillimin e Bibliotekës së Kuvendit të Kosovës, i cili është realizuar sipas pikave të memorandumit, që parashohin ndihmë profesionale në fushë të katalogimit, klasifikimit dhe pasurimit të fondeve. Biblioteka e Kuvendi të Kosovës tashmë është krijuar dhe në të kanë qasje të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës.

- Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë për përkrahje në krijimin dhe zhvillimin e bibliotekave të burgjeve të Kosovës. Me përkrahjen e BKUK-së, është themeluar Biblioteka e Burgut të Dubravës, dhe është ndihmuar me fonde Qendra Korrektuese në Lipjan. Përveç që janë ndihmuar me fonde, koleksione në këto dy biblioteka janë përpunuar, klasifikuar dhe radhitur në raftet me ndihmën e stafit profesional të BKUK-së.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Arkivin e Kosovës. Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi i dyanshëm për aktivitete dhe veprimtari që janë në interes të dy institucioneve, në këtë kontekst edhe të këmbimit të materialeve të rëndësishme, si: libra, harta, gazeta, revista, mikrofilma e materiale të tjera në interes të dy institucioneve.

➤ **Themelimi dhe zhvillimi i bibliotekave**

Në kuadër të projektit për themelimin, zhvillimin dhe përkrahjen e bibliotekave të Kosovës dhe atyre jashtë Kosovës - me interes kombëtar, gjatë vitit 2007, me përkrahjen profesionale dhe ndihmën në fonde nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, janë themeluar:

-Biblioteka Shqiptare në Cyrih (Zvicër);Biblioteka e Qendrës Kulturore Shqiptaro-Amerikane në Dallas (ShBA);Biblioteka Komunale e Vitisë;Biblioteka e Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Ndërsa, në pasurimin e fondeve, janë ndihmuar: Bibliotekat Ndërkombëtare të komunave kryesore të Kosovës: Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Prizrenit, Ferizajt, Gjilanit

Biblioteka për persona me aftësi të kufizuara “Hendifer” në Ferizaj;-Biblioteka në fshatin Fierzë në Pejë;Biblioteka e Shkollës Filllore “Faik Konica” në Prishtinë;Biblioteka e Gjmnazit Filologjik “Eqrem Çabej” në Prishtinë.

Projektet

➤ **Implementimi i programit ALEPH 500 në Bibliotekat Ndërkomunale të Kosovës**

Pas 3 vjet implementimi të programit të automatizuar bibliotekar ALEPH 500, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, ka filluar projektin për zgjerimin e këtij programi, përkatësisht krijimin e rrjetit unik bibliotekar në tërë Kosovën, në bibliotekat kryesore ndërkomunale të Kosovës. BKUK ka dhënë falas nga një licencë të Programit të automatizuar bibliotekar Aleph 500, për shtatë bibliotekat ndërkomunale, (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan), të cilat do të fillojnë t'i fusin të dhënat e njërive bibliotekare në këtë program, me ç'rast do të nisë krijimi i katalogut të përbashkët online për tërë Kosovën. Licenca e parë tashmë i është dhënë Bibliotekës ndërkomunale të Prizrenit, ndërsa së shpejti do të shtrihet edhe në bibliotekat e tjera ndërkomunale.

Projekti parashihet të shtrihet edhe në bibliotekat e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, si dhe në bibliotekat e veçanta. Ky projekt është mbështetur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa pritet të përkrahet edhe nga institucione të tjera financiare të Qeverisë së Kosovës.

➤ **Projekti për zhvillimin e Bibliotekës së Fakultetit Juridik**

Projekt i inicuar dhe i udhëhequr nga World Learning (agjenci kontraktuese e USAID-it për implementim të projekteve në fushën e arsimit), që është ndihmë në zhvillimin e bibliotekave të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, ka filluar në Bibliotekën e Fakultetit Juridik, me përkrahjen dhe ndihmën profesionale të stafit të BKUK-së.

Pas vlerësimit të gjendjes së Bibliotekës dhe të personelit në Bibliotekën e Fakultetit Juridik të Prishtinës, është hartuar projekti nga anëtarë të stafit të BKUK-së, me ndihmën e World Learning, për zhvillimin dhe rimëkëmbjen e kësaj biblioteke.

Projekti ka përfshirë mbi 60-ditë trajnim, të mbajtura nga stafi i BKUK-së për punëtorë të bibliotekës së Fakultetit Juridik dhe ka përfshirë aktivitete praktike dhe teorike me tema specifike nga fusha profesionale të bibliotekarisë, si: katalogim, klasifikim dhe radhitje; burime elektronike dhe programe themelore të kompjuterit; pasurim, zhvillim dhe menaxhim të koleskioneve; përdorim i bazës së të dhënave dhe menaxhim i serverit; zhvillim i rregullorve themelore të veprimtarisë së bibliotekës etj.

Manifestimet bibliotekare

Në kuadër të manifestimeve me rëndësi të veçantë për bibliotekarinë dhe bibliotekat në Kosovë dhe në Shqipëri, të cilat tashmë po shënojnë rezultate inkurajuese, janë: manifestimi ndërkombëtar: “Java e Bibliotekës në Kosovë”, dhe manifestimi kombëtar: “Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë”, e cila një vit mbahet në Tiranë dhe një vit në Prishtinë.

➤ **Java e Bibliotekës në Kosovë**

Java e Bibliotekës në Kosovë 16-21 prill 2007 - aktiviteti më i rëndësishëm bibliotekar në Kosovë, u mbajt për të pestën herë që prej themelimit - në vitin 2003. Ky aktivitet, që është shndërruar në një institucion në vete me karakter ndërkombëtar, vazhdon të organizohet nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë. Edicioni i pestë i Javës së Bibliotekës në Kosovë u karakterizua me aktivitete të rëndësishme përmbajtësore me interes për bibliotekat dhe kulturën në Kosovë, duke veçuar ligjërata, seminare, sesione e prezantime me pjesëmarrje të një numri të madh të ekspertëve dhe bibliotekarëve ndërkombëtarë e vendës, me tema që zgjuan interesim të publikut, si ato të: Michael Kaplan, drejtor për Produkte Digjitale (Ex Libris, ShBA), me temat si: “Përtej Aleph-it: programet bibliografike, katalogët përmbledhës, pamjet e përgjithshme të katalogëve, katalogët përmbledhës kombëtar”, “Menaxhimi i përmbajtjeve digjitale për

koleksionet e depoziturave për trashëgiminë kulturore dhe institucionale”, “Krijimi bibliografik – Amazoogole”, “Mjetet bibliografike, konvertimi retrospektiv dhe katalogët shumëfunktional” Mario Gonzalez, drejtor Ekzekutiv i Bibliotekës Greenwich (ShBA), me temat si: “Çështje thelbësore të administrimit të bibliotekave”, “Filozofia dhe roli i bibliotekave publike: historia, vlerat themelore, bibliotekat publike në epokën e informacionit, bibliotekat në shoqëri shumë-etnike, programet, shërbimet për publikun”, “T’u shërbesh komuniteteve të ndryshme”, “Çështje buxhetore dhe të ngritjeve të fondeve”, “Teknologjia e informacionit dhe e ardhmja e materialeve të shtypura”;

Jean-Arthur Creff, drejtor i Bibliotekës së NATO-s në Bruksel, me temat: “Agjenda aktuale e NATO-s”, “Zhvillimi i Depoziturës së Bibliotekës së NATO-s në BKUK”.

Ishin të rëndësishme edhe sesionet nga drejtues vendës, si ato të: Sali Bashotës (BKUK), Enver Hasanit (UP), Lawrence Corwin (Zyra Amerikane në Prishtinë), Hava Ismajli (F. Juridik), Osman Gashi (F. i Filologjisë), Besim Kokollari (QBU) Jusuf Osmani (Arkivi i Kosovës), Ibrahim Gashi (Këndi Amerikan), Svetlana Breca (Zyra e ShBA-ve në Prishtinë)

Gjatë Javës, gjithashtu, është organizuar sesion i veçantë: “Krist Maloki në Kosovë”, si dhe ekspozitë e titujve të rrallë nga Biblioteka e Krist Malokit - tashmë pronë e BKUK-së, e cila është lënë amanet nga autori që t’i dhurohet Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Këtë vit është organizuar ekspozitë me fotografi: Java e Bibliotekës 2003 – 2006; ekspozitë e shkrimeve për BKUK, të gazetave të përditshme; ekspozitë: “Kosova në harta ndër shekuj”, e organizuar nga Zyra e Kryeministrit, Arkivi i Kosovës dhe BKUK; ekspozitë e skulpturave nga skulptorë nga Kosova.

Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mes BKUK-së dhe Arkivit të Kosovës, si dhe, në kuadër të bashkëpunimit, janë përruruar biblioteka të reja në: Viti, Fierzë; Ferizaj.

Ndërsa, në Ditën e Donatorëve, gjatë Javës, nga BKUK janë dhuruar libra për bibliotekën e Shkollës Filllore “Faik Konica”, dhe të Gjinnazit të Filologjisë “Eqrem Çabej”, në Prishtinë.

-Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë “Biblioteka dhe Kujtesa Kombëtare”

E themeluar në shtator të vitit 2006, si institucion i ri kulturor-shkencor i përbashkët Shqipëri-Kosovë, Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë realizoi, më 20-22 nëntor 2007 - edicionin II, në Prishtinë me temë “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”, me synimin për trajtuar problematika që lidhen me zhvillimin e mendimit kombëtar, në fushën e shkencës së bibliotekarisë, me funksionimin e sistemit të bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë, në mënyrë të veçantë në kuadrin e sfidave për ruajtjen e trashëgimisë kombëtare.

Në bazë të marrëveshjes themeluese, nënshkruar mes Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dr. Aurel Plasari, dhe Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare e Universitare të Kosovës, dr. Sali Bashota, Konferenca është organizim i përvitshëm, përkatësisht: një vit në Tiranë, një vit në Prishtinë. Ajo mbledhet nën kujtesën dhe mbështetjen të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë dhe të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës. Konferenca zhvilloi edicionin e saj të dytë me temë “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Në të morën pjesë autoritete të drejtimit dhe menaxhimit të bibliotekave kombëtare, universitare, vendore etj. nga Shqipëria dhe Kosova, si dhe specialistë të shkencës dhe teknologjisë së bibliotekarisë nga të dyja vendet.

Ajo trajtoi problematika që lidhen me zhvillimin e mendimit kombëtar në fushën e ruajtjes së kujtesës kombëtare, nëpërmjet dokumenteve e informacioneve burimore dhe dokumenteve të tjera në formë të ndryshme, të cilat përcaktojnë identitetin tonë nacional, duke iu përgjigjur zhvillimeve të shkencës së bibliotekarisë si dhe funksionimit të sistemit të bibliotekave në Shqipëri dhe Kosovë.

Bazuar në gjendjen konkrete të bibliotekave, si dhe të problemeve e reflektimeve që u dhanë gjatë Konferencës, për mbledhjen, dokumentimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, nga pjesëmarrësit është miratuar edhe rezoluta që parasheh mundësitë e bashkëpunimit mes

bibliotekave kombetare në Kosovë dhe Shqipëri, si dhe sensibilizimi në nivel qeveritar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare.

➤ **Dita Botërore e Librit**

Për herë të parë, nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është organizuar manifestimi Dita Ndërkombëtare e Librit dhe e të Drejtës së Autorit. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë nxënës, studentë, shkrimtarë, botues dhe përfaqësues të institucione të Kosovës. Manifestimi është përshëndetur nga përfaqësues të rëndësishëm të kulturës dhe të institucioneve, ndërsa për nder të këaj Dite, BKUK ka dhuruar 99 libra për lexuesit e moshave dhe profileve të ndryshme.

✚ **Veprimtaria botuese**

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës vijon të botojë një seri titujsh të librave, doracakëve, broshurave, katalogëve etj., që janë një ndihmë e veçantë dhënë bibliotekarisë dhe mendimit bibliotekar në Kosovë, si dhe ndihmë në informacion për përdoruesit e profileve të ndryshme, botuesit, dhe institucione të tjera shkencore, kulturore e arsimore.

Tituj të botuar nga BKUK gjatë vitit 2007, janë:

1. Formati MARC : të kuptuarit e njëjësive bibliografike / Përktheu Besim J. Kokollari, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 2. Katalog i titujve të zgjedhur të Bibliotekës së Krist Malokit, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 3. Java e Bibliotekës në Kosovë, 3-8 Prill = April 2006 / Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 4. Integrimi në sistemin e ISBN-së : ISBN 978-9951-Kosovë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 5. Islam Krasniqi, Bibliografi : e punimeve pedagogjike të botuara në gjuhën shqipe në periodikun pedagogjik : (1945-1978), Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 6. Katalog i Disertacioneve të Doktorateve : 1999-2004, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 7. Udhëzues : për përdorimin e burimeve elektronike, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007; 8. ISMN Numri Standard Ndërkombëtar i Muzikës : doracak për përdorues / Përktheu Besim J. Kokollari, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës dhe Shoqata e Bibliotekarëve të Kosovës, Prishtinë 2007; 9. William A. Katz, Hyrje në punën e referencave ; Përktheu Avni Spahiu. Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, Prishtinë 2007 10. Biblioetra, (Revistë e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës), Viti 4, Numri (1), (2), (3), Prishtinë 2007.

✚ **Shërbimet bibliotekare**

Në këtë pjesë përfshihen aktivitetet dhe rezultatet, që janë pjesë e punëve të veçanta bibliotekare që kryhen, në përputhje me detyra dhe përgjegjësitë, nga departamente, sektorë e shërbime të BKUK-së.

❖ **Departamenti i Zhvillimit të Koleksioneve**

Në Departamentin e Zhvillimit të Koleksioneve, gjatë vitit 2007:

- janë krijuar të dhëna relativisht të sakta për sasinë a fondit bibliotekar të pranuar nga: ekzemplari i detyrueshëm, blerja, dhurata; hartimi i pasqyrave për sasinë e fondit bibliotekar të pranuar (trajtimi i tyre); ekzemplari i detyrueshëm (verifikimi mes titujve të dorëzuar dhe atyre të botuar nga shtëpitë botuese), blerja (verifikimi mes listave të blerjes dhe materialit të pranuar; reklamimi i titujve, kontrollimi i çmimeve të tyre; dhurata (verifikimi i materialit të dhuruar);

- janë përshkruar njësi bibliografike në listat përcjellëse të materialit bibliotekar (numri i titujve dhe sasia e ekzemplarëve) dhe janë dorëzuar, sipas vlerësimit, në Departamentin e Arsimimit; Departamentin e Koleksioneve të Veçanta, në Qendrën e Bibliotekës Universitare;

- në depon e pranimit të librit (blerje, ekzemplar i detyrueshëm, dhuratë), është bërë verifikimi dhe kontrollimi i titujve të librave me ndihmën e katalogut – që të mos dublohen librat që hyjnë në fondin e BKUK-së;

- janë krijuar pasqyra korrekt) të raportit mes listave të hyrjes së materialit bibliotekar, në një rën anë, dhe të dhënave nga përpunimi fizik, fondi tepricë dhe fondi për shkëmbim, në anën tjetër; është ndarë fondi tepricë, si dhe është përzgjedhur numri i titujve dhe i ekzemplarëve që ruhen për shkëmbim; - është pasuruar lista e adresave të botuesve nga Kosova, Shqipëria, si dhe botuesve shqiptarë nga Maqedonia; janë vënë kontakte me shtëpi të rëndësishme botuese me të cilat është promovuar rrjeti i shkëmbim) të informacionit bibliografik . Më poshtë po japim të dhënat e përpunuara dhe të specifikuara sipas kategorive të statistikave:

Tabela 1. Pranimi i fondeve në BKUK nga format e pasurimit: blerje, ekzemplar i detyrueshëm, dhuratë

Blerje	tituj: 744	ekzemplarë: 2399
Ekzemplar i detyrueshëm	tituj: 361	ekzemplarë: 1549
Dhuratë	tituj: 1042	ekzemplarë: 2159
Gjithsej	2147	6107

Buxheti i shpenzuar për fonde bibliotekare gjatë vitit 2007

Nga buxheti i BKUK-së	35,611 €
------------------------------	-----------------

1. Në numrin e përgjithshëm, nga ekzemplari i detyrueshëm prej 361 tituj (1485 ekzemplarë), janë pranuar, 64 tituj (64 të doktoraturave, si dhe 114 tituj) të punimeve të magjistraturave – që do të thotë gjithsej 178 tituj/ekzemplarë;

2. Ekzemplar i detyrueshëm - 407 tituj, përkatësisht 1585 ekzemplarë, nga këta 282 tituj libra, (1259 ekzemplarë), si dhe 15 tituj revista (75 ekzemplarë);

3. Dhurata më e rëndësishme ka qenë fondi i librave dhe revistave nga Sudost-Institut i Universitetit të Vjenës - 113 tituj libra dhe revista, përkatësisht 215 ekzemplarë.

Numri i njësive të parakataloguara në Modulin e Pasurimit, (Programi ALEPH 500), i njësive të reja (libër) që kanë hyrë në BKUK

Libra të parakatalogura (tituj të rinj)	1243 tituj
--	-------------------

Tabela 2. Përpunimi (vendosja e etiketave, nr. të signaturës, si dhe e Kodit të Sigurisë së Librit), të titujve të rinj, si dhe titujve retrospektivë

Vendosja e signaturës së librit - për ekzemplarin e parë:	961 njësi
Vendosja e signaturës së librit - për dublikate:	1222 njësi
Vendosja e etiketave dhe Kodit të Sigurisë së Librit:	2535 njësi
Kontrollime në Katalog për njësi të caktuara:	49 tituj
Verifikim i njësive në Inventarin e Koleksioneve të Veçanta:	35 njësi
Anulim i numrave të dubluar:	70 tituj
Tërheqje e librave nga Fondi i përgjithshëm (teprica):	129 tituj
Gjithsej	5001 njësi/tituj

Tabela 3. Regjistrimi i librave dhe verifikimi i tyre – a janë apo jo në fondin e BKUK-së, gjatë vitit 2007, - botime kryesisht të para viteve '90, që kanë hyrë dhuratë gjatë viteve të mëhershme, kryesisht në gjuhën shqipe, dhe më pak në gjuhën angleze dhe serbokroate

Janë regjistruar dhe kontrolluar në skedar:	781 tituj
Janë gjetur në katalogun e BKUK-së:	284 tituj
Nuk janë gjetur në katalogun e BKUK-së:	411 tituj

Tabela 4. Të dhëna nga ISBN-ja për identifikues të titujve dhe të botuesve

Identifikues të titujve:	685 tituj
Identifikues të botuesve:	118 botues

Tabela 5. Libra të dhuruar për Bibliotekat Ndërkomunale të Kosovë - ish-donacion i KFOR-it amerikan për BKUK-në

BN "Fan Noli" - Gjilan:	131 tituj	659 ekzemplarë
BN - Gjakovë:	125 tituj	609 ekzemplarë
BN "Azem Shkrelji" - Pejë:	174 tituj	737 ekzemplarë
BN - Prizren:	152 tituj	683 ekzemplarë
BN Ferizaj	115 tituj	607 ekzemplarë
BN "Latif Berisha" - Mitrovicë	138 tituj	656 ekzemplarë

BN "Hivzi Sulejmani" - Prishtinë	188 tituj	787 ekzemplarë
Gjithsej numri i ekzemplarëve		4738 ekzemplarë
Tabela 6. Libra të dhuruar nga BKUK për bibliotekat në Kosovë dhe jashtë saj, gjatë vitit 2007		
Biblioteka e Kuvendit të Kosovës	145 tituj	220 ekzemplarë
Biblioteka Shqiptare e Zvicrës - Cyrih	350 tituj	455 ekzemplarë
QK Shqiptaro-Amerikane në Dallas (ShBA)	107 tituj	147 ekzemplarë
Gjimnazit Filologjik "Eqrem Cabej"- Prishtinë	157 tituj	157 ekzemplarë
Shkollës Fillore "Faik Konica" – Prishtinë	251 tituj	257 ekzemplarë
Bibliotekës Komunale - Viti		331 tituj 656 ekzemplarë
Biblioteka lokale - fshati Fierzë, Pejë	147 tituj	162 ekzemplarë
Dita Botërore e Librit - BKUK për lexues	108 tituj	108 ekzemplarë
Qendra e Studentëve të UP-së	123 tituj	271 ekzemplarë
Gjithsej		2433 ekzemplarë

➤ Departamenti i Katalogimit

Është viti i tretë – viti 2007, që prej kur ka filluar katalogimi elektronik nëpërmjet programit Aleph 500. Puna në këtë Departament vijon të zhvillohet sipas prioriteteve, duke u zgjeruar, njëkohësisht nëpërmjet katalogimit të koleksioneve të ndryshme në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, si:

- *Fondi i librave - koleksioni vijues dhe retrospektiv;*
- *Periodiku - koleksioni vijues dhe retrospektiv;*
- *Koleksione të Veçanta: Libri i Veçantë, i Rrallë dhe i Vjetër; Disertacione dhe tema të magjistraturës;*
- *Koleksioni i Qendrës së Bibliotekës Universitare;*
- *Koleksioni i Këndit Amerikan*

Gjatë vitit 2007, në Departamentin e Katalogimit:

- janë përpunuar njësi bibliotekare në katalogun elektronik dhe janë krijuar pasqyra të sakta për numrin e njësive të kataloguara në Fondin e Përgjithshëm të Librave dhe Serieleve, nga fondit bibliotekar - vijuesi dhe retrospektivi i BKUK-së, si dhe në numrin e njësive të kataloguara në Koleksionet e Veçanta, të Rralla dhe të Vjetra, Koleksionin e Qendrës së Bibliotekës Universitare, të Koleksionit të Doktoranturave dhe Punimeve të Magjistraturës, të Koleksionit të Këndit Amerikan;

- janë krijuar informacione të sakta për autorë për njësitë bibliografike;

- janë krijuar mundësi, mbështetur në këto të dhëna për numrin e njësive të përpunuara në katalogun elektronik, për vlerësimin dhe dinamikën që parashihet për përpunimin e gjithë fondit bibliotekar të BKUK-së;

- janë krijuar pasqyra të sakta për kapacitet e secilit katalogues për përpunimin/katalogimin e njësive bibliografike;

- janë krijuar mundësi, me përpunimin e njësive bibliografike nëpërmjet programit të automatizuar bibliotekar, të kryhet një lloj revizioni i koleksioneve, duke u identifikuar njësitë në mungesë, njësitë e dëmtuara, njësitë e tepërta, vjetërsia e koleksioneve, numri i njësive në gjuhë të caktuar etj.;

janë krijuar mundësi për vlerësimin e cilësisë së përpunimit/katalogimit dhe të klasifikimit nga secili katalogues që përshkruan njësitë bibliografike në katalogun elektronik;

janë krijuar mundësi të përcjelljes së veprimtarisë botuese të botuesve të Kosovës, dhe profilit të tyre botues.

- Katalogimi

Tabela 7. Numri i titujve dhe ekzemplarëve, sipas llojit të koleksioneve, të përpunuara në katalogun elektronik – në programin Aleph 500

Fondi i përgjithshëm i Librave dhe Serieleve

- Fondi i librave - koleksioni vijues dhe retrospektiv:	10490 tituj	20017 ekzemplarë
- Periodiku - koleksioni vijues dhe retrospektiv:	836 tituj	2058 ekzemplarë
<u>Fondi i Koleksioneve të Veçanta</u>		
- Libri i Veçantë, i Rrallë dhe i Vjetër:	902 tituj	902 ekzemplarë

- Disertacione dhe tema të magjistraturës:	782 tituj	782 ekzemplarë
Fondi i Koleksioneve të Bibliotekave		
Koleksioni i Qendrës së Bibliotekës Universitare:	371 tituj	634 ekzemplarë
Koleksioni i Këndit Amerikan:	297 tituj	297 ekzemplarë
Gjithsej	13678 tituj	24690 ekzemplarë
Numri i njësive autoriale të krijuar në katalogun elektronik – në programin Aleph 500		
Gjithsej	2494 njësi autoriale	

➤ ***CIP (Katalogimi në botim)***

Numri i titujve të librave të Katalogimit në botim në Kosovë, i njohur me inicialet CIP - përshkrim bibliografik i librave përpara se të botohen

Katalogimi në botim	685 tituj
---------------------	-----------

➤ ***Qendra e Bibliotekës Universitare (Përkrahje QBU-së)***

Në mbështetjen për zhvillimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare, për të cilën synohet të jetë Bibliotekë Qendrore e Universitetit të Prishtinës janë bërë investime edhe gjatë vitit 2007, përmes donacioneve nga OSBE për burime elektronike, me ç’rast ky Projekt ka siguruar falas qasje në bazën e të dhënave të burimeve elektronike: Oxford Journals dhe Oxford Scholarship Online. Gjithashtu ky Projekt ka siguruar pajisje për sigurimin e cilësisë në shërbimet me përdorues, nëpërmjet Programit EnvSIONWare, i cili shërben për menaxhimin kohor të përdorimit të kompjuterëve; pastaj përmes Programit Athens, përdoruesve u ofrohet qasje në burimet elektronike edhe jashtë bibliotekës

Në kuadër të zhvillimit të QBU-së gjatë vitit 2007 kanë qëndruar për trajnim në BKUK ekspertë amerikanë nga fusha e bibliotekarisë dhe shkencave informative të udhëhequr nga Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Kolegji Simons (ShBA). Nga buxheti i BKUK për zhvillimin e fondeve bibliotekare, njëkohësisht janë bërë blerje të veçanta për pasurimin e fondeve të QBU-së. I gjithë ky fond është përpunuar dhe është në shfrytëzim të përdoruesve.

Më poshtë po japim të dhënat për shërbimet si vijon: Shërbimi i referencave; Shërbimi i koleksioneve të lëndëve mësimore; Shërbimi i burimeve elektronike, me bazat e të dhënave që përbëjnë një fond prej 30 mijë tituj të revistave elektronike, si dhe shumë artikuj të tjerë, biografi, fotografi, pamje hartash, etj.

➤ ***Statistika për shfrytëzimin e shërbimeve të QBU-së***

Tabela 8. Statistika për përdorimin e koleksioneve të QBU-së dhe të Qendrës së Internetit, që funksionon në kuadër të kësaj Qendre

Përdorimi i Koleksionit Referal	939
Përdorimi i Koleksioneve të Lëndëve Mësimore	360
Përdorimi i kompjuterëve në Qendrën e Internetit	9840
Gjithsej	11139

Tabela 9: Statistikat e përdorimit të burimeve elektronike

	Inside Usage	Remote Usage	Total Usage
Average Session	418	0	418
Total Fulltext	5275	0	5275
PDF Fulltext	3251	0	3251
HTML Fulltext	1691	0	1691
Total Searches	11328	0	11328
Image video	333	0	333
Smart link	246	0	246
Abstract	3502	0	3502

➤ ***Departamenti i Bibliografisë***

Gjatë vitit 2007 është punuar në dy projekte bibliografike:

✓ *Hulumtimi i materialit bibliografik, për projektin: Bibliografia shqiptare: Libri 1944-1984;*

- *Redaktimi i tekstit: Bibliografi e punimeve pedagogjike të botuara në gjuhën shqipe në periodikun pedagogjik (1945-1978) të prof. Islam Krasniqi*
- *Për projektin: Bibliografia shqiptare: Libri 1944-1984, janë hulumtuar, identifikuar e përpunuar de visu (drejtpërdrejt nga burimi) 8726 njësi bibliografike. Kërkimet bibliografike janë bërë në BKUK dhe në Bibliotekën Ndërkomunale “Hivzi Sylejmani” të Prishtinës.*

Që nga shtatori 2007 ka filluar edhe redaktimi i materialit bibliografik në shqyrtim, në fushat e gatshme redaktuese, si ndarja kronologjike e njësisve bibliografike, alfabetizimi global i njësisve bibliografike, dëshifrimi i përcaktueseve kolektive apo anonim etj.

➤ Departamenti i Koleksioneve të Veçanta

Departamenti i Koleksioneve të Veçanta ka realizuar aktivitete sipas prioriteteve që janë parashikuar gjatë vitit 2007, ndërsa prioritet kryesor ka qenë bartja e të dhënave të Koleksioneve të Veçanta nga katalogu manual në atë elektronik.

Tabela 10. Tabela në vijim jep të dhënat e sakta për njësi të formuara, nga lloje të ndryshme të koleksioneve, në katalogun elektronik.

Libri i Rrallë dhe i Vjetër	534 njësi bibliografike
Muzikalie	618 njësi bibliografike
Disertacioneve të doktoratave	687 njësi bibliografike
Punime të magjistraturave	710 njësi bibliografike
Gjithsej	2549 njësi bibliografike

Janë kataloguar në skeda në letër: 453 dorëshkrime; janë redaktuar dhe plotësuar me të dhëna 219 kartela, si dhe janë parakataloguar 192 dorëshkrime.

Koleksionet e Veçanta dhe të Rralla janë pasuruar me: - 16 libra nga fusha e Muzikalieve; 154 tituj botime më të reja - dhuratë nga individë; 1 CD, e cila përmban 50 harta digjitale, që janë dhuruar nga Arkivi i Kosovës.

Nga antikualet dhe individët janë blerë 10 tituj.

Departamenti i Koleksioneve të Veçanta, ka përgatitur dhe botuar:

- 1. Katalogu me tituj të zgjedhur të Bibliotekës së Krist Malokit;*
- 2. Katalog i disertacioneve të doktorateve: 1999 – 2004;*
- 3. Doracaku për ISMN.*

Nga Sektori i Muzikalieve janë dhënë informacione të rëndësishme për botuesit e materialit muzikor: partiturave, CD, DVD etj., si dhe janë pasuruar të dhëna për botuesit e materialeve muzikore nga mbarë Kosova. Gjithashtu, nga përgjegjësi i Sektorit të Muzikalieve është punuar në krijimin dhe përkthimin e përcaktueseve lëndore.

Nga Fondi Muzeal, është bërë: përpunimi fizik i 2031 librave; është bërë risignimi i 405 librave. Nga Sektori i Restaurimit dhe Konzervimit janë pastrua, dezinfektuar, neutralizuar dhe restauruar kopertinat, fletët-faqet e librave, si dhe revistave të ndryshme si: Gazeta Shqiptare, Shqypnija e lire, Edukata e re, Vatra e rinisë, Shkolla Shqiptare etj.

❖ Departamenti i Informacionit dhe Shërbimeve Bibliotekare

Nga puna me palë, Departamenti i Qarkullimit ka arritur të nxjerrë të dhënat në vijim:

Tabela 11. Informacionet me palë

Informata:	shkencore 5729	me palë 6227	
Porosi:	libra 4177	revista 269	gazeta 1068
Realizime:	libra 3933	revista 263	gazeta 1048
Mungesa:	libra 244	revista 6	gazeta 19
Rezervime:	libra 1921	revista 147	gazeta 653

Tabela 12. Numri i studentëve (përdoruesve) në salla

Salla Qendrore	201.919
Salla I dhe II e katit të dytë	42352
Sallat Speciale-Kabinetet	5479
Gjithsej	249750

Tabela 13. Numri i përdoruesve në raport me shfrytëzimin e shërbimeve në BKUK

Numri i të anëtarësuar gjatë vitit 2007 ka qenë	3858	
Shfrytëzues të Arkivit të Hapur: revista	1052	gazeta 1968
Lexues të shtypit ditor	14300	
Libra të dhënë në lexim brenda sallës	8562	
Qendra e Internetit (kati i III-të)	1699	

❖ Departamenti i Teknologjisë Informative

Gjatë vitit 2007, nga Departamenti i TI-së janë, janë kryer detyra në përputhje me planifikimet e rregullta, si: mirëmbajtja e rrjetit lokal (Hardware & Software); mirëmbajtja e paisjeve në rrjet, kompjuter, printer, scanner etj., si dhe instalimi i paisjeve të reja; mirëmbajtja dhe mbikqyrja e punës së shfrytëzuesve të rrjetit; instalimi dhe mirëmbajtja e Programin Bibliotekar ALEPH 500; mirëmbajtja e serverit si dhe ruajtja të dhënave – Backup; mirëmbajtja dhe mbikqyrja e punës së shfrytëzuesve të programit ALEPH 500.

Ndërsa nga projekte me rëndësi për zhvillimet teknologjike në BKUK, janë:

- Instalimi dhe mirëmbajtja e Programit EnvsionWare, i cili shërben për menaxhimin kohor të përdorimit të kompjuterëve në Qendrën e Bibliotekës Universitare;
- Instalimi dhe mirëmbajtja e Programit Athens, që shërben për menaxhimin e përdoruesve në burimet elektronike që ofron BKUK;
- Instalimi dhe mirëmbajtja e Hardware & Software RFID – Kodi i sigurisë së librit etj.

✚ Administrata

Puna dhe veprimtaria është zhvilluar konform dispozitave ligjore të cilat aktualisht janë në fuqi, duke iu përmbajtur atyre në tërësi dhe duke i vënë në aplikim me rastin e materializimit të akteve, vendimeve, kontratave e shkresave të ndryshme me karakter juridik.

Është bërë arkivimi i çdo shkresë dhe klasifikimi i saj varësisht nga natyra e saj juridike si: vendime, kontrata, vërtetime, kërkesa, oferta e shkresa të tjera të natyrave të ndryshme.

Në periudhën janar-dhjetor 2007, përmes arkivës kanë hyrë në evidencën e protokollit 411 dokumente. Është bërë edhe regjistrimi, sistemimi dhe klasifikimi i materialit arkivor në regjistrator të veçantë; është bërë rishikimi i dosjeve personale të punëtorëve dhe u janë lëshuar kontratat e punës me afat njëvjeçar të gjithë të punësuarve në Bibliotekë; është dhënë ndihma juridike të gjitha departamenteve, si dhe është përgatitur Rregullorja e përshkrimit të detyrave të punës në Bibliotekë; është bërë përpunimin i regjistrave të hyrje-daljes së punëtorëve dhe mungesave në punë; pushimeve vjetore, mjekësore. Gjithashtu është bërë përgatitja e procedurave dhe zbatimi i konkurseve publike.

✚ Buxheti për vitin 2007

Tabela 14. Të dhënat për buxhetin

1. Pagat dhe mëditjet	231.939,00€
2. Mallra dhe shërbime	208.578.00 €
3. Shpenzimet komunale	173.000.00 €
4. Investimet Kapitale	43.000,00€
GJITHSEJ:	656.517,00€

Në kategorinë paga dhe mëditje, buxheti është paraparë për 105 punëtorë, momentalisht janë 102 punëtorë, që do të thotë se ka mungesë të punëtorëve dhe tepriçë të mjeteve në këtë kategori, për këtë arsye edhe është kërkuar me shkresa zyrtare që të lejohet pranimi i punëtorëve të rinj, meqë ekzistojnë edhe nevoja të mëdha për disa pozicione.

Tabela 15. Të dhënat për alokimin dhe shpenzimin e mjeteve

Në mallra dhe shërbimet janë alokuar	208.578,00€,
kurse janë shpenzuar	<u>199.144,59€</u>
mbetja nga zotërimet më të mëdha	8966.57 €
Në shërbimet komunale janë alokuar	173.000,00€,

<i>kurse janë shpenzuar</i>		92.611.43€
<i>Mbetja prej 80388,57€</i>		
<i>Sipas llojit, janë: - shpenzimet e rrymës</i>		27.742.22 €
- “ ngrohjes		40.364.74 €
- “ ujit		1.271.27 €
- “ higjienës		9.911.95 €
- “ telefonisë		13.179.01 € (këtu kanë hyrë edhe faturat e dy muajve të fundit të vitit 2006).

Kontoja për investimet kapitale gjithsej ka qenë 43.000,00€, por për shkak të destinimit të gabuar dhe pamundësisë së transferit për projekte të tjera kanë mbetur të pushfrytëzuara.

BKUK, përpos mjeteve të dedikuara nga Buxheti i Kosovës, ka edhe të hyra vetanake, të cilat menaxhohen përmes Memorandumit të nënshkruar nga MEF-i – MASHT-i dhe nga BKUK-ja.

Tabela 16. Të dhënat për të hyrat vetanake

<i>Të hyrat janë, nga: 1. Qeraja</i>	13.458,18 €
2. Nga anëtarësia e lexuesve	44.106,00€
3. Të tjera	698.00€
Gjithsej:	58.262.18 €

Nga këto mjete, nga të hyrat e bartura nga viti 2006 janë 49.314.78 € , nga të cilat të shpenzuara 71.175.78 €, ndërsa pjesa tjetër prej 36.491.99 € do të shpenzohet në vitin vijues, meqë shumica e mjeteve grumbullohen me fillimin e vitit akademik (pas muajit tetori) dhe shpenzimi i tyre gjatë këtij viti është i pamundshëm për shkak të procedurave bankare.

↓ INSTITUTI I HISTORISË

Instituti i Historisë në mbështetje të programit të punës për vitin 2007 ka kryer këto punë :

- *Hulumtimet arkivore*
- *Aktivitetet shkencore*
- *Veprimtaria botuese*
- *Marrëveshje bashkëpunimi*

I. Hulumtimet arkivore

Gjatë vitit 2007 punëtorët shkencorë të Institutit të Historisë kanë kryer hulumtime arkivore në vend, në Shqipëri, në Maqedoni, në Serbi dhe në Bosnje. Këto hulumtime janë të lidhura me makroprojektin “Historia e Kosovës” si dhe me projektet individuale të studiuesve shkencorë të Institutit të Historisë.

II. Aktivitetet shkencore të Institutit

- Në bashkëpunim me Shoqatën e Intelektualëve nga Diaspora është organizuar sesioni shkencor “ E Djaththa Shqiptare drejt Shqipërisë Etnike”, mbajtur më 20 e 21 maj 2007 Istog, në të cilën studiuesit e Institutit të Historisë janë paraqitur me kumtesa.

- Është organizuar sesioni shkencor:” Idriz Seferi në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare” - Prishtinë, 15 tetor 2007.

- Në bashkëpunim me Institutin e Historisë të Tiranës, Instituti ka organizuar Konferencën Shkencore “Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shekullit XX”, 26-27 nëntor 2007, Tiranë.

- Me rastin e 20 vjetorit të vdekjes së Akademik Ali Hadrit, Instituti organizoi një Akademi përkujtimore kushtuar akademik Ali Hadrit dhe veprës së tij, Prishtinë, 3 dhjetor 2007.

- *Studiuesit nga Instituti i Historisë kanë marrë pjesë me kontributet e tyre në shënimin e 17-vjetorit të shpalljes së Kushtetutës së Kaçanikut me 7 shtator 1990, Deçan 07.09. 2007.*

III. Veprimtaria botuese

Gjatë vitit 2007 Instituti ka përgatitur për shtyp dhe ka botuar revistën “Kosova” nr. 28 dhe nr. 29. Gjithashtu ka dërguar në shtyp përmbledhjen e punimeve kushtuar 125 – vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; përmbledhjen e punimeve të sesionit shkencor Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe epoka e tij. Instituti ka botuar veprën e Dr. Islam Laukës “Kosovo a Universal Case or Sui Generis?”. Gjithashtu janë përgatitur edhe disa monografi të autorëve nga Instituti për probleme të caktuara historike të cilat do të shohin dritën pas sigurimit të mjeteve.

Gjatë vitit 2007 Instituti ka begatuar fondin bibliotekar dhe akriivor me botime të reja si dhe me fonde dokumentesh, të cilat studiuesit tanë i kanë gjurmuar në arkiva të ndryshëm. Punëtorët e Institutit u janë përgjigjur pozitivisht ftesave të mediave të shkruara dhe elektronike me rastin e jubileve për emisione të veçanta me karakter shkencor, profesional e shoqëror. Edhe personeli i shërbimeve të përbashkëta dhe i administratës kanë kryer punët dhe detyrat e punës nga fushëveprimtaria e tyre.

IV. Marrëveshje bashkëpunimi

Gjatë vitit 2007 Instituti ka nënshkruar një marrëveshje për hulumtime shkencore me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Shqipërisë për hulumtimin e materialeve arkivore në Arkivat e Shtetit Shqiptar.

- *Gjithashtu në bazë të kërkesës së Zyrës së Shqipërisë në Prishtinë për nevojat e Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, Instituti ka hartuar materialin për botim special kushtuar Pavarësisë së Kosovës.*

- *Instituti ka lidhur marrëveshje me Institutin e Historisë në Tiranë për realizimin e projektit disa vëllimësh me dokumente të Arkivave Britanike, me titull: Shqipëria gjatë Luftës së Parë Ballkanike 1912-1913 ;*

- *Gjithashtu Instituti i Historisë në Prishtinë, ka lidhur marrëveshje me fotomjeshtrin e Arkivit të Kosovës – Bekim Aliu për ruajtjen e mikrofilmave të skanuar të cilat janë dhuratë e komitetit shqiptar në SHBA (gjithsejt 23.095 kuadro filmuese). Marrëveshja është lidhur me 19 nëntor 2007.*

❖ Plani për 2008

Sa i përket Planit të punës për vitin 2008, do të vazhdohet puna në makroprojektin “Historia e Kosovës” dhe në projektin “Gjenocidi serb në Kosovë 1998-1999”. Përveç hulumtimeve individuale do të organizohen konsulta profesionale sipas periudhave të projekteve me qëllim të perfeksionimit dhe begatimit të metodave hulumtuese dhe rezultateve të punës. Po ashtu studiues nga Instituti vazhdojnë punën në projekte të përbashkëta dhe individuale bartëse të të cilave janë MASHT; MKSÇR; ASHAK; Universiteti apo subjektet e tjera me të cilat bashkëpunojmë.

Një numër i studiuesve të rinj vazhdon punën në kryerjen e temave të magjistraturës e të doktoranturës në Kosovë dhe jashtë saj.

Në mbështetje të përkrahjes materiale do të vazhdojmë botimin e revistës “Kosova” sipas rradhës; disa vëllime me përmbledhje të dokumenteve arkivore për periudha dhe probleme të ndryshme historike, si dhe projekte të cilat janë të gatshme ose do të kryhen gjatë këtij viti. Do të kryhen punë e detyra të përditshme të cilat janë të lidhura me fushëveprimtarinë e Institutit.

Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK)

Hyrje

Instituti Pedagogjik është themeluar me qëllim hulumtimi, eksperimentimi, krahasimi dhe zbatimin në fushën e arsimit. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve ndihmon dhe lehtëson zbatimin e politikave arsimore të MASHT-it dhe përparimin e shkollës dhe arsimit në Kosovë.

❖ PLOTËSIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE

Instituti ka filluar punën në shtator 2007. Në bashkëpunim me Këshillin Administrativ, është hartuar Plani i punës, në të cilin janë paraqitur objektivat dhe fushat e veprimeve dhe hulumtimeve. Pastaj është ripunuar Udhëzimi administrativ, i cili me pak ndryshime është nënshkruar nga ministri. Kemi përpunuar edhe Rregulloren e brendshme, e cila është dorëzuar në Zyrën ligjore dhe pritet të përfundojë e të miratohet.

❖ PROJEKTET E HARTUARA

IPK është strukturuar në katër sektorë. Pas fillimit të punës, sektorët dhe hulumtuesit kanë filluar me identifikimin e çështjeve dhe problemeve në fusha të ndryshme të arsimit, të cilat duhet të hulumtohen. Është përgatitur një listë me prioritete dhe janë hartuar projekte për hulumtimin e tyre.

Në vazhdim po japim listën e projekteve të propozuar nga sektorët e IPK-së.

- *Korrelacioni i përmbajtjeve mësimore të teksteve me qëllimet dhe objektivat e programit mësimor*
- *Aparatura didaktike e teksteve, hulumtim krahasues*
- *Planifikimi , udhëheqja dhe autonomia e shkollës, gjendja dhe cilësia*
- *Komunikimi mësimdhënës – nxënësi- prind kusht për sukses*
- *Vijueshmëria, lëvizja dhe braktisja e shkollimit*
- *Liritë, të drejtat dhe obligimet e nxënësve*
- *Dhuna në shkollë (aspektet e dhunës.)*
- *Informimi dhe orientimi profesional i nxënësve*
- *Plani mësimor sipas lëndëve, klasave dhe niveleve*
- *Standardet e përmbajtjeve programore*
- *Mësimi zgjedhor planifikues. (gjendja dhe perspektivat e...)*
- *Praktikat e vlerësimit të dijeve të nxënësve në Kosovë*
- *Të pyeturit; pyetjet me gojë dhe me shkrim, të metat dhe përparësitë*
- *Tipet e vlerësimit, problemet dhe sfidat*
- *Vetëvlerësimi, mundësitë dhe përparësitë*
- *Planifikimi i mësimi; (cilësia dhe problemet në entet parashkollore.)*
- *Metodat e mësimdhënies; (shkathhtësitë metodike të mësimdhënësve.)*
- *Mësimi dhe praktika profesionale në shkollat profesionale (mësimi dual)*
- *Përgatitja profesionale dhe efikasiteti i trajnimit të mësimdhënësve*
- *Ngarkesa nxënësve me detyra, gjendja në shkollat tona*
- *Çanta e nxënësit, ngarkesa fizike në pajtueshmëri me moshën kalendarike të tyre*
- *Arsimtar, mësues, shoku, zotëri...apo z. emri, çfarë mendojnë nxënësit, prindërit dhe arsimtarët*
- *Disleksia, hulumtim i gjendjes në shkolla*
- *Klasat e bashkangjitura faktor integrimi apo ndarjeje (në arsimin special)*

- *Format e edukimit në distancë, alternativë për ngritjen e cilësisë në arsimit*
- *Terminologjia e huaj dhe shkencore në tekstet mësimore si formë e ngarkesës së nxënësve*
- *Zbatimi i/Të mësuarit me bazë projekti – risi në mësimdhënie në shkollat e Kosovës*
- *Mësimi zgjedhor planifikues (gjendja dhe perspektivat e zbatimit në shkolla.)*
- *Ngarkesa e klasave me nxënës, gjendja dhe rrjedhojat në mësimnxënie e mësimdhënie.*

Shumica nga projektet e propozuara janë hartuar dhe presin mendimin e Këshillit shkencor si dhe gjetjen e mjeteve për realizimin e hulumtimeve. Disa janë në shtrirje/përpunim e sipër. Posa të dihen burimet financiare realizimi i hulumtimeve do të fillojë sepse janë bërë përgatitjet fillestare.

✚ *AKTIVITETET E ORGANIZUARA*

Qysh nga fillimi, të gjithë hulumtuesit e IPK-së kanë marrë për obligim që të studiojnë mirë gjithë legjislacionin e aprovuar në fushën e arsimit si dhe strategjitë e hartuara. Nga ky studim kanë dalë edhe shumë projekte të propozuar për hulumtim në të ardhmen.

Në tetor është mbajtur konferenca promovuese e Institutit në bashkëpunim me CESES. Në konferencë janë prezantuar Plani i punës, Objektivat dhe projektet parësore të Institutit. Është prezantuar edhe broshura e parë informative e Institutit.

Në nëntor është mbajtur punëtorja në të cilën janë trajtuar çështjet e cilësisë së arsimit në Kosovë. Pjesa e dytë ka qenë planifikuar të mbahet në dhjetor, por për shkaqe materiale është shtyrë për më vonë, 2008. Në dhjetor kemi filluar me hulumtimin në shkolla, projekti nën 22, i cili do të përfundojë gjatë janarit 2008.

Ngritja e kapaciteteve

Pesë hulumtues kanë marrë pjesë në trajnime profesionale, KEC dhe GTZ.

❖ *RALIZIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL*

Deri më tani janë mbajtur takime me GTZ-në, FSDEK, Fakultetin Filozofik, PKA, KulturKontakt. Të gjithë kanë shprehur interesim për bashkëpunim në zbatimin e projekteve të veçanta. Me disa jemi marrë vesh të përgatisim memorandum bashkëpunim.

PËRFUNDIM

Meqenëse Instituti është ende në konsolidim e sipër prandaj edhe e kanë përcjellë probleme të cilat kanë ndikuar në pengimin e realizimit me kohë të detyrave të parashtruara. Disa nga këto probleme, të natyrës teknike ende po na përcjellin. Gjithashtu IPK ende nuk është kompletuar me staf, sidomos administrativ. Për momentin jemi 22 vetë, me drejtorin.

Qendra e Studentëve

Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës në bazë të resurseve njerëzore ekzistuese dhe kapaciteteve teknike e buxhetore ofron shërbime për strehim , ushqim , shërbime kulturore e sportive për studentë, në pajtim me statutin e saj.

Në vazhdim po paraqesim punët dhe aktivitetet në qendrën e studenteve sipas shërbimeve për këtë periudhë

Qendra e Studentëve disponon me pesë konvikte dhe një shtëpizë për banim me kapacitet prej 2877 shtretër. Në tri konvikte (nr. 2,3,,dhe 4) janë të vendosura femrat , ndërsa në konviktet nr.1, në konviktin .nr.3 (në dy lamela) meshkujt dhe në konviktin nr.5 janë të vendosur po ashtu meshkujt..

Ky kapacitet është shfrytëzua në tërësi gjatë vitit 2007 , por është i pamjaftueshëm, sepse me rastin e aplikimit për vendosje në konvikte ka pasur kërkesa më të mëdha për 30% të kapacitetit që disponojmë.

Banimi i rregullt për studentë fillon me 1 tetor dhe mbaron me 30 qershor, kurse në muajin korrik dhe shtator, në pajtim me kërkesat e studentëve ,organizohet banimi me recepcion. Sivjet ky banim për muajin korrik është organizuar në konvikti nr.1, ndërsa në shtator në konviktin nr 4. Gjatë muajit korrik Qendra ka ofruar banim dhe ushqim për studentë të Universitetit Veror , të cilët janë financuar nga MASHT-i.

Përveç mirëmbajtjes së vazhdueshme, gjatë sezonit veror, Qendra e Studentëve me mundësitë e veta buxhetore ka kryer gëlqerosjen e 450 dhomave, është kryer edhe DDD-ja , janë riparuar nyjet sanitare, ka përfunduar fasadimi i konviktit.nr. 2 , si dhe janë kah përfundimi punimet në ndërrimin e instalimit (gypave) të ngrohjes në tërë rrjetin e ngrohjes. Gjithashtu është riparuar i gjithë inventari nëpër dhomat e banimit sipas kërkesave të konvikteve dhe shtëpizave, si dhe objekteve përcjellëse, përfshirë këtu sallat e leximit, e pushimit etj. Gjatë sezonit veror në Qendrën e Studentëve janë bërë ndryshime pozitive në dobi të studentëve. Është rregulluar Biblioteka (leximorja) me kapacitet prej 220 vendeve dhe gjithashtu është hapur një qendër për internet, ku për fillim kapaciteteve është 20 kompjuterë.

Gjatë shtatorit është shpallur konkursi për aplikimin për banim në Q. .S, ku janë paraqitur rreth 5 mijë kërkesa. Komisionet përkatëse të Q.S. e kanë bërë seleksionimin e përfituesve të banimit në pajtim me kriteret e përcaktuara me parë dhe janë shpallur rezultatet me 28 shtator, kurse vendosja ka filluar nr.1 tetor.

Pas vendosjes së studentëve kanë ardhur kërkesa të shumta për lirim të studentëve nga ushqimi dhe banimi me çka është njoftuar edhe MASHT-i. Me vendim të MASHT-it (nr 66/02 i datës 30.09.2005) për vendosjen e Parlamentit Studentor dhe lirim përkatës nga pagesa për student invalid të luftës, fëmijë të dëshmorëve dhe student me familje në asistencë sociale. Studentët nga kategoritë e përmendura do të sistemohen në Qendrën e Studentëve dhe do të lirohen sipas kategorive.

- 1. Invalid të luftës me invaliditet mbi 50% lirohen nga të gjitha obligimet financiare, numri i tyre është prej 35 – 40 student*
- 2. Fëmijët e dëshmorëve dhe invalid të luftës lirohen nga detyrimet financiare, pagesa për vendosje, numri i tyre është 45 – 50 student.*
- 3. Studentë të familjeve me asistencë sociale, kjo kategori lirohet 50 % nga strehimi, numri i këtyre studentëve është prej 195 – 200 studentë.*
- 4. Parlamenti Studentor, kjo kategori do të lirohet për 28 studentë.*

Qendra e Studentëve do të formojë komision të përbashkët me MASHT-in dhe do ti shqyrtoj të gjitha kërkesat për këto kategori..

➤ **Shërbimi i ushqimit**

Pas rikonstruimit të kryer në tetor të vitit 2004, shërbimi i ushqimit ka ofruar nga dy racione në ditë gjegjësisht 710 000 shujta në vit, sipas menysë të aprovuar paraprakisht. Problemet e identifikuar pas rekonstruksionit janë raportuar rregullisht në MASHT, të cilat pritet të përmirësohen. Sivjet janë bërë riparimet gjatë muajeve të verës në frigo-dhoma, ngjyrosja e mezës dhe DDD-ja si dhe në kanalizim.

Vlen të theksohet se gjatë gjithë vitit Akademik 2006/2007 nga studentet abonues të ushqimit nuk kemi pas vërejtje në cilësi dhe sasi. Për punëtorët e këtij shërbimi për çdo gjashtë muaj behet kontrollimi shendetsoro - sanitar ashtu siç është e parapare me ligj. Pengesë për funksionimin sa me cilësor të mensës paraqitet problemi i stafit ekzistues për shkak të moshës si dhe sëmundjeve profesionale të punëtorëve prandaj kar angazhime të punëtorëve sezonal. Mensa e cila gjendet të Fakultetit Teknik shfrytëzohet pjesërisht nga TMK-ja.

➤ **Shërbimi i Administratës**

Ka përcjellë ecuritë e punëtorëve, pushimeve vjetore dhe të tjera si dhe lëshuarjen e kontratave të punës të vendimeve dhe aktvendimeve. Gjithashtu ka përfaqësuar Qendrën në kontestet gjyqësore. Gjatë këtij viti akademik, ky shërbim, hartime të rregulloreve të reja, si dhe ka mbajtur disa procedura të ankesave të punëtorëve si dhe komisione të ndryshme punuese, hartuar informata dhe njoftime në interes të Qendrës

➤ **Shërbimi teknik**

Ky shërbim në mënyrë permanente ka kryer intervenime në të gjitha objektet e qendrës siç janë: intervenime në rrymë, ujë, kanalizim, ngrohje qendrore; ngjyrosje të pjesërishtme, intervenime në raste të defekteve të të gjitha llojeve. Ka bërë ndërrimin e rregullt të të gjitha llojeve të aparateve dhe të instalimit të ujit, rrymës si dhe përgatitjen e ujit sanitar sipas nevojës dhe orarit të përcaktuar. Kështu sipas njësisë janë kryer keto intervenime, kryesisht gjatë verës:

Konvikti nr-I -kompletimi i nyjeve sanitare, lamavaneve, tushave, intervenime në nxemjen qendrore me ndërrime të pjesëve, intervenime në instalimin e rrymes elektrike etj.

Konvikti nr.-II; Përgatitja e konviktit sipas nevojave afërsisht si në konviktin nr -I- si dhe ngjyrosja e jashtme e fasades së konviktit.

Edhe në konviktin nr. III janë bërë ndryshime sipas nevojës si dhe janë ngjyrosur shumë dhoma, kurse gjatë muajit nëntor është bërë edhe izolimi i dy terasave.

Në konviktin nr. IV, sidomos të katet e larta është intervenu në instalimin e ujit dhe të ngrohjes qendrore.

Edhe në konviktin nr pese janë bërë intervenime sipas nevojave, ku është intervenu në ngrohjen qendrore.

Gjatë verës janë bërë edhe pastrimi i kazanave të ndezjes. Gjithashtu ky shërbim ka bërë kontrollin e aparateve të zjarrfikësit, duke i mbushur në kohë të caktuara.

Të laventaria ky shërbim ka dal me një risi, është hap laventaria për larjen e rrobave për studente me 10 makina laresë dhe një teresë.

Ky shërbim ka kryer pastrimin e qarshafave, batanijeve, mbulesave të jastukave, pastrimin e uniformave të punëtorëve si dhe hekurrosjen e tyre sipas orarit të përcaktuar.

Ky shërbim punon me dy ndërrime dhe jep vazhdimisht kujdestari.

b) Mirëmbajtja e ambientit

Kujdes i veçantë i ka kushtuar edhe ambientit të kompleksit të qendrës së Studentëve në mbajtjen e pastërtisë, mënjanimin e barishtave, kositjen e rregullt të barit, bartjen e mbeturinave, gjithashtu kanë mbjelle fidanë dhe trëndafila në kompleksin e qendrës.

Është rregulluar platoja para ndërtesës të drejtorisë, pastaj rrugicat (alet) për terrenet sportive etj..

➤ **Shërbimi i Financave dhe buxhetit**

Ka kryer te gjitha punët e parapara ne rregullore; planifikimi I buxhetit ,raportet periodike e vjetore dhe te gjitha pagesat.

➤ **Sherbimi i kultures dhe sportit**

Kryerja e rekonstruimit ne Palestrën I Tetori ka qene si pengese ne zhvillimin e te gjitha aktiviteteve sportive dhe kulturore te planifikuara me herët .

Per te qene ne funksion kjo palestër nevojitet te rikonstruohen këto pune :parketi ,rryma, nyejt sanitare, ngrohja, ventilimi,ndriçimi, shejzimet brenda, pastaj renovimi I lokaleve përcjelle të palestrës të cilat janë më se te domosdoshme për sportet

Perkuner kësaj jane mbajte pese koncerte, festivali i Kosova festit , dy koncerte per studente, nje revy mode,e manifestime tjera.

Me rregullimin e terreneve sportive te hapura ne Kompleksin e Qendrës janë krijuar kushte te mira për studentet për sport dhe rekreacion.

➤ **Shërbimi i sigurimit**

Ky shërbim ka kryer punët gjate 24 orëve pa ndërprerje ,duke bërë sigurimin e objekteve dhe te pasurisë së Qendrës.

Ne kuadër te këtij shërbimi funksionon edhe zjarrfikësi ,qe kujdestë për kohen e servisimit dhe mbushje te bombolave .

➤ **Zyra e kontrollës Interne**

Ka përcjelle ne vazhdimësi punën e te gjitha sektorëve dhe ka pranuar hyrjen dhe daljen e mallrave dhe punëve qe janë bere ne Qendër.

Gjithashtu eshte mbikeqyre veprimtaria e afarizmit financiar te shërbimit te kultures , zbatimin e kontratave,percjelle edhe respektimin e orarit te punes nga ana e shërbimeve

• **Zyra e Informimit**

Kjo zyrë ka raportuar për media për punën ne Qendër dhe ka bashkëpunuar me studente duke ua marre opinionin e tyre.

➤ **Zyra e Prokurimit**

Kjo Zyre ne kuadër te veprimtarisë se vet ,ka kryer te gjitha procedurat e prokurimit ne pajtim me ligjin .

➤ **Qendra e Mjekesise Familjare**

Ne Kompleksin e Qendrës se Studenteve ka vepruar edhe QMF-ja ,e cila ka bërë ofrimin e shërbimeve shëndetësore për studentë.

Kjo Qendër menaxhohet nga Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe prej muajit korrik nuk funksionon, pasi që Drejtoria Komunale për Shëndetësi e ka tërhequr personelin nga objekti.

Në qendrën e studenteve kemi afër 70 punëtorë që punojnë në ndërrim të natës (në këtë nr. hyjnë punëtorët e sigurimit, receptionistet, kujdestarë teknik).

Përfundim

Përkundër te gjitha këtyre aktiviteteve të zhvilluara dhe të raportuara në Qendrën e Studentëve si probleme të theksuara dhe që meritojnë prioritet në vendosje janë:

- Mungesa e theksuar e rrymës elektrike
- Reduktimet e ujit
- Mosfurnizimi i mjaftueshëm me ngrohje nga ana e ngrohjes qendrore
- Rrjeti i vjetëruar shpërndarës në konvikte, sepse rrjeti kryesor i ngrohjes është rregulluar, ndërsa i ujit ka probleme në disa konvikte.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Sektori i buxhetit dhe financave

Më Freebalance realizimi i buxhetit të MASHT-it me datë 26.12.2007

Kodi	Emërtimi	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Totali A+R	Mbetja/AI	index
904	Universiteti	12,131,747	12,131,747	11,000,777	23,132,524	11,000,777	190.7
010000	Pagat	7,291,036	7,291,036	7,119,828	14,410,864	7,119,828	197.7
013000	Mallra dhe shërbime	2,895,431	2,895,431	2,287,078	5,182,509	2,287,078	179.0
013200	Shpenzimet komunale	945,280	945,280	871,419	1,816,699	871,419	192.2
030000	Shpenzime kapitale	1,000,000	1,000,000	722,452	1,722,452	722,452	172.2
905	Qendra e studentëve	1,461,793	1,461,793	1,194,349	2,656,142	1,194,349	181.7
010000	Pagat	599,336	599,336	567,168	1,166,504	567,168	194.6
013000	Mallra dhe shërbime	186,457	186,457	172,546	359,003	172,546	192.5
013200	Shpenzimet komunale	131,000	131,000	126,540	257,540	126,540	196.6
030000	Shpenzime kapitale	545,000	545,000	328,095	873,095	328,095	160.2
906	Institutet	1,147,018	1,147,018	507,445	1,654,463	507,445	144.2
010000	Pagat	383,267	383,267	348,839	732,106	348,839	191.0
013000	Mallra dhe shërbime	143,751	143,751	131,725	275,476	131,725	191.6
013200	Shpenzimet komunale	120,000	120,000	26,881	146,881	26,881	122.4
030000	Shpenzime kapitale	500,000	500,000	0	500,000	0	
908	Shkollat speciale	1,291,536	1,291,535	1,148,670	2,440,205	1,148,670	188.9
010000	Pagat	560,262	560,262	505,958	1,066,220	505,958	190.3
013000	Mallra dhe shërbime	420,929	420,929	388,439	809,368	388,439	192.3
013200	Shpenzimet komunale	139,112	139,112	83,041	222,153	83,041	159.7
030000	Shpenzime kapitale	171,233	171,232	171,232	342,464	171,232	200.0
909	Biblioteka	656,517	656,517	517,704	1,174,221	517,704	178.9
010000	Pagat	231,939	231,939	225,948	457,887	225,948	197.4
013000	Mallra dhe shërbime	208,578	208,578	199,145	407,723	199,145	195.5
013200	Shpenzimet komunale	173,000	173,000	92,611	265,611	92,611	153.5
030000	Shpenzime kapitale	43,000	43,000	0	43,000	0	100.0
910	Trajnimet	238,262	238,262	228,262	466,524	228,262	195.8
013000	Mallra dhe shërbime	238,262	238,262	228,262	466,524	228,262	195.8
911	Kurrikula	956,575	606,575	545,603	1,152,178	545,603	120.4
013000	Mallra dhe shërbime	606,575	606,575	545,603	1,152,178	545,603	189.9
030000	Shpenzime kapitale	350,000	350,000	349,995	699,995	349,995	200.0
11308	Administrata qendrore	17,100,970	17,100,970	11,910,727	28,757,697	11,783,727	168.2

010000	Pagat	638,931	638,931	632,777	1,271,708	632,777	199.0
013000	Mallra dhe shërbime	869,407	869,407	784,620	1,654,027	784,620	190.2
013200	Shpenzimet komunale	262,608	262,608	179,089	441,697	179,089	168.2
	Subvencione	127,000	127,000	127,000	254,000	127,000	200.0
030000	Shpenzime kapitale	15,203,024	15,203,024	10,187,241	25,390,265	10,187,241	167.0
11408	Ministri	138,433	138,433	102,765	241,198	102,765	174.2
010000	Pagat	73,656	73,656	65,039	138,695	65,039	188.3
013000	Mallra dhe shërbime	64,777	64,777	37,726	102,503	37,726	158.2
030000	Shpenzime kapitale						
	Marrëveshja bilaterale	248,189					76
20800	MASHT-i	35,371,040	34,772,850	27,156,302	61,675,152	27,029,302	
907	Te hyrat vetanake	0	0	0	0	0	0.0
	Totali		0	0	0	0	0.0

❖ *Sektori për zhvillimin e personelit*

Përgatitja e fletëvlerësimeve të punës pas skadimit të kontratave

Përgatitja e kontratave mbi vepër dhe kontratave të arsimit special si dhe vazhdimi i kontratave

Përgatitja dhe botimi i konkurseve, si dhe përgatitja e tenderëve për publikim

Përgatitja dhe botimi i konkurseve për Bankën Botërore dhe për drejtorë të shkollave

Përgatitja dhe botimi i konkursit për regjistrimin e nxënësve në kl. e 10-ta të gjimnazëve dhe shkollave profesionale 2007/08.

Janë përgatitur procedurat për mbajtjen e intervistave

Përgatitja e pushimeve vjetore dhe evidentimi i tyre

Evidentimi i pushimeve: mjekësore, të lehonisë, të mirëkuptimit, pa pagesë, martesore.

Përkthimi dhe lekturimi i të gjitha materialeve të MASHT-it.

Përcjellja dhe evidentimi i trajnimeve

Rregullimi i dosjeve të punëtorëve.

❖ *Sektori për informim dhe marrëdhënie me publik*

Gjatë kësaj periudhe kohore Zyra për Informim e MASHT ka përgatitur komunikata, ku janë publikuar aktivitetet e MASHT-it. Të gjitha komunikatat që janë shkruar për aktivitetet e përmendura janë dërguar në mediat e vendit dhe janë plasuar edhe në web faqen zyrtare të MASHT www.ks-gov.net/masht

Janë përcjellë aktivitetet e rëndësishme të MASHT-it, si: manifestimi për nder të 7 Marsit- Ditës së Mësuesit; konferenca “Hartimi i politikave kombëtare për integrimin e AL në hapësirat evropiane”, “Java e arsimit për të gjithë”, “9 Maji- Dita e Evropës”, “1 Qershori- Dita ndërkombëtare e fëmijëve”, etj.

Është bërë monitorimi i shtypit ditor, kopja e artikujve me tema nga fusha e arsimit dhe arkivimi i tyre

Janë përgatitur dhe janë përcjellë informatat e kërkuara nga ana e gazetarëve.

Janë aranzhuar prezantimet publike të zyrtarëve të MASHT-it në radio dhe në televizione.

Janë përgatitur dhe redaktuar informatorët mujor të MASHT-it, të cilët janë botuar në revistën “Shkëndija”.

Sipas nevoje janë bërë sqarimet apo reagimet ndaj shkrimeve në të cilat eventualisht ka rrjedhë dezinformata ose keqinterpretimi .

Është bërë skenimi i dokumenteve dhe materialeve të ndryshme informative brenda MASHT –it.

Çdo ditë është përcjellë agjenda e Ministrit, Sekretarit, drejtorëve dhe shefave të njësive.

✚ DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Departamenti i prokurimit ka kryer procedurat e prokurimit për lëndët lidhur me projektet dhe punët e kryera, si më poshtë:

- *Ndërtimi i shkollës fillore “Dardania” Pejë;*
- *Ndërtimi i shkollës së mesme “Hasan Tahsini” Obiliq;*
- *Ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Sheq Merovci” Shtedim, Podujevë;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Vllaznimi” Cermjan – Gjakovë;*
- *Transporti i ekspertëve;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Musa Zajmi” Gjilan, aneks për minoritetin turk;*
- *Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore “Selami Hallaqi” në Gjilan;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore në Prizren, faza e I;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Ismail Qemali” Prishtinë;*
- *Shtypja e testeve të arritshmërisë;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore “Zymer Zeka” Kaliqan, Istog;*
- *Renovimi i shkollës së lartë “Bajram Curri” Gjakovë;*
- *Ndërtimi i shkollës së mesme “Xheladin Hajda-Toni”, Krushë e Madhe, Rahovec;*
- *Paramasat dhe parallogaritë për shkolla;*
- *Tekste shkollore për komunitete, kl. VI- IX;*
- *Renovimi i objektit të ORL-së të Fakultetit të Mjekësisë;*
- *Trajnime- Programet MKLSH dhe Hap pas hapi;*
- *Pajisje me inventar për shkolla;*
- *Furnizim me ngrohje qendrore në shkollën “V.Frashëri” Lubizhdë- Viti.*
- *Material harxhues për nevojat e MASHT-it.*
- *Ndërtimi i aneksit në objektin e shkollës fillore në Gerdofc, Podujevë;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore në Leletiq, Lipjan.*
- *Furnizim me një llaptop për zyrën e informimit.*
- *Ndërtimi i shkollës së fillore “Mitrush Kuteli” në Mat (Matiqan) Prishtinë, Faza e III-të;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Muhamet Qami” Kuk, Dragash;*
- *Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore “Emin Duraku” Arllat – Glllogvc;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Qemail Bakia “ Doll, Gjakovë;*
- *Ndërtimi i aneksit në objektin e shkollës fillore në Gerdofc, Podujevë;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Lidhja e Prizrenit“ Deqan;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore “Ramë Bllaca” Suharekë Faza e II;*

- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Filip Shiroka“ Slivovë;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Skenderbeu“ dhe objektit të shkollës fillore “Ismail Qemali” në Hogosht;*
- *Renovimi i shkollës së mesme “Naim Frashëri” Shtime (e cila është dëmtuar nga stuhia- erërat);*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Nazim Hikmet”, Bukovik, Gjilan;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Adem Bajrami” Kievë*
- *Lexues optik për zyren e standardeve;*
- *Vazhdimi i punimeve në objektin e MASHT-it;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore në Burojë, Skenderaj;*
- *Ndërtimi i konviktit Nr:6, Prishtinë;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore “Zekirja Rexha” Gjakovë;*
- *Renovimi i shkollës fillore në Lubizhdë, Has, Prizren;*
- *Renovimi i objektit të shkollës fillore “Filip Shiroka“ Slivovë;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore “Petro Nino Luarasi” Llapqevë, Malishevë;*
- *Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Miradi e Lartë, Fushë Kosovë;*
- *Renovimi i shkollës së mesme “Mithat Frashëri” Gurakoc, Istog;*
- *Renovimi i konviktit të studentëve Gjakovë;*
- *Zyra rajonale e Gjakovës.*
- *Konkurs projektimi për shkollën “Kongresi i Manastirit” në Firajë-Shterpcë;*
- *Tekste shkollore për komunitete kl. I-V;*
- *Instalimi i internetit në Qendrën didaktike në Ferizaj;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Sylë Alaj” Dranoc, Deqan;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Rilindja” Dobrigje, Gjakovë;*
- *Blerja e teksteve shkollore për dhënie falas fëmijëve të kategorive të ndryshme;*
- *Furnizim me harta gjeografike dhe historike për shkollat e Kosovës;*
- *Ndërtimi i shkollës së mesme në Junik;*
- *Transporti i ekspertëve.*
- *Konkurs projektimi për shkollën fillore “Bajram Curri” Nekofc;*
- *Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore “Sadri Misini” Shipashnicë, Kamenicë;*
- *Vazhdimi i punimeve në shkollën fillore në Vushtrri;*
- *Furnizim me tonera;*
- *Furnizim me inventar;*
- *Furnizim me kompjuterë dhe pajisje kompjuterike*
- *Furnizim me teste të maturës;*
- *Furnizim me material për mure ndarëse në arkiv;*
- *Furnizim me inventar për kabinetin e Ministrisë;*
- *Shërbime të internetit;*
- *Furnizimi me goma dhe larja e automjeteve të MASHT-it;*
- *Sigurimi i teksteve për minoritetin goran;*
- *Furnizim me inventar për programin austriak;*
- *Furnizim me pajisje kompjuterike për programin austriak;*
- *Klimë për Zyren e Ministrisë.*

- *Furnizim me detektor elektrik për MASHT;*
- *Furnizim me pajisje kompjuterike për Agjensionin e Akreditimit;*
- *Furnizim me inventar për Agjensionin e Akreditimit;*
- *Shtypja e posterave;*
- *Furnizim me broshura;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Hasan Prishtina” Godanc, Shtime;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Lasgush Poradeci” Rashnicë, Shtime;*
- *Renovimi i shkollës “Lasgush Poradeci” Muzeqinë, Shtime;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Idriz Ajeti” Pjetërshicë, Shtime;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Skenderbeu” Reqak, Shtime;*
- *Libra amë për institucionet private.*
- *Renovimi i shkollës fillore “Idriz Ajeti” Baicë, Lipjan;*
- *Renovimi i shkollës fillore në Cermjan, Gjakovë;*
- *Renovimi i shkollës fillore në Baballoq, Gramaqel- Deqan;*
- *Renovimi i shkollës fillore “Eqrem Qabej”, Buricë- Podujevë;*
- *Renovimi i shkollës së mesme “Kuvendi i Arbërit” Ferizaj.*

DEPARTAMENTI I INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE TEKNIKE

❖ Sektori i infrastrukturës

Puna e këtij sektori është e orientuar në përmirësimin dhe krijimin e hapësirave të reja shkollore me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit dhe zbatimit të reformave arsimore për të gjitha komunitetet.

Kështu, janë duke vazhduar punët në ndërtimin e shkollave të filluara në vitin 2006, si: shkolla fillore “Mitrush Kuteli”, Mat – Prishtinë (objekti pritet të përfundojë deri në shtator të këtij viti); shkolla fillore “Martin Camaj”, Gurrakoc – Istog; shkolla fillore “Gjon Sereqi”, Ferizaj (vazhdojnë punimet e fazës së dytë); shkolla fillore “Dardania”, Pejë; shkolla fillore në Vushtrri (janë duke vazhduar punimet e fazës së dytë); shkolla fillore Stan Tërg - Mitrovicë (ky objekt pritet të hyjë në përdorim në shtator të këtij viti); shkolla fillore në Lubishtë - Viti (janë duke vazhduar punët finale).

Nga buxheti i planifikuar për vitin 2007, janë lidhur kontratat dhe kanë filluar punimet në këto objekte shkollore:

Shkolla fillore “Adem Bajrami”, Kijevë, renovim

Shkolla fillore “ Emin Duraku”, Arllat – Drenas, ndërtim i ri (faza e dytë),

Shkolla fillore - Leletiq – Lipjan, ndërtim i objektit të ri (kanë filluar punimet)

Shkolla fillore “Eqrem Çabej “, Buricë – Podujevë, ndërtim i objektit të ri

Shkolla fillore “Ramë Bllaca”, Bllacë – Suharekë, ndërtim i ri (faza e dytë),

Shkolla fillore “ Luigj Gurakuqi “, Gërdovc – Podujevë, ndërtim i aneksit

Shkolla fillore”Qemajl Bakia” Dol – Gjakovë, renovim i objektit

Shkolla fillore “Muhamet Qami” Kuk – Dragash, rindërtim i objektit

Shkolla fillore “Musa Zajmi”, Gjilan, aneks i objektit ekzistues

Shkolla fillore “Lidhja e Prizrenit”, Deçan, renovim i objektit

Shkolla fillore “Nazim Hikmet”, Bukovikë - Gjilan, ndërtim i objektit të ri,

*Shkolla fillore “Skënderbeu“, Hogosht – Kamenicë, renovim i kulmit
Ismail Qemali, Hogosht - Kamenicë, renovim i objektit
Shkolla fillore, “Selami Hallaqi”, ndërtimi i aneksit prej 12 dhomave të mësim
Shkolla mesme “Naim Frashëri”, Shtime, renovim i objektit të dëmtuar nga erërat e
forta*

*Shkolla fillore “Ismail Qemali”, Prishtinë, renovim i objektit
Shkolla fillore “Kuvendi i Arbërit”, Ferizaj, renovim i objektit
Shkolla fillore “Filip Shiroka”, Slivovë - Prishtinë, renovim i objektit
Shkolla fillore “Idriz Ajeti”, Bainsë - Lipjan, përfundim i punimeve në objektin e ri
(i ndërtuar nga donatorë)*

*Shkolla fillore “Pandeli Sotiri” Obiliq, renovim i objektit
Shkolla fillore në Gramaqel, Baballoq - Deçan, renovim dhe zgjerim i objektit
Shkolla fillore Cërmjan - Gjakovë, vazhdim i punimeve në ndërtimin e objektit të ri
Shkolla e re fillore në Prizren, ndërtim i objektit të ri*

Në planifikimin buxhetor për këtë vit MASHT brenda listës së prioriteteve vjetore për investime në infrastrukturën shkollore ka përfshirë edhe projekte për nxënësit minoritar dhe ata të kthyer në vlerë prej 150 000 €. Kështu, gjatë kësaj periudhe është përruruar shkolla në Viçë, komuna e Shtërpçës. Objekti shkollor ka qenë donacion nga USAID dhe është implementuar nga MERCY CORS.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), pasi ka realizuar vlerësimin e rrezikshmërisë së mjedisit dhe shëndetit nga plumbi dhe metalet e rënda me plumb ka ndarë një shumë të caktuar të mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve remediale në shkollat e Mitrovicës, me qëllim të krijimit të një ambienti të shëndoshë për punë, mësim dhe jetesë duke e shfrytëzuar qasjen “Shkollat Promovuese të Shëndetit”. Vlera totale e investimeve rreth 112,000.00 €, përfituese kanë qenë tri shkolla fillore dhe një institucion parashkollor: sh.f. “Migjeni” në Mitrovicë, sh.f. “Bedri Gjina” në Mitrovicë, sh.f. “Elena Gjika”, tuneli i parë në Mitrovicë, sh.f. “Vuk Karaxhiq” në Zveçan, dhe institucioni parashkollor “Danica Jaramaz”.

Vazhdojnë përgatitjet për pajisjen e shkollave me inventar dhe kompjuterë MASHT, në bashkëpunim me drejtorët komunal të arsimit, në komunat e Kosovës është duke përpiluar listat prioritare për investime në godinat shkollore për vitet në vijim: 2008, 2009 dhe 2010.

Janë futur në programin e PIP projektet kapitale për vitin 2008.

Janë rregulluar zyrat e Agjencionit të Akreditimit dhe janë pajisur me pajisjet përkatëse.

Spektori i infrastrukturës ka zhvilluar edhe këto punë dhe aktivitete:

Gjatë muajit shtator MASHT ka arritur të përfundojë investimet në shkollën fillore “Trepça” në Stan Tërg të komunës së Mitrovicës si dhe ka vënë gurëthemelin për ndërtimin e shkollës së mesme “Ilirida” në Mitrovicë.

Shkollat të cilat kanë filluar të ndërtohen në vitin 2006 janë 3, prej tyre njëra ka hyrë në funksion, 1 pritë të hyjë në funksion gjatë muajit tetor, ndërsa në një tërësi kanë mbetur të punohen shkollat në hyrje të shkollës.

Shkollat të ndërtuara nga buxheti 2007 të cilat janë të planifikuara të hyjnë në funksion në shtator të këtij viti janë 20 shkolla, prej të cilave 12 kanë hyrë në funksion, për dy shkolla pritë pranimit teknik, ndërsa 6 tjerat janë në fazën finale.

Nga buxheti i planifikuar për vitin 2007, kanë vazhduar punimet në 12 objekte shkollore:

Ndërsa në procedurat e tenderimit dhe vlerësimit, ku gjatë muajit tetor priten të fillojnë punimet janë 2 shkolla.

Vetëm gjatë muajit nëntor MASHT ka lidhur kontratat dhe ka filluar punimet edhe në këto objekte arsimore

- *Shkolla e mesme në Firajë – Shtërpçë, nderim i objektit të ri.*
- *Shkolla fillore “Zekirja Rexha në Gjakovë.*
- *Shkolla fillore në Llukar, komuna e Prishtinës*
- *Shkolla fillore në Nekovcë, komuna e Gllogovcit*
- *Renovimi i shkollës fillore në Lugisht, Komuna e Prizrenit*
- *Renovimi i konviktit të nxënësve/studentëve në Gjakovë*

Shkollat në të cilat ka përfunduar investimi janë:

Shkolla fillore “Mitrush Kuteli”, Mat – Prishtinë, ndërtim i objektit të ri

Objekti është përfunduar dhe është bërë pranimi teknik.

- *Shkolla fillore “Vëllezërit Frashri”, Miradi e Lartë – Fushë Kosovë*
- *Investimi ka përfunduar dhe është bërë pranimi teknik.*
- *Shkolla fillore “Idriz Ajeti”, Bainsë – Lipjan, është bërë pranimi teknik i punimeve në objektin e ri i ndërtuar nga donatore dhe MASHT.*
- *Shkolla fillore “Ramë Bllaca”, Bllacë – Suharekë, ndërtim i ri (faza e dytë), punimet në punët finale kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik në dhjetor.*
- *Shkolla mesme “Naim Frasheri”, Shtime, renovim i objektit të dëmtuar nga erërat e forta. Investimi ka përfunduar.*
- *Pandeli Sotiri Obiliq, renovim i objektit.*

Renovimi i objektit ka përfunduar, pranimi teknik është bërë në dhjetor.

Inventari

Është duke vazhduar shpërndarja e inventarit nëpër shkollat e reja të ndërtuara nga MASHT apo donatorë si dhe në disa shkolla te vjetra ku mungon inventari Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është duke investuar edhe në rregullimin dhe krijimin e hapësirave të arsimit të lartë dhe objekteve tjera kapitale arsimore

- Janë duke vazhduar punimet në ndërtimin e Institutit të Historisë, respektivisht faza e parë dhe e dytë e ndërtimit..

- Kanë filluar punimet për ndërtimin e Konviktit nr. 6 në hapësirën e qendrës së studentëve në Prishtinë.

- Është bërë pranimi teknik i punimeve në renovimin e Fakultetit të Edukimit –dega në Gjakovë

- Vazhdojnë punimet në renovimin e fakultetit të mjekësisë, respektivisht objekti i ORL në Prishtinë

- Kanë filluar punimet në renovimin e konviktit të nxënësve dhe studentëve në Gjakovë Pritet te sigurohet leja e ndërtimit dhe të fillojnë përgatitjet edhe për ndërtimin e fakultetit të edukimit në Prishtinë, ku tani më është siguruar lokacioni si dhe projekti zbatues për këtë fakultet.

Ndërtimi i objektit të MASHT-it

Janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë edhe punimet për ndërtimin e ri të objektit të MASHT-it, tani janë duke u punuar punimet e konstruksionit dhe mbulesës së kulmit

Në të gjitha këto projekte (ndërtime, renovime, dhe anekse) janë realizuar shumë vizita në terren, janë përgatitur raporte nga vizitat në terren si dhe është bërë menaxhimi dhe përcjellja e punimeve nga Departamenti i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Teknike

❖ Sektori i mbështetjes teknike

Është bërë shpërndarja e materialit harxhues sipas kërkesave të zyrtarëve të MASHT dhe zyrave rajonale.

Janë realizuar udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit sipas kërkesave.

Është bërë mirëmbajtja e veturave si servisimi, regjistrimi, larja etj.

Është bërë mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit të MASHT –it

Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve kompjuterike dhe rrjetit të internetit.

Janë duke u bërë incizimi i inventarit dhe përcjellja e lëvizjes së tij sipas kërkesave.

Deri më tani kompjuterët donacion nga gjykata e Hagës janë shpërndarë në 36 shkolla.

➤ *Sektori i shërbimeve teknike*

Aktivitetet e sektorit të mbështetjes teknike për periudhën raportuese sipas njësive janë:

Njësia e inventarit dhe mirëmbajtjes

- *Mirëmbajtja e ndërtesës së MASHT-it dhe ZRA- Prishtinë*
- *Formimi i kthinës në sallën e takimeve, për serverin e SMIAS*
- *Shpërndarja e dollapëve të drurit dhe metalit për zyrtarët e MASHT-it*
- *Përgatitja e zyrave për Agjensionin e Akreditimit në Qendrën e Studentëve*
- *Mirëmbajtja e zërimit në sallën e takimeve*
- *Incizimi i inventarit dhe përcjellja e lëvizjes së tij sipas kërkesave*
- *Janë shpërndarë kondicioner për zyrat rajonale në Gjakovë dhe Pejë dhe për Qendrën Didaktike të Pejës.*
- *Është bërë vendosja dhe rregullimi i disa kondicionerëve në objektin e MASHT*
- *Është dorëzuar në prokurim kërkesa për blerjen e klimave lëvizëse për disa zyra të MASHT- it*
- *Janë pranuar disa kompjuterë donacion nga Haga, të cilët janë shpërndarë nga 5 për secilën nga këto shkolla: në komunën e Skenderajt në shkollën fillore “Ismet Rrahmani” në Açarevë; në komunën e Drenasit në shkollën fillore “Ali Gashi”, Çikatovë e Re; në komunën e Gjakovës në shkollën fillore “Remzi Pula” në Dublibar.*

Njësia e teknologjisë informative

- *Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve kompjuterike dhe rrjetit të internetit si dhe formatimi i 65 kompjuterëve.*

Njësia e furnizimit

- *Furnizimi i depos me material harxhues si dhe mirëmbajtja e saj*
- *Është bërë shpërndarja e materialit harxhues sipas kërkesave të zyrtarëve të MASHT dhe zyrave rajonale.*
- *Shpërndarja e kartelave të telefonisë mobile*

- *Konfirmimi i shpenzimeve për telefoninë fikse.*

Njësia e transportit

- *Është bërë mirëmbajtja e veturave si: servisimi, regjistrimi, larja etj.*
- *Realizimi i vizitave në terren brenda dhe jashtë vendit për zyrtarët e MASHT-it*
- *Kontrollimi dhe nxjerrja e kilometrave për vetura.*

Logjistika ka mbështet me sukses mbajtjen e testit kombëtar dhe testit të maturës.

SFIDAT

Ndër sfidat me të cilat MASHT është përballur gjatë vitit 2007 janë:

Përpjekjet e parreshtura për integrimin e plotë të minoritetit serb në strukturat e sistemit unik të arsimit në Kosovë

Përcaktimi i statutit të arsimit, përkatësisht përmirësimi i bazës materiale të tyre

Implementimi i strategjive zhvillimore të miratuara deri më tani

Monitorimi, vlerësimi dhe valorizimi real i procesit të reformave deri më tani

Infrastruktura e pamjaftueshme shkollore;

Mbikëqyrja, vlerësimi, ngritja e cilësisë në institucionet publike dhe private të arsimit në të gjitha nivele e arsimit etj.

PRIOTITETET E MASHT-it PËR 2008

Plani i punës i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2008 bazohet në:

- *Prioritetet e Qeverisë së Kosovës për vitin 2008 (të paraqitura në Planin Strategjik të Kosovës 2007-2013);*
- *Strategjinë e Arsimit Parauniversitar, 2007-2017;*
- *Strategjinë e Arsimit të Lartë të Kosovës 2005-2015, si dhe në disa strategji të tjera sektoriale nga fusha e arsimit;*
- *Në të arriturat në të gjitha fushat dhe nivelet e arsimit, veçmas në procesin e zhvillimit të reformave të arsimit në Kosovë gjatë vitit 2007;*
- *Në vazhdimin e programeve dhe projekteve që zhvillohen nga MASHT, në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë të jashtëm e që kanë vijimësi më të gjatë kohore, inicimin e projekteve dhe programeve të reja, si dhe në:*
- *Mundësitë buxhetore që ka Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2008.*

Për realizimin e vizionit dhe misionit të arsimit, të parapara në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2007-2017, përkatësisht Strategjinë e Arsimit të Lartë të Kosovës 2005-2015 dhe programin qeverisës, MASHT për vitin 2008 ka përcaktuar këto objektiva, programe dhe projekte prioritare:

- *Të përcaktojë arsimin si prioritet të parë dhe vendimtar për Kosovën;*
- *Që sistemi arsimor t'i shërbejë një shoqërie të bazuar në dije, ekonomi dhe punësim;*
- *Që arsimit të jetë punë dhe fokus i përbashkët ndërsektorial i tërë Qeverisë së Kosovës;*
- *Të sigurojë gjithëpërfshirje, barazi dhe respektim të diversiteteteve në arsim;*
- *Të sigurojë gjithëpërfshirje të tërë gjeneratës së re në arsimin fillor dhe të mesëm;*
- *Të ngrisë qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor dhe efikas në sistemin e arsimit*
- *Të zhvillojë sistem efektiv për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të personelit arsimor*
- *Të krijojë mjedis fizik të përshtatshëm dhe të shëndetshëm për mësimdhënie dhe nxënie*
- *Të ndërtojë lidhje të qëndrueshme të arsimit me zhvillimet ekonomike dhe shoqërore;*
- *Të rrisë rëndësinë e kualifikimeve në fushën e arsimit profesional dhe të arsimit të lartë për tregun e punës;*
- *Të avancojë gjendjen materiale të arsimit përmes zëvendësimit të sistemit aktual linear të pagave të mësimdhënësve me sistemin e dallimeve pozitive në pagë, në përputhje me kriteret e licencimit;*
- *Të themelojë Fondin Nacional (Kombëtar) për Edukim nga shtimi i taksave alkool dhe duhan;*
- *Të hartojë politika dhe të krijojë mekanizma për ngritjen e kontrollit dhe të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe universitar*

- *Të ngritet kapaciteti për punë kërkimore-shkencore;*
- *Të krijohen mekanizma për sigurimin dhe menaxhimin e efektshëm të burimeve dhe të mjeteve financiare për zhvillimin e arsimit të lartë;*
- *Të zhvillohet një infrastrukturë e plotë dhe funksionale për arsimin e lartë;*
- *Të promovojë nevojën për arsim profesional dhe mësimin gjatë tërë jetës;*

Prioritete tjera edhe në këtë vit, e që dalin nga planifikimi i politikave arsimore janë:

- *Përmbushja në tërësi e standardeve që i përkasin fushës së arsimit;*
- *Integrimi i të gjitha minoriteteve në sistemin unik arsimor të Kosovës;*
- *Ndërtimi i bazës ligjore me ligje të reja, nxjerrja e udhëzimeve përkatëse administrative që dalin nga ligjet e miratuara, si dhe nga objektivat e cekura më lart;*
- *Vlerësimi dhe valorizimi i procesit të reformave në arsim si dhe rishikimi dhe ripunimi i Kornizës së Kurrikulit të Ri të Kosovës, planprogrameve dhe teksteve shkollore, si dhe trajnimi i personelit arsimor;*
- *Fillimi i procesit të licencimit të arsimtarëve dhe përgatitja e bazës së nevojshme ligjore;*
- *Implementimi i planprogrameve për mësimin protësues të fëmijëve tanë në diasporë;*
- *Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë në mësimdhënie, studim dhe punë shkencore;*
- *Themelimi dhe Funkcionalizimi i Agjensionit për Akreditim të Kosovës;*
- *Themelimi i Qendrës për Transfer Teknologjik;*
- *Ngritja e Qendrës për Standarde dhe Vlerësim;*
- *Licencimi i institucioneve të reja të arsimit privat në të gjitha nivelet si dhe vlerësimi dhe valorizimi i punës së institucioneve private të licencuara;*
- *Ngritja e nivelit të bashkëpunimit në fushën e arsimit - lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit me vendet e rajonit dhe më gjerë;*
- *Vazhdimi i bashkëpunimit me donatorët e deritashëm si dhe kërkimi i donatorëve të rinj;*
- *Përgatitja për konferencën e donatorëve dhe prezantimi i nevojave përmes projekteve konkrete nga MASHT-i;*
- *Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Universitetet në Kosovë;*
- *Zhvillimi dhe implementimi i një sistemi modern për menaxhimin e informatave në arsim;*
- *Integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropian të Arsimit të Lartë;*
- *Zhvillimi dhe përcjellja e veprimeve që dalin nga prioritetet e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE);*